



Muhammed Xhevàd Mugnijeh

FIKHU I IMAM

XHA'FERR SADIKUT

(Paqja goftë mbi të!)

II

Titulli: **Fikhu i Imam Xha`ferr Sadikut** (*Paqja qoftë mbi të!*) II

Autori: **Muhamed Xhevàd Mugnijeh**

Përktheu: **H. Selim Stafa** (*Allahu e mëshiroftë!*)

Recensent: **H. Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Perkujdesja garfike: **Sabrie Feza**

Kapaku: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata FLLADI**

NAMAZI

NAMAZET FARZ DHE NAMAZET NAFILE

Kuptimi i namazit

Nga ana gjuhësore, fjala “salat”-“namaz”, do të thotë “lutje”. Allahu i Lartësuar thotë:

“وَمِنَ الْأَعْرَابِ مَنْ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَيَتَّخِذُ مَا يُنْفِقُ قُرْبَاتٍ عِنْدَ اللَّهِ وَصَلَوَاتِ الرَّسُولِ ۚ”

“Prej banorëve të shkretëtirës ka që besojnë në Allahun e në Ditën e fundit dhe atë që e japin, e konsiderojnë afrim te Allahu e bekim te i Dërguari...” (Sure “Et Teubeh”, ajeti 99), që do të thotë, lutja e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë:

“إِنَّ صَلَاتَكَ سَكَنٌ لَهُمْ ۖ”

“...me të vërtetë, lutja jote është qetësim për ata...” (Sure “Et Teubeh”, ajeti 103), si dhe ajete të tjera.

Fjala “*salat*” për namazin e xhenazes është në kuptimin e lutjes për të vdekurin para varrimit.

Në ligjin e fesë, lutja, “*salat*” është namazi për kryerjen e të cilit pastrimi është kusht. Gjithashtu, kryerja e namazit përmban fjalë e veprime të veçanta: namazi fillon me tekbir dhe përfundon me selam. Allahu i Lartësuar e ka përmendur namazin në shumë ajete të Librit të Tij, në të cilat ka urdhëruar të ruhen me rigorozitet kohët e faljes së namazit dhe ka bërë kërcënime për ata që lënë faljen e namazit. Prej këtyre fjalëve të Tij, janë vetëm emrat e Tij të bukur, kemi:

“مَا سَلَكَكُمْ فِي سَقَرٍ ۚ قَالُوا لَمْ نَكُ مِنَ الْمُصَلِّينَ”

“Çka u solli në Sekar. Ata thanë: nuk ishim prej atyre që falnin namaz.” (Sure “*El Mudeth’thir*”, ajetet 42-43), si dhe ajeti:

“أَصَاعُوا الصَّلَاةَ وَاتَّبَعُوا الشَّهَوَاتِ ۖ فَسَوْفَ يَلْقَوْنَ عَذَابًا”

“...që lanë namazin e u dhanë pas kënaqësive dhe më pas ata do të flaken në çdo të keqe...” (Sure “*Merjem*”, ajeti 59)

Allahu i Plotpushtetshëm thotë:

“وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ”

“Falni namazin dhe jepni zekatin...” (Sure “*El Bekare*”, ajeti 43 dhe sure “*En-Nisa*”, ajeti 77)

Allahu Fuqiplotë thotë:

قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ ۚ الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ

“Është e sigurt që kanë shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përulur në namazin e tyre.” (sure “El-Muminun”, ajetet 1-2)

Në një ajet tjetër, Allahu i Lartësuar thotë:

“إِنَّ الصَّلَاةَ كَانَتْ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ كِتَابًا مَوْقُوتًا”

“...sepse namazi është obligim me kohë të caktuar për besimtarët...” (Sure “En Nisa”, ajeti 103)

Mohuesi i namazit dhe lënësi i namazit

Namazi është prej shenjave të dukshme të Islamit dhe njëri prej pesë kolonave të tij, për të cilat tregon hadithi i nderuar: *“Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla, që janë: dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi në muajin e Ramazanit dhe Haxhi në Qabe për atë që ka mundësi.”*

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Ndërmjet mohimit (kufrit) dhe besimit (ijamànit) s’ka gjë tjetër përveç lënies së namazit... ai që e le namazin me qëllim, umeti islam nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj këtij lënësi të namazit.”*

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Kurvarin dhe atë që pi verë e cyt epshi, kurse atë që le namazin, nuk e cyt gjë tjetër përveç mosdhënies rëndësi.”*

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se, kur njeriu, pasi ka pranuar Islamin, mohon që falja e namazit është farz, ai është mohues (*kàfir*), është renegat dhe ekzekutimi i tij është bërë i detyrueshëm, sepse ai, me mohimin e namazit, ka stisur një fe

tjetër përveç Islamit. Por, nëse njeriu e le faljen e namazit, duke e ditur se po mëkaton, ose ngaqë nuk i kushton rëndësi, atë e edukon sundimtari me mjetet që ai mendon: me qortim, sharje, rrahje, ose burgim. Në qoftë se ai, edhe pas këtij “edukimi” vazhdon të mos e falë namazin, sundimtari e edukon për së dyti herë dhe e urdhëron të bëjë teube, ndryshe i shtrëngon masat ndaj tij. Nëse ai vazhdon e nuk heq dorë nga lënia e namazit, herën e katërt ai ekzekutohet.

Namazet farz

Kemi namaze farz (të detyrueshme) dhe namaze mustehab (të pëlqyeshme). Namaze farz, në radhë të parë, janë pesë namazet ditore, sexhedeja në ajetet e sexhdeve (sexhdetu tilàveh), namazi i tavafit farz, si dhe namazi kaza që fal djali i madh për dy prindërit e vet për namazet që ata të dy nuk i kanë falur dot për shkak të sëmundjes nga e cila vdiqën.

Namazet ditore janë pesë: namazi i drekës (*dhuhr*) “Yleja” katër rekate, namazi i pasdites (*asr*) “Iqindija” katër rekate, namazi i mbrëmjes (*magrib*) “Akshami” ka tre rekate, namazi i darkës (*el ishà*) “Jacija” katër rekate dhe namazi i mëngjesit (*es subh*) “Sabaja” dy rekate. Gjatë udhëtimit namazet me katër rekate përgjysmohen, domethënë namazi i drekës, namazi i pasdrekes dhe namazi i darkës bëhen nga dy rekate.

Më poshtë do të vijë edhe sqarimi për këtë çështje, domethënë që falja e namazeve ditore janë farz dhe janë vërtetuar prej domosdoshmërisë së fesë, prandaj për këtë çështje s’ka vend

as për hulumtim (*ixhtihàd*) e as për ndjekje tradite (*taklijd*). Gjithashtu, nuk është e nevojshme të përmendim as tekste.

Namazet e vullnetshme (nevàfil) të namazeve të përditshme

Namazet mustehab, përveç namazeve farz, janë shumë dhe do të përmendim namazet e vullnetshme të namazeve të përditshme. Numri i namaze mustehab është tridhjetë e katër rekate, të ndara si vijon: 8 rekate para namazit të drekës, 8 rekate para namazit të pasdites, katër rekate pas namazit të mbrëmjes, 2 rekate pas namazit të darkës dhe pas ndenjes pasohen nga një rekat i vetëm që quhet "*el uetijretu*", 8 rekate të namazit të natës, dy rekate të çiftit (*esh'shefi*) dhe një rekat i vitrit, si dhe dy rekate para namazit të mëngjesit.

Në lidhje me këto namaze mustehab, ka njoftime të shumta të transmetuara prej Ehli Bejt (Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta!).

I nderuar lexues, këto hadithe ke mundësi t'i gjesh në librin "*El Uesàil*". Sej'jid El Hakijm thotë në librin "*El Mustemsek*": "Me këtë renditje të hollësishme kanë ardhur tekstet si një zinxhir i pashkëputur.

Nga sa u tha, rezulton se rekatet farz dhe rekatet mustehab (*nevàfil*) të namazeve ditore janë gjithsej 51 rekate.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "*Farzet dhe mustehabet janë 51 rekate, prej të cilave dy rekate falen ndenjor pas*

farzit të namazit të darkës dhe që pasohet nga një rekat që falet më këmbë."

Thënë ndryshe, nga ky numër rekatesh namaze farz janë 17 rekate dhe 34 rekate janë namaze të vullnetshme (nevàfil).

Të gjitha namazet mustehab falen nga dy rekate, me një tesheh'hud e me një selam, plotësisht siç falet namazi i mëngjesit, përveç namazit të vitrit, i cili është një rekat i vetëm me tesheh'hud e me selam. Në udhëtim rrëzohen të gjitha namazet mustehab, me përjashtim të rekateve mustehab të namazit të mbrëmjes. Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): "Namazi në udhëtim është dy rekate dhe nuk ka gjë tjetër as para e as pas këtyre dy rekateve, përveç namazit të mbrëmjes, pas të cilit janë katër rekate mustehab." Këto katër rekate mos i lini as kur jeni në vendbanimin tuaj e as kur jeni në udhëtim.

* * *

KOHËT E FALJES SË NAMAZEVE

Allahu i Lartësuar urdhëron e thotë në ajetin 114 të sures “Hud”:

“وَأَقِمِ الصَّلَاةَ طَرَفِي النَّهَارِ وَزُلْفًا مِّنَ اللَّيْلِ”

“Fale namazin në dy skajet e ditës dhe në kohën e afërt të natës...”

Skaji i parë i ditës është për namazin e mëngjesit, kurse skaji i dytë është për namazin e drekës dhe namazin e pasdrekës, ndërsa koha e afërt e natës është për namazin e mbrëmjes dhe për namazin e darkës.

Në ajetin 130 të sures “Ta-Ha”, Allahu i Lartësuar urdhëron e thotë:

“وَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ قَبْلَ طُلُوعِ الشَّمْسِ وَقَبْلَ غُرُوبِهَا ۚ وَمِنْ أَنَاءِ اللَّيْلِ فَسَبِّحْ وَأَطْرَافَ النَّهَارِ لَعَلَّكَ تَرْضَىٰ”

“...madhëro e falëndero Zotin tënd duke falur namaz para lindjes së diellit e para perëndimit të tij, fal namaz në orët e natës dhe në skajet e ditës, kështu do të gjesh kënaqësi.”

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar urdhëron e thotë në ajetin 78 të sure “El Isra”:

“أَقِمِ الصَّلَاةَ لِذُلُوكِ الشَّمْسِ إِلَى عَسَقِ اللَّيْلِ وَقُرْآنَ الْفَجْرِ ۖ إِنَّ قُرْآنَ الْفَجْرِ كَانَ مَشْهُودًا”

“Fale namazin kur dielli fillon zbritjen, deri në errësirën e natës dhe bëj lutjen e agimit (fal namazin e mëngjesit), me të vërtetë lutja e agimit është e shoqëruar me prezencë.”

Fjala “kur dielli fillon zbritjen”, tregon kohën kur dielli ka kaluar zenitin. Kjo është koha për faljen e namazit të drekës dhe të namazit të pasdites, kurse fjala “deri në errësirën e natës”, tregon kohën për faljen e namazit të mbrëmjes e të namazit të darkës. Për sa i përket fjalës “dhe bëj lutjen e agimit” “ue kur’anel-fexhri”, tregon kohën për faljen e namazit të mëngjesit, të cilin e dëshmojnë njerëzit. Në njoftimet e transmetuara prej Ehli Bejtit, fjala e ajetit “gaseki-l’lejl”, (në errësirën e natës) ka kuptimin gjysma e natës.

Dihet se këto ajete nuk i përcaktojnë kohët e faljeve të namazeve me saktësi, por mbi shpjegimet e ajeteve s’ka as veshje e as përngjasime, prandaj patjetër duhet t’i referohemi Sunetit (praktikës Profetike) të nderuar, sepse vetëm suneti është komentues e shpjegues për atë që Allahu, me madhërinë e Tij, ka thënë në mënyrën më të bukur në Librin e Tij.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai që fal namaz jashtë kohës së namazit, ai nuk ka falur namaz.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) njofton se i Dërguari më i madh (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush e fal namazin jo në kohën e caktuar,

për atë ngrihet lart një errësirë e zezë që thotë: “Më humbe mua, të humb të Allahu!”

Gjëja e parë, për të cilën do të pyetet rob, kur të qëndrojnë para Allahut të Lartësuar, do të jetë namazi. Nëse ai e ka kryer të pastër namazin e tij, e pastër do të jetë e gjithë puna e tij dhe, nëse rob nuk e ka kryer të pastër namazin e vet, kurrë nuk do të pastrohet puna e tij.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Djalli do të vazhdojë të jetë i frikësuar prej besimtarit, derisa ai të bëjë kujdes që të jetë i përpiktë në kohët për faljen e pesë namazeve. Kur ai nuk ka kujdes për kohën e faljes së namazeve, atëherë djalli i trimërohet besimtarit dhe e fut atë në mëkatet e mëdha.”

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Ndjekësit tanë janë sprovuar në kohën e faljes së namazeve, sa kujdes kanë ata për ruajtjen e kohëve të faljes së namazeve.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur hyn koha e faljes së namazit, hapen portat e qiellit që punët të ngrihen lart. Ah sa dëshiroj që puna ime të jetë e para që ngrihet lart dhe në librin e punëve të mos shkruhet askush para meje.”

Edhe nipi i Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!), Imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: “Kur hyn koha e faljes së namazit, ke detyrë të falësh menjëherë namazin, sepse ti nuk mund të dish se ç’do të ndodhë më pas.”

Thëniet që flasin për ruajtjen e kohëve të namazeve, janë të shumta.

Koha për faljen e namazit të drekës dhe të namazit të pasdites (uaktu dhuhrej):

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur dielli të priret kah perëndimi, ka hyrë koha për faljen e namazit të drekës dhe të namazit të pasdites. Por falja kryhet sipas radhës dhe ti je në kohën e faljes së këtyre dy namazeve deri në perëndimin e diellit.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur dielli fillon animin kah perëndimi, ka hyrë koha për faljen e namazit të drekës, derisa kalon aq kohë sa është e mjaftueshme të falen katër rekate. Kur të kalojë kjo pjesë kohe, atëherë ka hyrë koha për faljen e namazit të drekës dhe të namazit të pasdites, derisa të mbetet prej diellit aq sa burri mund të falë katër rekate dhe, kur mbetet vetëm kaq kohë, atëherë ka dalë koha për faljen e namazit të drekës dhe ka mbetur koha vetëm për faljen e namazit të pasdites, derisa dielli të perëndojë.”

Edhe një thënie e çmuar prej Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!): “Për çdo namaz, ka dy kohë, por fillimi i kohës është koha më e preferuar për faljen e namazit.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur hija jote të jetë sa trupi yt, atëherë fal namazin e drekës dhe, kur hija jote të bëhet sa dy herë trupi yt, atëherë fal namazin e pasdites.”

Fukahatë

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se për faljen e namazit të drekës dhe për faljen e namazit të pasdites ka një kohë të veçantë për faljen e çdo njërit prej këtyre dy namazeve, kurse koha e fundit është e përbashkët. Kur dielli kapërcen kulmin e

kupës së qiellit, është koha për faljen e namazit të drekës dhe, pasi kalon aq kohë sa duhet për faljen e katër rekateve, në kohën vijuese nuk mund të jetë pjesëtar edhe namazi i pasdites. Ndërsa kur dielli i afrohet perëndimit, mbetet koha specifike vetëm për faljen e namazit të pasdites dhe në këtë kohë nuk është pjesëtar namazi i drekës. Koha ndërmjet këtyre dy kohëve të specifikuara, është e përbashkët për faljen e namazit të drekës dhe të namazit të pasdites.

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët që çdo namaz ka dy kohë për faljen e tij, por njëra prej këtyre dy kohëve (koha e parë) është më e preferuar se koha tjetër. Gjithashtu, është veprim i preferuar që të shpejtohet falja e namazit. Dijetarët kanë mendime të ndryshme në lidhje me përcaktimin e kohës për faljen e namazit të drekës dhe të kohës për faljen e namazit të pasdites. Natyrisht që kjo kundërshti mendimesh ka ardhur për shkak se njoftimet e transmetuara prej Ehli Bejt (Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta!) janë të ndryshme. Gjithsesi, fjala më në zë në medh'hebin e Ehli Bejt është veprimi sipas transmetimit të mësipërm, që konsiston: Koha më e pëlqyer për faljen e namazit të drekës është kur hija e çdo sendi bëhet sa vetë sendi dhe koha më e pëlqyer për faljen e namazit të pasdites, është kur hija e çdo sendi bëhet sa dy herë vetë sendi.

Vlen të theksohet se fukahatë, në librat e tyre, i kanë renditur namazet duke filluar me namazin e drekës, sepse ky është namazi i parë që është bërë farz në Islam. Pas këtij është bërë farz namazi i pasdites, pastaj namazi i mbrëmjes, pastaj namazi i darkës dhe në fund është bërë farz namazi i mëngjesit.

Koha për faljen e namazit të mbrëmjes dhe të namazit të darkës (el ishàejn)

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Koha për faljen e namazit të mbrëmjes, është kur zhduket e kuqja e qiellit nga ana e lindjes dhe kështu lindja shtrihet mbi perëndimin.” Ndërkaq Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ngriti të djathtën e tij mbi të majtën dhe pastaj tha: “Kur dielli të perëndojë, ja këtë, zhduket e kuqja prej andej.”¹

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Koha e parë për faljen e namazit të mbrëmjes është zhdukja e të kuqes, kurse koha e fundit për faljen e namazit të mbrëmjes është deri në gjysmën e natës.”

Përsëri Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur dielli perëndon, ka hyrë koha për faljen e namazit të mbrëmjes, derisa të kalojë një periudhe kohe, aq duhet për të falur tre rekate. Pas kësaj hyn koha për faljen e namazit të mbrëmjes dhe të namazit të darkës. Kjo kohë vazhdon derisa afër mesit të natës të ketë mbetur vetëm aq kohë sa burri fal brenda saj katër rekate dhe, kur ka mbetur vetëm aq kohë, atëherë ka dalë koha për faljen e namazit të mbrëmjes dhe ka mbetur kohë vetëm për faljen e namazit të darkës deri në gjysmën e natës.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Në qoftë se burri fle, ose harron të falë namazin e mbrëmjes dhe namazin e

¹ Perëndimi i diellit vërtetohet, sapo të zhduket dielli, por kjo zhdukje e diellit nuk njihet me fshehjen e diskut të diellit nga sytë, por me largimin e të kuqes nga ana e lindjes, sepse e kuqja e lindjes është pasqyrim i dritës së diellit. Sa më shumë të errësohet dielli në kohën e perëndimit, aq më shumë pakësohet edhe ky pasqyrim. Për sa i përket fjalëve që i atribuohen shí'ave se ata vonojnë faljen e namazit të mbrëmjes, derisa të gërshetohen yjet, kjo është vetëm gënjeshtër e shpifje. I është thënë Imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!): “Banorët e Irakut e vonojnë faljen e namazit të mbrëmjes, derisa të gërshetohen yjet.” Ai tha: “Kjo fjalë është prej armiqve të Allahut.”

darkës, në rast se ai zgjohet para agimit, kur ka mbetur aq kohë sa është e mjaftueshme të falë të dy namazet e mbetura, ai i fal këto dy namaze menjëherë."

Në qoftë se ai ka frikë se, për shkak të kohës nuk do të arrijë të falë të dy namazet, atëherë le të fillojë me faljen e namazit të darkës. Në rast se zgjohet pas agimit, më parë le të falë namazin e mëngjesit, pastaj namazin e mbrëmjes dhe pastaj të falë namazin e darkës.

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se fillimi i kohës për faljen e namazit të mbrëmjes është perëndimi i diellit, sipas shenjës së njohur që është zhdukja e të kuqes nga ana lindore e horizontit, derisa nga gjysma e natës të mbetet aq kohë sa duhet për të falur katër rekate. Kurse koha për faljen e namazit të darkës fillon me mbarimin e faljes së namazit të mbrëmjes deri në gjysmën e natës. Koha për faljen e namazit të mbrëmjes llogaritet me kalimin e aq kohe sa duhet për të falur tre rekate, duke shënuar kështu fillimin e kohës për faljen e namazit të darkës, kurse koha specifike për fundin e kohës për faljen e namazit të darkës, llogaritet me mbetjen e aq kohe sa duhet për të falur katër rekate prej përfundimit të kohës. Koha që shtrihet mes këtyre dy namazeve është e përbashkët për faljen e namazit të mbrëmjes dhe të namazit të darkës, plotësisht ashtu siç pamë më sipër në lidhje me kohën për faljen e namazit të drekës dhe të namazit të pasdites.

Për faljen e namazit të mbrëmjes dhe për faljen e namazit të darkës ka dy kohë: koha e parë është me përparësi dhe koha tjetër

është e veçantë për kryerjen e detyrës. Koha e përparësisë për faljen e namazit të mbrëmjes është nga fillimi i kohës, derisa të zhduket e kuqja e perëndimit, në anën lindore të horizontit, kurse koha e përparësisë për faljen e namazit të darkës, është që prej largimit të kësaj të kuqeje deri në dy të tretat e natës.

Kur njeriu harron të falë namazin e mbrëmjes dhe namazin e darkës, ose në kohën e faljes së këtyre namazeve ai fle deri në gjysmën e natës, ai i fal këto dy namaze me nijet si namaze të falura brenda kohës, sepse në raste domosdoshmërie, koha për faljen e këtyre dy namazeve shtrihet deri në daljen e agimit. Është e pëlqyeshme që ai t'i falë këto dy namaze me nijet afrimi të Allahut i Gjithëpushtetshëm dhe jo me nijet se po i fal brenda kohës, ose po i fal si namaze kaza.

Koha për faljen e namazit të mëngjesit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Koha për faljen e namazit të mëngjesit shtrihet ndërmjet zbardhjes së agimit deri në lindjen e diellit.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Për çdo namaz ka dy kohë. E para nga të dyja kohët është me përparësi, kurse koha për faljen e namazit të mëngjesit fillon me agimin, derisa mëngjesi të përshkojë të gjithë qiellin.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se koha e parë për faljen e namazit të mëngjesit është agimi i vërtetë, kurse agimi i gënjeshtërt, është i ngjashëm me dhëmbin e ujkut. Prandaj falja e namazit në këtë kohë, është rreptësisht e ndaluar, por nuk është e ndalur që në këtë kohë të hajë ai që është agjerueshëm. Fundi i kohës për faljen e namazit të mëngjesit, është lindja e diellit. Padyshim që përparësi ka falja në kohën e parë, në krahasim me faljen e namazit në kohë të tjera.

Kohët e nafileve të namazeve ditore

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se koha për faljen e rekateve *nafile* (jo farze) të namazit të drekës hyn me kapërcimin e diellit kah perëndimi. Koha për faljen e nafilës së namazit të pasdites hyn pasi ka mbaruar falja e namazit të drekës.

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre për përfundim e kohës së nafileve. Autori i librit “El Xheuàvir” ka thënë: “Koha për faljen e nafileve të namazit të drekës shtrihet derisa hija e sendit të bëhet sa madhësia e dy këmbëve, kurse koha për faljen e nafileve të namazit të pasdites është kur hija e sendit bëhet sa madhësia e katër këmbëve. Kjo është fetvaja më e përhapur e më në zë si citim, madje në disa shprehje ndihet fjala e përbashkët e fukahave në lidhje me tekstet respektive, të cilat me siguri kanë zinxhir të pashkëputur përcjellësish. Ndër këto njoftime është transmetimi që gjendet në “Sahijhun” e Ibn Miskanit, sipas përcjelljes së Zurares dhe ky e ka marrë prej Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: “*Ti ke të drejtë të falësh namaz nafile, që kur dielli*

kapërcen zenitin, derisa hija jote të bëhet në madhësinë e një krahu, domethënë në madhësinë e dy këmbëve dhe, kur hija jote të bëhet sa madhësia e një krahu, atëherë fillo të falësh farzin dhe lëre nafilen. Kur hija jote arrin madhësinë e dy krahëve, ti ke filluar faljen e farzit dhe ke lënë faljen e nafiles."

Koha për faljen e nafiles së namazit të mbrëmjes është që nga koha që ke përfunduar farzin, derisa të largohet e kuqja e perëndimit. Kurse koha për faljen e nafiles së namazit të darkës shtrihet sipas shtrirjes së kohës së namazit të darkës. Koha për faljen e nafiles së namazit të mëngjesit fillon me agimin e vërtetë, deri me daljen e të kuqes lindore, kurse koha për faljen e nafileve të namazit të natës fillon prej gjysmës së natës deri në shfaqjen e agimit. Sa më shumë të afroresh kah agimi për faljen e namazit të natës, aq më e pëlqyeshme është. Autori i librit "El Xheuàhir" ka thënë: "Në lidhje me këtë çështje nuk ka asnjë kundërshtim që mund të bashkojë këtë përcaktim kohe për faljen e nafilve të namazit të mëngjesit."

Fjalët e Allahut të Lartësuar: **"Dhe në syfyr (deri para agimit) ata kërkojnë faljen e mëkateve."** (Sure "Edh'dhàrij'jàt, ajeti 18); Dhe: **"...ata kërkojnë faljen e mëkateve në kohën e syfyr."** (Sure "Al Imran", ajeti 17),

Ehli Bejti (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!) i ka interpretuar me namazin e natës.

Çështje

1- Më sipër thamë se për namazin e drekës ka një periudhë kohore të veçantë, të mjaftueshme për faljen e katër rekateve në fillimin e kohës, domethënë kur dielli kapërcen zenitin. Edhe namazi i pasdites ka një periudhë kohore të veçantë, të mjaftueshme për faljen e katër rekateve në fundin e kohës së caktuar për faljen e këtij namazi, që do të thotë se namazi i pasdites nuk është i vlefshëm, nëse falet në kohën që është e veçantë për faljen e namazit të drekës. Gjithashtu, as namazi i drekës nuk është i vlefshëm, kur falet në kohën që është e veçantë për faljen e namazit të pasdites. Përsa u përket namazeve të tjera, si namazi që falet kaza, s'ka problem, nëse ai falet në kohën e veçantë për faljen e namazit të drekës ose të namazit të pasdites. Në analogji me këto që u thanë, në lidhje me dy namazet e mësipërme, qëndron edhe puna për faljen e namazit të mbrëmjes dhe për faljen e namazit të darkës.

2- Kur burri ka filluar faljen e namazit të pasdites, duke qenë i bindur se ai e ka falur namazin e drekës, por gjatë faljes së namazit qartësohet se nuk e ka falur namazin e drekës, atëherë me nijetin e tij me zemër, kthehet në namazin e drekës. Por, nëse ai nuk kujtohet, derisa e përfundon namazin e filluar, namazi i pasdites që ai fali, është i vlefshëm dhe pastaj ai fal namazin e drekës, me kusht që namazi të mos jetë falur i gjithi në kohën e veçantë të caktuar për faljen e namazit të drekës, ndryshe namazi i tij është i zhvlerësuar.

3- Nuk lejohet heqja dorë prej namazit të mëparshëm, për të kaluar në namazin vijues, sepse si rregull bazë është vlefshmëria e mos heqjes dorë, por lejohet e kundërta. Për këtë

çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nëse ti harron pa falur namazin e drekës, derisa ke filluar faljen e namazit të pasdites, por gjatë faljes së namazit kujtohesh, ose kujtohesh, pasi ke përfunduar faljen e namazit, atëherë bëje nijet për namazin e parë dhe pastaj fal namazin e pasdites, sepse, në të vërtetë, ke falur katër rekate në vend të katër rekateve (pra: ke falur katë rekartet e ikindisë në vend të katër rekateve të drekës).”

4- Kur burri vonon faljen e namazit të drekës dhe të namazit të pasdites, derisa mbetet kohë vetëm për faljen e katër rekateve, në fillim fal namazin e pasdites në kohën e vet dhe pastaj fal kaza (jashtë kohës së caktuar për faljen) namazin e drekës. Në rast se ka mbetur aq kohë sa mjafton për faljen e pesë rekateve, së pari, ai fal namazin e drekës dhe pastaj fal namazin e pasdites. Në lidhje me këtë, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai që arrin prej kohës, aq sa mjafton për të falur brenda saj edhe një rekat të vetëm, në të vërtetë ai e ka arritur të gjithë kohën.” Prandaj, ai ka detyrë të falë të dy namazet njërin pas tjetrit, me nijetin se po i fal brenda kohës së caktuar për faljen e këtyre dy namazeve, qoftë edhe kur në fillim fal namazin e pasdites dhe më pas fal namazin e drekës. Pra, le të jetë namazi i parë i falur brenda kohës së vet dhe namazi i dytë, le të jetë namaz i falur kaza, sepse s’ka asnjë dyshim që kryerja e faljes së namazit në kohën e vet është më e rëndësishme se falja e namazit kaza, prandaj falja e namazit në kohën e vet ka përparësi ndaj namazit të falur kaza. E njëjta dispozitë është edhe për faljen e namazit të mbrëmjes dhe për faljen e namazit të darkës.

5- Atij që i mbeten pa falur disa namaze farz, ai ka detyrë t’i falë kaza namazet e mbetura, sipas renditjes që kishin namazet e

humbura, ashtu siç ka thënë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Ai i fal kaza ato sipas radhës që i la pa falur.”*

6- Kur buri është duke falur namaz dhe mendon se koha e faljes ka hyrë, por më pas ai bindet për të kundërtën, si do të veprojë ky burrë?

Përgjigje:

Në qoftë se namazi është falur i gjithi jashtë kohës, ky namaz është i pavlefshëm dhe është detyrë të përsëritet falja e namazit, sipas fjalës së përbashkët të fukahave dhe sipas teksteve. Për këtë rast është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), kur është pyetur për një burrë që i gënjyer prej ditës së hënës, ka falur namazin e mëngjesit natën. Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Ai përsërit faljen e namazit të tij, por, kur një pjesë e namazit është falur jashtë kohës së vet dhe një pjesë është falur brenda kohës së caktuar për faljen e atij namazi, qoftë edhe, kur brenda kohës ka mbetur vetëm selami, falja e namazit brenda kësaj kohe konsiderohet namaz i falur në kohën e vet.”*. Pra, ai nuk e përsërit faljen e këtij namazi. Të këtij mendimi janë edhe fukahatë. Ka edhe tekste për këtë, siç është thënia e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Kur ti fal namaz dhe mendon se je brenda kohës së faljes dhe koha e faljes së namazit akoma s’ka hyrë, porse në të vërtetë, koha për faljen e namazit erdhi, dhe ti je në namaz, ti e ke falur atë.”*

* * *

KIBLA

Allahu i Lartësuar, në ajetin 144 të sures “El Bekare” urdhëron e thotë:

“فَوَلِّ وَجْهَكَ شَطْرَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ ۚ وَحَيْثُ مَا كُنْتُمْ فَوَلُّوا وُجُوهَكُمْ شَطْرَهُ ۚ”

“...ktheje fytyrën tënde në drejtim të Xhamisë së Shenjtë (Qabesë) dhe kudo që të ndodheni, ktheni fytyrat tuaja në drejtim të saj...”

Gjithashtu, në ajetin 149 të kësaj sureje, Allahu i Lartësuar urdhëron e thotë:

“وَمِنْ حَيْثُ خَرَجْتَ فَوَلِّ وَجْهَكَ شَطْرَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ ۚ”

“Ngado që të shkosh, ktheje fytyrën tënde në drejtim të Xhamisë së Shenjtë...”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Për Allahun e Plotpushtetshëm ka tri shenjtëri dhe asnjë send nuk mund të jetë i ngjashëm me to: Libri i Tij, vetëm ai është urtësi e dritë; shtëpia e Tij, të cilën Ai e ka bërë Kible për njerëzit, prandaj askujt nuk i pranohet namazi, nëse kthehet në drejtim të ndonjë objekti tjetër, si dhe familja

erëkëndshme e Profetit tuaj (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)."

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "*S'ka namaz veç namazit të falur i kthyer në drejtim të Kibles.*" Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur: "*Ku është kufiri i Kibles?*" Ai është përgjigjur: "*Hapësira që përfshihet ndërmjet lindjes e perëndimit, e gjitha është Kible.*"

Fukahatë

Autori i librit "El Medàrik" ka thënë: "Qëllimi me Qaben është vendi i ndërtimit prej bazamentit në tokë deri në lartësitë e qiellit." Sikur të supozojmë, Allahu na ruajttë, burri nuk bëri nijet për faljen e namazit dhe ai e fali namazin i kthyer në drejtim të Kibles, por ndodhej mbi një vend më të lartë se Qabeja, si për shembull e fali mbi malin Ebu Kajs, ose në ndonjë ultësirë që është në nivel më të ulët se Qabeja. A është i vlefshëm namazi i tij? Në lidhje me këtë çështje, s'ka asnjë mendim ndryshe midis fukahave, se namazi i këtij burri është i vlefshëm. Këtë e tregon ajeti i nderuar. Transmetimet e ardhura prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) njoftojnë se një burrë i ka thënë Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): "*Kam falur namazin e pasdites mbi malin Ebu Kajs. A është i vlefshëm ky namaz, kur Qabja ishte poshtë meje?*" Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: "*Po, ajo është Kible, që nga themeli deri në lartësi të qiellit.*"

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se Qabja, në kuptimin e përmendur, është Kibla e afërme, që mundëson drejtimin kah ajo, kur njeriu ka mundësi të shikojë muret e saj.

Prandaj në këtë gjendje, njeriu drejtohet kah cili mur i saj të dëshirojë. Po kështu drejtohet edhe ai që fal namaz në brendësi të Shtëpisë së Shenjtë.¹ Kurse ai që është larg, patjetër që e fal namazin i kthyer në drejtim të Qabes.

Autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “I largëti, e ka detyrë të domosdoshme (*farz*) të kthehet në drejtim të anës ku gjendet Qabja, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar në Librin e tij:

“فَوَلُّوا وُجُوهَكُمْ شَطْرَهُ” - **“Ktheni fytyrat tuaj në drejtim të saj.”**

Në ajetin e nderuar fjala “*shatrehu*”, do të thotë, “anën e saj”, ashtu siç ka shpjeguar Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*): “Hapësira që përfshihet ndërmjet lindjes e perëndimit, e gjitha është Kible.” Më pas, autori i lartpërmendur, tha: “Mëso se fukahatë kanë kundërshtime të shumta për caktimin e anës ku gjendet Qabja dhe s’ka asnjë caktim që të ketë shpëtuar prej gabimeve, për shkak se fukahatë s’kanë argument të përcjellë, që të jetë i vlefshëm për t’u bazuar në të. Për më tepër, s’ka as edhe argument logjik mbi të cilin ata të mbështeten. Ajo që mësohet prej argumenteve të ligjit të fesë tregon qartë se është e mjaftueshme kthimi në drejtim të Qabes, sipas bindjes së formuar dhe sipas asaj që është e zakonshme në praktikën e përditshme, në lidhje me anën e horizontit kah gjendet Qabja. Të gjitha njoftimet nuk

¹ Me fjalën e përbashkët të fukahave, njeriut i lejohet të falë namaz nafile në brendësi të Qabes. Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se njeriut, në raste emergjente, i lejohet të falë në brendësi të Qabes edhe namaz farz, por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, nëse lejohet të falet me dëshirë namaz farz në brendësi të Qabes. Pjesa më e madhe fukahave janë shprehur se namazi farz, i falur në brendësi të Qabes, lejohet krahas kerahetit, kurse disa fukaha të tjerë kanë thënë se është haram të falet namaz në brendësi të Qabes dhe ai namaz nuk është i vlefshëm.

përmbajnë asnjë përkufizim, me gjithë nevojën e madhe që ka për njohjen e këtyre shenjave orientuese. Për sa i përket referencës për të mësuar, kjo është krejtësisht e përjashtuar, sepse është një dituri me shumë imtësi paraprake, prandaj obligimi për masën e njerëzve që janë larg Qabes, mbetet përpjekja për të mësuar drejtimin e anës së Qabes nëpërmjet seleksionimit të shenjave më të domosdoshme.

Rruga e njohjes së drejtimit të Kibles

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Përpjekja për ta gjetur gjithmonë e shlyen, kur nuk dihet ana nga bie Kibla.”, domethënë: Kur nuk dihet nga cila anë është Kibla, njeriu ka detyrë të hulumtojë që të mësojë sa më saktë drejtimin e Kibles. Ai vepron sipas hulumtimit që bëri, sido që të jetë hulumtimi i tij.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), në lidhje me fjalën e Allahut të Lartësuar:

“قَوْلٌ وَجْهَكَ شَطْرَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ”

“...ktheje fytyrën tënde në drejtim të Xhamisë së Shenjtë (Qabes).”, ka thënë: “Ajeti ka kuptimin: Kthehu drejt saj, kur ajo shikohet dhe kthehu në drejtim të saj bazuar në argumente e në shenja, kur ajo nuk shikohet. Kur ti e di anën e Kibles, është detyrë e padiskutueshme që të kthehesh në drejtim të saj, por s’ka argument që të tregojë anën e Kibles. Kur anët e horizontit janë të gjitha të sheshta, atëherë njeriu le të falë namazin sipas hulumtimit të tij dhe le të përzgjedhë të drejtohet kah ana që mendja i anon më shumë, se nga ajo anë është Kibla, derisa të hasë në argumente e në shenja të qëndrueshme.

Nëse krahas kësaj që përmendëm, buri përsëri devijon nga drejtimi, aq sa lindjen e bën perëndim dhe perëndimin e bën lindje, hulumtimi i tij e ka humbur kuptimin dhe është prishur që kur ai u sigurua për drejtimin e Kibles."

Fukahatë

Në shkencën e bazave të ligjit të fesë (*ilmul usûl*), fukahatë kanë vendosur atë çka është e njohur me mendje spontanisht dhe kanë thënë: Kur njeriu ka arritur moshën në të cilën obligohet me detyrimet e fesë, kur di se një gjë kërkohet prej tij, ai është i detyruar ta kryejë atë gjë. Prandaj ai ka detyrë të studiojë e të vëzhgojë me imtësi rreth asaj gjëje, derisa të mësojë atë që i duhet për kryerjen e obligimit në fjalë, pasi vetëm kështu ai ka mundësi ta kryejë atë adhurim të plotë e me të gjitha kërkesat. Kurse ai që e le studimin e vëzhgimin, është si ai që le një detyrim të njohur. Në qoftë se ai s'ka mundësi të arrijë të mësojë,¹ atëherë le të veprojë sipas hamendjes së vet, pasi në këtë rast nuk ka rrugë që ai të arrijë diturinë. Por nëse ai nuk ka mundësi as të mendojë, atëherë ai imiton të tjerët dhe, në qoftë se ai nuk gjen dikë që meriton të imitohet, atëherë vepron me rezervë, krahas mundësisë që ka për veprim. Nëse ai nuk ka mundësi të veprojë as me rezervë dhe as të sjellë të gjithë elementet, atëherë përzgjedh elementin që ka mundësi të kryejë, me kusht që të mos ketë mundësi më të dobët se elementi tjetër që ai la, kur ka fuqi ta kryejë edhe këtë.

¹ Mendimi për të cilin flet argumenti i ligjit të fesë konsiderohet në pozitën e ditorisë, prandaj fukahatë e kanë emërtuar "argumenti i ditorisë", sepse ai përfundon në dituri, që do të thotë se është dituria ajo që ka urdhëruar të veprohet sipas këtij mendimi specifik.

Bazuar mbi sa u tha, kush ka qëllim të falë një namaz farz, ose namaz nafile,¹ ose të bëjë një punë, në të cilën është kusht drejtimi kah Kibla, si për shembull, prerja e kurbanit, falja e namazit të xhenazes dhe varrimi i të vdekurit, në radhë të parë dhe para çdo veprimi, ai e ka detyrim të mësojë anën nga është Kibla, me çdo rrugë qoftë: me vëzhgim, me të pyetur, ose edhe me çdo lloj shenje nga e cila mund të mësohet ana e Kibles. Madje edhe sikur ai të arrijë të mësojë drejtimin e Kibles nga lëvizja e krahëve të sorrave, ai e ka detyrim të ndjekë këtë dituri që arriti, sepse dituria, në vetvete, është argument, pavarësisht nga shkaqet e nga motivet e saj.

Kur burri nuk arrin të mësojë drejtimin e Kibles, atëherë bazohet në Kiblen që kanë myslimanët në vendin e tyre, bazohet në drejtimin që kanë xhamitë e varrezat e këtij vendi, sepse kjo çështje kështu ka vijuar të trajtohet që prej kohëve të vjetra, me fjalë e me praktikë. Gjithnjë, bazuar mbi këtë praktikë, është bërë edhe ndërtimi i institucioneve ligjore, të cilat është detyrë të ndiqen dhe të veprohet sipas orientimit që ato japin, prandaj nuk lejohet hulumtimi e veprimi sipas mendjes, në kundërshtim me këto institucione ligjore, sepse, në këtë gjendje, ai është hulumtim përballë tekstit, me kusht që ai nuk e di se po vepron gabim dhe në kundërshtim me realitetin, sepse nuk ka mësim nga një institucion, kur vetë institucioni është në kundërshtim me

¹ Të gjithë myslimanët ndajnë një fjalë të përbashkët se drejtimi kah Kibla, është kusht për faljen e namazeve farz. Kjo është arsyeja që ata janë emërtuar “njerëzit e Kibles”. Por myslimanët kanë mendime të ndryshme në lidhje me namazet nafile, pasi shumica mendojnë se drejtimi kah Kibla është kusht edhe për faljen e namazeve nafile, kur duhet të përzgjedhësh anën ku hamendësohet të jetë drejtimi i Kibles. Të tjerë kanë thënë, por ata në fakt janë një numër i vogël, se drejtimi kah Kibla, në mënyrë absolute, nuk është kusht për faljen e namazeve nafile.

realitetin. Këtë e shpjegon shehu El Hamedanij, në librin “Misbàhul Fakijh”: “Patjetër, kur ai ka rrugë nga të cilat mëson drejtimin e Kibles në mënyrë të prerë, në këtë rast atij i lejohet ta lërë Kiblen e vendit dhe të ndjekë rrugën ku e drejton dituria e fakti i prerë.”

Kur për atë është e vështirë të mësojë drejtimin e Kibles me anë të diturisë dhe nuk është në vendin e myslimanëve, atëherë ai hulumton dhe mundohet, sipas mundësisë që ka për të gjetur drejtimin e Kibles, prandaj është i detyruar të veprojë sipas mendimit që ka arritur në saje të shenjave që ka parë. Në lidhje me këtë, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Gjithmonë hulumtimi mjafton, kur nuk dihet nga cila anë është Kibla.*”

Në radhë të parë, ai shikon shenjat e cituara në tekstet ligjore të fesë, si: serioziteti dhe mendimi i prerë janë superior ndaj mendimit më të ulët. Për sa i përket fjalës që thotë i zoti i shtëpisë, ajo fjalë nuk ka vlerë, nëse nuk sjell atë siguri që qetëson shpirtin, sepse fjala e tij mund të mos ketë bazë në dituri, prandaj hulumtimi është farz edhe në një gjendje të tillë.

Pyetje: Përderisa ai është pronari i një sendi, fjala e tij, me tekst dhe sipas praktikës, a është argument?

Përgjigje:

Ai është pronari i shtëpisë së vet, si dhe i sendeve që janë në atë shtëpi, përfshirë pajisje e mjete me të cilat ai manovron, por ai nuk është pronar i Kibles, sepse Kibla qëndron mbi pronën e dikujt, si dhe mbi të drejtën për të qenë pronë e dikujt.

Kur ai nuk ka mundësi as të mësojë drejtimin e Kibles, as me anë diturisë e as me anë të mendimit, madje as me të gjitha rrugët e mundshme, se ku ndodhet Kibla, ai ka detyrim të përsërisë faljen e namazit, duke u drejtuar në të katër anët e horizontit, ose në tre anë, ose në dy anë të horizontit, pra, fal namaz në atë drejtim kah mendohet se mund të jetë Kibla. Ai fal namaz në njërën nga tri anët, ose në njërën prej dy anëve, pikërisht për të qenë në kuadrin e përvetësimit të urdhrit dhe për të arritur realitetin. Në qoftë se koha nuk është e mjaftueshme për të përsëritur faljen e namazit katër here, ose ai s'ka mundësi të falë namazin katër herë, është e mjaftueshme ta falë aq herë sa ka mundësi e fuqi, ose kur koha mjafton për të falur namazin vetëm një herë. Autori i librit "El Xheuàhir" ka thënë: "Kjo është thënia më në zë në mesin fukahave të mëparshëm e të mëvonshëm, të cilët janë mbështetur në tekstet e në hulumtimet e arritura. Madje kjo është thënia me shumë zë, sepse ajo gjendet në shumë libra dhe fukahatë kanë një mendim të përbashkët në lidhje me këtë thënie. Më pas ky autor sjell disa njoftime të transmetuara prej Ehli Bejtit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!) që flasin për këtë çështje.

Çështje

1- Për atë që e ka detyrim të përpiqet e të hulumtojë për gjetjen e drejtimit të Kibles, nëse ai e le me qëllim hulumtimin dhe pas faljes së namazit për të bëhet e qartë se ai ka falur namazin në drejtim të gabuar, ai shikon: në qoftë se devijimi i tij prej Kibles është i vogël, bazuar në transmetimin që do të vijë më poshtë, namazi që ai fali, është i vlefshëm, ndryshe ai namaz është

krejtësisht i zhvlerësuar dhe është si namazi i atij që e ka lënë me qëllim drejtimin kah Kibla.

Në qoftë se ai e ka lënë drejtimin kah Kibla gabimisht, ose nga shkujdesja, por pastaj për atë, gabimi bëhet i qartë, ai shikon: Nëse nuk e ka përfunduar akoma namazin, pjesa e namazit që ka falur deri në këtë çast është e vlefshme dhe menjëherë kthehet në drejtim të Kibles për pjesën që i ka mbetur nga ky namaz dhe, nëse ai e ka përfunduar faljen e namazit, atëherë i gjithë namazi i tij është i vlefshëm, me kusht që devijimi i tij nga drejtimi i Kibles të jetë i vogël. Kështu ka thënë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) në lidhje me një burrë, i cili, pasi ka falur namazin, shikon se ka devijuar drejtimin e Kibles, djathtas ose majtas. Për këtë njeri, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: *“Ai e ka kryer namazin e vet, sepse hapësira ndërmjet lindjes e perëndimit për atë është Kible. Është edhe fjala tjetër e Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) për një burrë që ka falur namazin jo në drejtim të Kibles dhe gjatë kohës që është në namaz, mëson se nuk po fal namazin në drejtim të Kibles. Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Në qoftë se ai është drejtuar ndërmjet lindjes e perëndimit, menjëherë le të kthehet në drejtim të Kibles, në çastin që e mëson dhe, nëse është duke falur namaz me shpinë kthyer Kibles, menjëherë le ta ndërpresë namazin.”*

Në qoftë se pas faljes së namazit për atë bëhet e qartë se devijimi nga drejtimi i Kibles ka qenë i madh e jo i vogël dhe ai e ka falur namazin drejtuar kah lindja, ose kah perëndimi, ose e ka falur namazin me shpinë kthyer Kibles, nëse do të ketë aq kohë sa i mundëson atij përsëritjen e namazit, qoftë edhe kur arrin të falë brenda kohës një rekat të vetëm prej këtij namazi, ai e ka farz ta përsërisë namazin. Por në qoftë se gabimi për atë bëhet i qartë, pasi ka kaluar koha e faljes së namazit, namazi që ai fali është i

vlefshëm dhe ai nuk e ka detyrë që këtë namaz ta falë kaza, ashtu siç ka thënë Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!): “Kur ti fal namaz jo në drejtim të Kibles dhe për ty kjo bëhet e qartë, pasi ke mbaruar faljen e namazit, por vazhdon të jesh brenda kohës për faljen e namazit, menjëherë përsërite faljen e namazit. Por nëse koha për faljen e këtij namazi ka përfunduar, atëherë mos e përsërit.”

Duhet të theksohet se kjo mund të thuhet vetëm për atë që harron, për atë që nuk di, për atë që ka gabuar, për atë që është falur me shpinë kthyer Kibles, etj, pasi ndarjet nuk ndërtohen mbi bazën dhe në mënyrë absolute, as nuk dalin jashtë kësaj baze, me përjashtim të atij që e le hulumtimin e përpjekjen për të gjetur drejtimin e Kibles, kur ka mundësi të hulumtojë, sepse në këtë gjendje ai e ka lënë hulumtimin me qëllim.

2- Është farz kthimi në drejtim të Kibles për faljen e namazeve të përditshme, për faljen e rekateve rezervë, pjesëve të harruara të namazit, për bërjen e dy sexhdeve të harrimit (*sexhdetu s'sehvi*) dhe për çdo namaz farz, ndër të cilët edhe namazin e xhenazes, si dhe për atë që është prezent në dhomën ku është vënë i vdekuri e në varrimin e tij. Gjithashtu, kthimi në drejtim të Kibles është farz, kur theret bagëtia, ose kur bagëtia pritët për kurban.

Autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “Kthimi në drejtim të Kibles, në ligjin e fesë rrëzohet, kur kjo nuk është e mundur.”

Gjithashtu, rrëzohet edhe për faljen e namazit e për veprime të tjera, gjithnjë në raste pamundësie për t’u kthyer në drejtim të saj. Argumenti për këtë është fjala e përbashkët e dijetarëve të fesë, si dhe njoftimet e shumta të transmetuara prej Ehli Bejtit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!). Autori i librit të

lartpërmendur, në mënyrë të përmbledhur, ka thënë: “Namazi nafile, i falur në gjendje të stabilizuar e normale, nuk është i vlefshëm, kur nuk është falur në drejtim të Kibles, sepse ai është adhurim dhe adhurimi nuk kryhet si të vijë për mbarë. Veç kësaj, nuk ka ardhur asnjë njoftim që namazi nafile, në gjendje normale e të stabilizuar, lejohet të falet jo në drejtim të Kibles, madje në ligjin e fesë është haram që namazi nafile të falet jo në drejtim të Kibles.”

Natyrisht që stabiliteti nuk është kusht për faljen e namazit, sepse, kur është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për namazin nafile hipur mbi deve ose mbi ndonjë kafshë, ka thënë: “Po, ngado që të jetë drejtuar.”

Por pamundësia për t’u kthyer në drejtim të Kibles është një gjë dhe kushti për kthimin në drejtim të Kibles në gjendje stabiliteti e normale, është një gjë tjetër. Dallimi mes këtyre dy gjërave është si diferenca mes fjalëve të tua: “Drejtohu kah jugu, kur ti je ulur.”, dhe fjalës tënde: “Drejtohu kah të duash, kur ti je më këmbë.”

3- Kur burri hulumton e përpiqet të gjejë drejtimin e Kibles dhe, sipas mendimit të arritur, nga ky hulumtim ai fal namazin, për këtë njeri lejohet, që në bazë të këtij mendimi të arritur, të falë edhe namazin tjetër dhe nuk e ka detyrim të bëjë një hulumtim të dytë, përveçse kur është mundësia e ndryshimit të hulumtimit, sepse në këtë rast, ai e ka detyrim të hulumtojë e të vëzhgojë me imtësi, ashtu siç veproji edhe herën e parë.

4- Kur dy burra të drejtë dëshmojnë për anën e Kibles, a duhet që ai të mbështetet në dëshminë e këtyre dy burrave, apo ai

ka detyrim të hulumtojë, të vëzhgojë dhe të veprojë sipas hulumtimit të arritur?

Përgjigje:

Dëshmia e dy burrave të drejtë mund të jetë me nijet ligjor, kur njofton për ndijim ose për shikim me sy, si dëshmia e asaj, kur pohon se ky send është pasuri e Zejdut. Por, kur ajo dëshmon prej nxitimit dhe prej hulumtimit, siç është përcaktimi i drejtimit të Kibles, ose i kohës për faljen e namazit, në këtë rast, hulumtimi i saj mohon përshkrimin e argumentit të ligjit të fesë, atëherë ky hulumtim e kjo dëshmi nuk merret në konsideratë.

Bazuar mbi këtë fakt, bëhet e qartë se, kur hulumtimi i njeriut kundërshton hulumtimin e dijetarit, përparësi ka mendimi më i fuqishëm, sepse ai është më i kuptueshëm, prandaj edhe mbështetja bëhet mbi mendimin më të fuqishëm.

5- Kur hulumtimi i dy vetëve për anën e drejtimit të Kibles ka kundërshti, aq sa hulumtimi i njërit nuk bashkohet gjëkund me hulumtimin e tjetrit, megjithëkëtë atij i lejohet ngrënia e mishit të kurbanit të tjetrit, ose e mishit që tjetri ka therur jo në drejtim të Kibles, sepse kush e le kthimin në drejtim të Kibles, ngaqë nuk e di, ose ngaqë harron, është hallall ngrënia e mishit të therur prej tij. Po kështu qëndron edhe çështja e namazit të xhenazës që ai fal, sepse këshillimi për vlefshmërinë e namazit te ata që janë duke falur namazin, nuk është këshillë në përgjithësi.

* * *

VESHJA E ATIJ QË FAL NAMAZIN

Rroba e tejdukshme

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Mos fal namaz me rrobë të tejdukshme.”, domethënë rrobë të hollë, që lejon të shihet çka nën të.

I është thënë Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Burri fal namaz vetëm më një këmishë.” Ai tha: “Nëse ajo është e trashë, s’ka problem.”

Kur namazi nuk lejohet të falet pa rrobë të trashë, në mënyrë absolute, nuk lejohet të falet pa rrobë.

Lëkura e ngordhësirës

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për lëkurën e ngordhësirës, a duhet të vishet ajo për të falur namaz, kur është e regjur. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Jo, edhe sikur të jetë regjur shtatëdhjetë herë.”

Veshja prej kafshëve që nuk u hahet mishi

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Namazi i falur me rroba të përgatitura nga leshi i kafshëve që është haram t’u hahet mishi, si dhe qimet, leshi, lëkura, urina e bajgat e këtyre kafshëve, çdo gjë prej këtyre kafshëve, është prishës i namazit. Prandaj namazi i falur me të tilla rroba, nuk pranohet, madje nuk pranohet as kur mbi ato ka veshje të përgatitura prej kafshëve që Allahu ka lejuar të hahen.”

O Zurara, mbaje mend këtë prej të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): “Çdo kafshë, së cilës i hahet mishi, namazi i falur me rrobat e përgatitura prej leshit të saj, si dhe urina e saj, fijet, bajgat dhe qumështi i saj, çdo gjë prej kësaj kafshe është hallall, kur ti e di se ajo është pastruar, sepse dhe atë kafshë e ka pastruar therja (sipas rregullit të ligjit të fesë). Në qoftë se kafsha është prej atyre kafshëve që është e ndaluar të hahet, ti e ke haram të hash mishin e saj, gjithashtu edhe namazi i falur me çdo rrobë të përgatitur prej pjesëve të kësaj kafshe, është i prishur, qoftë ajo e pastruar me therje, ose jo.”

Mëndafshi

Në shumë transmetime përmenden paragrafët vijues: “Është haram të falet namazi me rroba të punuara me mëndafsh puro.” Nuk bën që burri të veshë rroba mëndafshi, përveçse në luftë. Gruaja ka të drejtë të veshë rroba mëndafshi, me përjashtim të rastit kur është në ihram për të kryer Haxh. Gjithashtu, gruaja lejohet të mbajë unaza prej floriri dhe të falë namaz me to.”

Floriri

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Burri as nuk vesh flori dhe as nuk fal namaz me të.”

Gruaja, fytyra dhe dy shputat e duarve

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për pjesët e trupit që le gruaja të duken. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Fytyrën dhe dy shputat e duarve.”

Gjithashtu, Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) i është thënë: “Cilat pjesë të trupit të gruas ka hallall burri të shikojë, kur nuk është i afërm i saj “muhrim” (që nuk mund të martohet me të)?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Fytyrën, dy shputat e duarve dhe dy këmbët.”

Gjithashtu, është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për gruan që fal namaz me nikab (me mbulesë fytyre) dhe ai tha: “Kur ajo zbulon vendin e sexhdes (ballin e hundën), nuk ka ndonjë problem.”

Në hadith tregohet se Selman El Farisij ka parë dorën e përgjakur të Zahrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Xhabir El Ensarj herë e ka parë fytyrën e saj të verdhë dhe herë tjetër të kuqe.

Sendi i rrëmbyer

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), i tha Kumejlit: *“O Kumejl, shiko mirë me çfarë fal namaz dhe mbi çka e fal namazin. Nëse rroba nuk është e lejuar, nuk ka pranim namazi.”* Çështja qëndron kështu: Ndalimi i përdorimit të gjësë së rrëmbyer është vërtetuar ndër domosdoshmëritë e fesë.

Ka shumë hadithe të tjera të transmetuara prej Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*), që flasin për veshjen e atij që fal namaz.

Të gjitha këto hadithe i ka mbledhur autori i librit “El Uesail” dhe zënë deri 200 faqe në një botim të “El Islami”jetu uel Muham’medij”, të shtypur në qytetin Kum, Iran.

Fukahatë

Fukahatë, të mëparshmit e të mëvonshmit, janë bashkuar në një fjalë të vetme për të dhënë sentencën (fetvanë) për gjithçka që tregojnë këto transmetime. Prej këtyre transmetimeve dhe prej shumë transmetimeve të tjera, ata kanë arritur në një përfundim të përbashkët.

Po e japim në mënyrë të përmbledhur mendimin e tyre:

Burri e ka farz që, në namaz, të mbulojë në mënyrë absolute pjesët e trupit që nuk lejohen të shihen (*auret*), qoftë kur është, ose nuk është ndonjë i rritur që e shikon, sepse mbulimi i këtyre pjesëve është kusht për vlefshmërinë e namazit. Kur burri e le mbulimin e këtyre pjesëve, edhe pse ka mundësi e fuqi ta bëjë këtë

gjë, namazi i tij është i prishur, qoftë edhe atëherë kur fal namaz i vetmuar. Gjithashtu, burri e ka farz që këto pjesë t'i mbulojë prej shikimit të të rriturit, edhe atëherë kur nuk fal namaz.

Aureti i burrit nga përpara është penisi dhe dy testikulat, kurse nga prapa është pjesa e njohur e rrumbullakët. Është mustehab i shkallës Muek'kedeh (i përforcuar deri afër shkallës së farzit) që burri të mbulojë pjesën ndërmjet kërthizës e gjurit.

Gruaja ka farz të mbulojë të gjithë trupin e saj, me përjashtim të fytyrës, dy shputave të duarve dhe shpinës së dy këmbëve, qoftë kur është duke falur namaz, qoftë kur është jashtë namazit, kur aty gjendet një shikues i rritur, kurse në namaz mbulimi gruas është absolut, madje edhe atëherë kur gruaja e fal namazin e vetmuar. Gruaja ka të drejtë, që në vetmi të plotë, jashtë namazit, të bëjë ç'të dëshirojë. Gjithashtu, me burrin e saj, ka të drejtë të bëjë ç'të dëshirojë ai dhe ç'të dëshirojë ajo. Gruaja e ka hallall të shikojë te gruaja tjetër atë ç'ka është hallall për burrin të shikojë te burri tjetër, domethënë çdo pjesë të trupit, përveç dy pjesëve që është detyrë të mbulohen (*es seutejni*). Për burrin e afërm me gruan është hallall të shikojë te ajo çka është hallall të shikojë gruaja te gruaja, domethënë çdo gjë, me përjashtim të *es'seutejni*, por me kusht të besnikërisë e të sigurisë se nuk do të kalohet në veprime haram. Më e pëlqyeshme është që burri të mos shikojë burrin dhe gruaja të mos shikojë as të afërmin e asnjë grua tjetër, qoftë ajo nëna ose e bija, domethënë të mos shikojë nga kërthiza deri te gjuri.

Këtu është me vlerë të theksojmë se ky rregull ka miratimin e të gjithë shkollave juridike (medh'hebeve) islame dhe konsiston:

“Ajo që lejohet të preket, lejohet të shikohet dhe ajo që është haram të shikohet, është haram të preket.”

Asnjë prej fukahave të medh’hebeve nuk ka pretenduar varësinë mes lejimit të shikimit dhe lejimit të prekjes. Burri e ka hallall të shikojë fytyrën e një gruaje të huaj dhe dy shpuat e duarve të saj. Gjithashtu, edhe gruaja e ka hallall të shikojë burrin e huaj për të, por prekja është e lejuar vetëm në raste domosdoshmërie, siç mund të jetë mjekimi i të sëmurit dhe shpëtimi i atij që është duke u mbytur. Padyshim që Islami ka bërë lehtësim për gratë plaka dhe të moshuara. Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Atyre u lejohet të zbulojnë fytyrën, një pjesë të flokëve e të krahëve, ashtu siç është e zakonshme për gratë e moshuara.”

Për këtë realitet tregojnë hadithet e transmetuara prej Ehli Bejtit, por me kusht që ky zbulim të mos jetë në formën e zbukurimit, por vetëm lehtësim që ato të dalin për nevojat e tyre. Gjithsesi dhe pavarësisht nga ky lejim, mbulimi është shumë më i mirë edhe për të moshuarat. Patjetër që ky rregull është në përputhje të plotë me atë çka urdhëron ajeti 60 i sures “En Nur”:

“وَالْقَوَاعِدُ مِنَ النِّسَاءِ اللَّاتِي لَا يَرْجُونَ نِكَاحاً فَلَيْسَ عَلَيْهِنَّ جُنَاحٌ أَنْ يَضَعْنَ ثِيَابَهُنَّ غَيْرَ مُتَبَرِّجَاتٍ بِزِينَةٍ
وَأَنْ يَسْتَغْفِفْنَ خَيْرٌ لَهُنَّ” ط

“Për gratë e moshuara që nuk kanë më shpresë të martohen, nuk është mëkat që ato të lënë rrobat e tyre, por jo me qëllim që të nxjerrin në dukje huret e tyre e as për zbukurim, megjithëse më mirë për ato është të jenë të përmbajtura.”

Cilësitë e veshjes

Pas këtij shpjegimi dobisjellës, me lejen e Allahut, rikthehemi në veshjen për të falur namaz dhe në cilësitë e kësaj veshjeje. Nuk lejohet falja e namazit me veshje të përgatitur prej kafshëve që nuk u hahet mishi, siç janë bishat e të ngjashmet me to, madje edhe sikur të jenë të pastra. Kur mbi trupin e njeriut, ose mbi rrobat e tij bie një qime prej maces, ai ka detyrë ta heqë këtë qime, para se të falë namazin, megjithëse ai e di se macja është e pastër, madje edhe rroba kur është përgatitur prej pjesëve të kafshës detare që nuk u hahet mishi, në mënyrë absolute, nuk lejohet që me ato rroba të falet namazi. Namazi është i vlefshëm, kur njeriu në trup e në rroba ka gjak tartabiqesh, morrash, pleshtash, si dhe flokë, qumësht e djersë njeriu.

Gjithashtu, namazi nuk është i vlefshëm, kur falet me rroba të përgatitura prej lëkure cofëtinash, qoftë ajo edhe kafshe që i hahet mishi, qoftë kur lëkura e saj është e regjur ose jo. Por namazi, si rregull bazë, lejohet të falet me leshin, flokët, qimet e puplat e kafshëve e të shpendëve të ngordhura që u hahet mishi, duke ditur se gjithçka që është prej këtyre kafshëve e shpendëve e prej leshit të tyre, si dhe vetë ato cofëtina janë të pastra. Dalluesi për këtë çështje është teksti i qartë dhe që nuk pranon asnjë interpretim. Është vërtetuar se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“S’ka problem që namazi të falet me rroba të punuara prej leshit të cofëtinave, sepse leshi nuk ka shpirt.”*

Justifikimi për mospasje shpirti nënkupton lejimin e faljes së namazit me çdo gjë që nuk ka shpirt prej pjesëve të trupit të kafshës së ngordhur.

Më sipër kemi parë fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “*Namazi nuk lejohet të falet në asgjë të kafshës që nuk i hahet mishi, qoftë ajo e pastruar ose jo.*”

Kur kafsha që i hahet mishi, pastrohet, namazi i falur mbi lëkurën, leshin, flokët, fijet e puplat e saj, është i vlefshëm.¹

Burrave nuk lejohet të veshin rroba të punuara me mëndafsh puro, qoftë kur burri fal namaz, qoftë kur ai është jashtë namazit. Në qoftë se rroba e mëndafsh të është prej llojit me të cilat nuk janë kusht që të plotësohet falja e namazit, si kësula e rripi i pantallonave, veshja e këtyre lloj rrobave, në mënyrë absolute, lejohet, kur ato janë të përziera me ndonjë material tjetër përveç mëndafshit, edhe nëse mëndafshi është dominues në atë rrip ose kësulë, por me kusht që materialet e tjera të kësaj veshjeje të mos jenë të konsumuara deri në atë shkallë sa, në veshjen në fjalë, të vërtetohet emri veshjeje prej mëndafshi pa asnjë kusht. Lejohet të veshin rroba prej mëndafshi puro luftëtari dhe ai që është i detyruar nga nevoja të veshë rroba mëndafshi.

Për sa u përket grave, ato e kanë hallall të veshin rroba të mëndafshita, kur falin namaz dhe jashtë namazit, sipas dëshirës,

¹ Në kapitullin e veshjes së rrobave të mëndafshita, fukahatë kanë dhënë fetva për lejimin e veshjes së rrobave të mëndafshita në namaz e jashtë namazit për pjesëtarët e familjes së Ehli Bejtit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!). Në njoftimet e transmetuara prej tyre, thuhet: “Ne njerëzit e familjes së Muhamedit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) veshim rroba të mëndafshita. Hyseni (paqja qoftë mbi të!), kur u vra, kishte veshur një xhybe të mëndafsh të, ishte prej mëndafshi që vishnin imamët e pastër. Fukahatë kanë dhënë fetva për lejimin e veshjes së këtij lloji mëndafshi (*el khaz'z*), i cili, siç thuhet në hadith, merrej prej një kafshe detare katërkëmbëshe, prej llojit të qenve të detit. Përsa i përket mëndafshit që njihet në ditët e sotme, veshja e tij është haram për burrat në namaz e jashtë namazit, sepse ai është mëndafsh i mirëfilltë. Referohu në librin “Mexhmaul Bahrejn”.

qofshin rroba të punuara me mëndafsh puro ose me mëndafsh të përzier me materiale të tjera.

Natyrisht që burri ka të drejtë të përdorë shtroje mëndafshi dhe të mbulohet me rrobë mëndafshi, gjithashtu, burri ka të drejtë të mbajë një copë të mëndafshit si ruajtëse, po kështu edhe oficeri nuk del në syrin e njerëzve i veshur me mëndafsh.

Në mënyrë absolute është haram që burrat të mbajnë sende prej floriri puro ose të punuara me flori të përzier me metale të tjera, kur falin namaz dhe jashtë namazit. Nën prizmin e këtij rregulli, shikohet dallimi mes mëndafshit dhe floririt: lejohet veshja e mëndafshit, kur është i përzier me material tjetër dhe është e ndalur në mënyrë absolute veshja e sendeve prej floriri, por patjetër që lejohet të mbahen me vete para prej floriri, orë floriri dhe veshja e dhëmbëve me flori. Për sa u përket grave, për ato lejohet të veshin e të zbukurohen me sende të punuara prej floriri, kur falin namaz dhe jashtë namazit.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Për gruan lejohet që ajo të vërë unazë prej floriri e të falë namaz me të, por kjo është haram për burrat.”

Gjithashtu, është kusht që veshja të jetë e lejuar dhe jo e rrëmbyer, sepse veprimi me pasurinë e tjetrit, pa lejen e tij, është haram, prandaj nuk lejohet adhurimi e afrimi te Allahu me atë çka është haram dhe është veprim i urryer te Allahu. Në qoftë se njeriu fal namaz me veshje të grabitur e të rrëmbyer, ngaqë është i shkujdesur, ose ngaqë harron, namazi që ai fal është i vlefshëm, sipas hadithit të dëgjuar profetik, në të cilin thuhet: “*Harresa është ngritur prej umetit tim.*” Nëse burri fal namaz dhe nuk e di që rroba e tij është e grabitur, ose e rrëmbyer, megjithëse ai e di se gjëja e

grabitur është haram, namazi që ai fali me këtë rrobë është i pranuar. Në qoftë se ai e di se rroba e tij është e grabitur dhe harron që e grabitura është haram, në këtë rast ai shikon: Nëse mosdija e tij është për shkak të pamundësisë, namazi i tij është i vlefshëm, por, nëse mosdija është për shkak neglizhence, atëherë namazi i tij nuk është i vlefshëm dhe ai ka detyrë ta përsërisë faljen e namazit, sepse nga pikëpamja logjike, pamundësia është justifikim, por nuk është justifikim neglizhenca.

Në qoftë se ai e di problemin e objektit dhe dispozitën e ligjit të fesë, është si personi që e di se kjo gjë është e grabitur dhe e grabitura është haram, por ai nga nevoja është i detyruar të manovrojë me gjënë e grabitur, siç mund të jetë i burgosuri në një vend të rrëmbyer. Namazi i falur prej tij është i vlefshëm, me kusht që me namazin të mos pretendojë shtim veprimi përveç atij që i lejohet për shkak të domosdoshmërisë së detyruar, ashtu siç ndodh në të shumtën e rasteve.

Thënë më qartë e më gjerë, rezulton që ligji i fesë nuk e ndalon faljen e namazit me rrobë të grabitur, por ai ka ndaluar grabitjen e rrëmbimin në mënyrë absolute, pavarësisht nga mënyra e forma që kryhet rrëmbimi e grabitja. Prej këtij ndalimi, logjika ka konkluduar se sendi i grabitur, e prish namazin dhe se me gjënë e grabitur e të rrëmbyer pengohet afrimi te Allahu i Lartësuar. Nga ky shpjegim arrihet në përfundimin se, kur gjëja e rrëmbyer ka lidhje me namazin dhe, kur vërtetohet se rroba është e grabitur, kemi të bëjmë me një cilësim të ardhur rastësisht dhe është jashtë karakterit të namazit, sepse namazi, në peshoren e tij, rëndon shumë, kurse me karakterin e tij, namazi është i dashur. Por ky individ u bë i padëshiruar në namaz për shkak të gjësë së grabitur dhe për shkak se ai ka lidhje me rrëmbimin, që është

veprim i urryer te Ligjvënësi, atëherë rezulton që veprimi dhe gjëja e urryer, është e rastësishme dhe nuk është e vetvetishme.

Pa dyshim që veprimi i urryer e i përbuzur kryhet me qëllim e me vetëdashje. Por nëse nuk ka as qëllim e as vetëdashje, e urryera nuk ekziston që në bazë dhe, kur zhduket e urryera, atëherë namazi i falur me gjënë e grabitur, është i vlefshëm për atë që nuk di, për atë që harron dhe për atë që është i detyruar nga nevoja të përdorë gjënë e grabitur.

Kështu që rrëzohet çdo kusht me rrëzimin e angazhimit të obligimeve, prej të cilave është nxjerrë kushti. Unë përsëris konceptin për një ndryshim të dytë, i cili konsiston në atë që dallimi është shumë i madh mes faktit kur ai të thotë ty: “Mos fal namaz me rrobë të grabitur!” dhe mes faktit, kur ai të thotë: “Mos vish rrobë të grabitur!”

Në rastin e parë, ndalimi ka lidhje tërësisht e kryekëput vetëm me namazin, kur dihet se ndalimi që ka lidhje me adhurimin tregon prishjen e adhurimit. Bazuar mbi këtë rregull, nuk lejohet falja e namazit me gjënë e grabitur dhe, është barabartë, qoftë kur ai e vesh rrobën e grabitur me qëllim, ose kur nuk e ka ditur që rroba është e grabitur, ose nga harresa, ose ka qenë i detyruar nga nevoja të veshë rrobë të grabitur. Këtu bën përjashtim rasti kur argumenti specifik tregon vlefshmërinë e namazit të falur me rrobën e grabitur.

Për sa i përket ndalimit, në rastin e dytë, shihet qartë se ai ka lidhje parësore vetëm me rrobën dhe, në radhë të dytë, me rastësinë për faljen e namazit me rrobë të grabitur. Por kur nuk plotësohet ndalimi subjektiv për veshjen, për shkak se ai nuk e ka

ditur që rroba është e rrëmbyer, ose për shkak se ka harruar punën e rrobës, ose ngaqë e ka veshur rrobën e grabitur, i detyruar nga nevoja e domosdoshme, në këtë gjendje, rrëzohet edhe ndalimi rastësor, jo substancial për faljen e namazit me dhunë, sepse dega nuk mund të jetë më shumë se origjina.

Për sa i përket obligimit për pastërtinë e rrobës e të trupit për faljen e namazit, për këtë çështje kemi vënë një nëntitull të pavarur në kapitullin “Pastrimi” (tahàret), prandaj referohu në këtë kapitull.

Çështje

1- Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që është lakuriq, ngaqë nuk ka rrobë të veshë. Ndërkaq vjen koha për faljen e namazit. Si duhet të veprojë ky njeri? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai e fal namazin më këmbë, kur nuk e sheh asnjë njeri, por, nëse atë e sheh dikush, ai e fal namazin ulur.”

Me këtë thënie kanë punuar fukahatë dhe kanë arritur në një përfundim të përbashkët: Ai bën ruku e sexhde me shenjë me kokë, nëse ka mundësi, ndryshe ai e bën shenjën për ruku e për sexhde me dy sytë.

2- Kur burri fal namaz me rrobë të punuar nga cofëtina, për shkak se nuk e di, ai nuk e ka farz ta përsërisë faljen e namazit, sepse pastërtia e rrobës dhe e trupit për faljen e namazit, është kusht, krahas ditorisë dhe jo krahas realitetit. Por në qoftë se ai fal namaz me rrobë të grabitur nga harresa, ai ka detyrim ta përsërisë

faljen e namazit brenda kohës ose jashtë saj, sepse harresa e papastërtisë nuk është justifikim, pasi, në radhë të parë, ka vend që të mësohet prania e papastërtisë, nëse ajo është prej qenieve që s’kanë gjak të rrjedhshëm, namazi i falur me këtë papastërti është i vlefshëm, madje edhe kur njeriu harron se mbart këtë papastërti, sepse ajo, në fakt, nuk është papastërti.

3- Më sipër kemi thënë se namazi nuk është i vlefshëm kur është falur me ndonjë rrobë të punuar prej pjesëve të kafshës që nuk u hahet mishi. Por nëse atij i lind ndonjë dyshim, mos vallë kafsha është prej atyre që u hahet mishi, ose prej ndonjë lloji tjetër, a lejohet të falet namaz me këtë rrobë?

Përgjigje:

Në radhë të parë, duhet të dimë patjetër: A është kusht për vlefshmërinë e namazit mosqenia e veshjes prej kafshës që nuk i hahet mishi, apo kafsha që nuk i hahet mishi është ndaluesi? Bazuar mbi pjesën e parë të pyetjes, namazi i falur me të dyshuarën, nuk është i vlefshëm, për shkak se dyshimi në kushtin nënkupton edhe dyshimin në të kushtëzuarin. Me një fjalë, patjetër duhet të arrihet kushti.

Mbështetur në pjesën e dytë të pyetjes, është e qartë se namazi është i vlefshëm, sepse, si bazë është mosndalimi. Shejkh El Hamedànij, në librin “Misbàhul Fakijh”, ka thënë: “Nuk duhet menduar se atë çka njoftojnë të gjitha transmetimet e ardhura për kapitullin tonë, ndalojnë veshjen e përgatitur prej pjesëve të kafshës që nuk i hahet mishi për të falur namaz me atë veshje, sepse nuk ka kusht për mosqenien e asaj rrobe. Gjithashtu, është

nxjerrë konkluzioni prej hadithit: “Njerëzit kanë gjerësi veprimi për gjërat që nuk i dinë.”

E ngjashme me këtë ose afërsisht si kjo, është edhe çështja e shkruar tekstualisht në librin “El Medàrik”: “Mund të thuhet: Kusht është mbulimi i auresit dhe ndalimi ka lidhje me ndalimin për faljen e namazit me veshje të përgatitura prej kafshës që nuk i hahet mishi. Por kjo nuk vërtetohet ndryshe veçse duke e ditur se veshja është e këtille. Gjithashtu, kjo vërteton atë që ka thënë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Në çdo send ka hallall e haram dhe ai send për ty gjithmonë është hallall, derisa të mësosh për haramin e mirëfilltë.” Gjithnjë mbi këtë bazë është edhe çështja e dyshimit në kafshën që i hahet mishi e në të tjera, ai mbetet dyshim te ndaluesi dhe jo te kushti, prandaj dyshimi shkon në bazën e mospenguesit dhe ai fal namazin.

Gjithashtu, mbi këtë bazë ne bëjmë të ecë origjina e mospenguesit për vlefshmërinë e namazit me dyshim, kur dyshimi është i ardhur prej floririt dhe të namazit me dyshim, kur dyshimi është i ardhur prej mëndafshit puro.

4- Kur mbulesa, ose rroba është prej mëndafshi puro, ose është e grabitur, ose prej cofëtinës, në qoftë se ai është i detyruar nga nevoja të veshë këtë rrobë për shkak të të ftohtit, ose sëmundjes dhe prej shkaqeve të tjera, ai fal namaz me këtë rrobë dhe namazi që ai fali është i vlefshëm, sepse në këtë gjendje s’ka ndonjë pengesë për afrimin te Allahu me anë të namazit, veç kësaj, domosdoshmëritë lejojnë gjërat e ndaluara.

Kur ai nuk është i detyruar nga nevoja të veshë një rrobë të tillë, ai është i detyruar ta lërë atë dhe fal namazin lakuriq, sepse në ligjin e fesë ai është i penguar të veshë atë rrobë dhe, kur

gjendja është e tillë, i penguari nga ligji i fesë, është si i penguari logjikisht, edhe sikur teksti të mos tregojë se mbulesa, veshja, nuk është kusht për faljen e namazit, ose kur burri s'ka mundësi për të pasur mbulesën. Të gjithë fukahatë kanë një mendim të përbashkët në lidhje me këtë çështje. Padyshim që fjala për mosqenien detyrim që namazi të falet në drejtim të Kibles, sepse pamundësia për realizimin e kushtit, nënkupton pamundësinë edhe për realizimin e të kushtëzuarit.

* * *

VENDI KU NJERIU FAL NAMAZIN

I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Për mua toka është bërë vend i pastër, ku unë fal namaz.” Në një hadith tjetër ka thënë: “Për mua toka është bërë vend ku unë bëj sexhde dhe dheu i saj është bërë pastrues, kudo që mua të më arrijë koha e faljes së namazit, unë aty e fal namazin.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “E gjithë toka është vend ku falet namaz, me përjashtim të nevojtores, varrezave dhe banjës.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i ka veçuar këto tre vende në rrugë keraheti dhe jo se është haram.

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se kuptimi i fjalës “vend” do të thotë: vendi ku qëndron ai që fal namaz dhe hapësira që ai zë me trupin e tij. Në lidhje me vendin për faljen e namazit duhet të merren në konsideratë disa çështje:

1- Vendi të jetë i lejuar, jo i rrëmbyer. Ato që ne përmendëm në lidhje me veshjen, janë vepruese edhe për vendin e faljes, pa asnjë dallim.

2- Vendi të mos jetë i ndotur me papastërti, që mund të depërtojnë në rrobat e në trupin e atij që fal namaz, sepse pastërtia, ashtu siç kemi parë më sipër, është kusht për faljen e namazit, gjithashtu, do të thotë se njeriut i lejohet të falë namaz me rroba të ndotura me papastërti, ose mbi një vend të ndotur me papastërti, në kushte lagështie, kur papastërtia i ngjitet njeriut në trup e në rroba, me përjashtim të vendit ku vihet balli për të bërë sexhden, pasi siç do të vijë më poshtë, sexhdeja është kusht të bëhet vetëm mbi një vend të pastër.

3- Vendi të jetë i qëndrueshëm. Në lidhje me këtë, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Burri nuk fal asnjë namaz farz kaluar, me përjashtim të rasteve kur është i detyruar nga domosdoshmëria.”*

Prej këtij transmetimi, fukahatë kanë arritur në një përfundim të përbashkët se qëndrueshmëria e vendit, në mënyrë absolute, është farz. Por ata e kanë anuluar këtë kusht në gjendjet e emergjencave dhe të gjendjeve të imponuara.

4- A lejohet që burri dhe gruaja të falin namaz përkrah njëri-tjetrit, ose gruaja të dalë përpara burrit gjatë faljes së namazit, pa pasur mes tyre ndonjë ndarës, ose kur mes tyre ka një largësi të barabartë me dhjetë krahë?

Përgjigje:

Për këtë çështje ka dy thënie: Njëra për moslejim, pasi, kur burri e gruaja falin namaz së bashku dhe fillojnë faljen e namazit në të njëjtën kohë bri njëri-tjetrit, ose gruaja del përpara burrit, namazi i të dyve është i prishur. Por nëse njëri prej tyre ka filluar faljen e namazit më përpara se tjetri, namazi i tij është i vlefshëm, por është prishur namazi i atij që ndjek atë në namaz, përveçse kur mes tyre ka një ndarës, ose ata të dy janë larg njëri-tjetrit dhjetë krahë. Ky është mendimi i shumicës së fukahave të mëparshëm.

Thënia e dytë është lejimi dhe vlefshmëria e namazit krahas kerahetit, kur mes burrit e gruas s'ka ndarës dhe nuk është largësia e lartpërmendur prej dhjetë krahësh. Nëse keraheti është ngritur për njërin prej atyre të dyve. Të këtij mendimi, janë shumica e fukahave të mëvonshëm,¹⁽¹⁾ ndër të cilët autori i librit "El Xhevàhir", i cili ka thënë: "Lejimi i mbështetur mbi kerahetin është i ngjashëm me bazat e medh'hebit, duke shtruar argumente dhe fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: "Nuk ka problem që gruaja të falë namaz duke ndjekur një burrë, i cili është duke falur namaz."

Është pyetur Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) edhe për një grua që fal namaz së bashku me burrat dhe prapa e përpara saj ka safe. Si është namazi i saj? Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Namazi që ajo fali, është kryer dhe ajo nuk i ka prishur namazin askujt. Prandaj as burrat nuk e përsërisin faljen e namazit."

¹ Ne jemi mbështetur në librin "El Medàrik" dhe në librin "El Xheuàhir", për pavlefshmërinë e këtij namazi te të mëparshmit dhe për vlefshmërinë e tij te të mëvonshmit.

Për sa u përket transmetimeve të tjera, që flasin për ndarësin apo perden, nuk vlejnë për gjë tjetër veçse për të treguar se falja e gruas së bashku me burrat është *kerahet*.

Më pas, ky autor, duke përmendur këto transmetime, i diskuton ato me fjalë të gjata dhe i sjell si dëshmuese për të vërtetuar se namazi që fal gruaja së bashku me burrat, është detyrë të konsiderohet *kerahet* dhe jo *haram*. Fjalën e tij të gjatë, autori i lartpërmendur, e përfundon me fjalinë vijuese: “Nga e gjithë kjo që u tha, për ty u bë e qartë se, në të vërtetë, s’ka vend për të hequr dorë prej fjalës që falja e namazit prej gruas së bashku me burrat, është vetëm *kerahet*.”

Me fjalë të përmbledhura, kushtet e vendit ku burri ose gruaja fal namaz, janë: Falja e namazit lejohet në çdo vend të qëndrueshëm, jo të lëkundshëm, të pastër nga papastërtitë që i ngjiten njeriut në rroba e në trup, vendi të jetë prej atyre ku lejohet të falet namazi, ndër të cilat edhe sinagogat e jehudive dhe kishat e të krishterëve.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për namazin e falur në sinagoga e në kisha, nëse ishte i pranueshëm ky namaz. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Fal namaz në to. Ti i ke parë ato sa të pastra janë. A nuk e ke lexuar Kur’anin:

“قُلْ كُلٌّ يَعْمَلُ عَلَىٰ شَاكِلَتِهِ فَرُؤُكُمْ أَغْلَمُ مِمَّنْ هُوَ أَهْدَىٰ سَبِيلًا”

“Thuaj: secili vepron sipas rrugës së vet dhe Zoti juaj e di shumë mirë se cili është në rrugën më të drejtë.” (Sure “El Isra”, ajeti 84)

Vendi ku vihet balli për të bërë sexhde

Një burrë i tha Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!): “Më thuaj se mbi ç’gjë lejohet e nuk lejohet të bëhet sexhde.” Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) iu përgjigj: “Sexhdja nuk lejohet të bëhet mbi ndonjë material tjetër përveç tokës. Në përgjithësi, sexhde lejohet të bëhet mbi materiale që dalin prej tokës, me përjashtim të gjërave që hahen ose vishen.”

Burri i tha përsëri: “Kurban t’u bëfsha! “Ku qëndron shpjegimi për këtë?” Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) iu përgjigj: “Sexhdja është nënshtrim e përulje ndaj Allahut të Lartësuar, prandaj sendi mbi të cilin bën sexhde, nuk duhet të jetë prej gjërave që hahen e që vishen, sepse bijtë e kësaj bote janë skllëvër të asaj që ata hanë e veshin, ndërsa ai që bën sexhde, është në adhurim të plotë për Allahun e Lartësuar. Prandaj, kur ai bën sexhde, nuk duhet ta vërë ballin e tij mbi të adhuruarat e bijve të kësaj bote, të cilat i mashtrojnë ata me ngacmimet e veta.”

Është pyetur Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) për një burrë që e mundon nxehtësia e tokës, kur fal namaz dhe ai s’ka fuqi të bëjë sexhde. A lejohet ai të verë rrobën e vet, kur ajo është pambuk ose prej liri?” Ai (Paqja qoftë mbi të!) iu përgjigj: “Kur është i detyruar nga domosdoshmëria, le ta bëjë.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Sexhdja mbi dheun e varrit të Hysenit (Paqja qoftë mbi të!) ndriçon deri në shtatë tokë. Kush ka me vete një kokërr tesbijhu prej dheut të varrit të Hysenit (Paqja qoftë mbi të!), ai shkruhet si ai që e dëlir Allahun e Lartësuar nga të gjitha mangësitë e të metat.” (Thotë: “*Subhàne-ll’Ilàh*”) edhe kur ai nuk thotë “*Subhàne-ll’Ilàh*”.

Fukahatë

Duke punuar me këto transmetime, fukahatë kanë thënë: Është kusht që vendi ku vihet balli për të bërë sexhde, duhet të jetë tokë ose prej gjërave që dalin prej tokës, me kusht që të mos jenë gjëra që hahen, ose që vishen. Kur njeriu e ka të pamundur të gjejë ndonjë gjë tjetër, përveç hirit ose gëlqeres, ai nuk bën sexhde as mbi hirin e as mbi gëlqeren, por në raste pamundësie për të gjetur tokë, është më e pëlqyeshme që ai të bëjë sexhde mbi xham ose mbi një copë kristali.

Gjithashtu, vendi i sexhdes nuk lejohet të jetë as metal, as gur i çmuar e as flori, sepse metali, edhe pse del prej tokës dhe është krijuar në tokë, është i rrallë e me vlerë te njerëzit. Pikërisht kjo cilësi e tij e ka nxjerrë metalin prej emërtimit tokë.

Gjithashtu, vendi i sexhdes është kusht të jetë i pastër dhe të mos jetë me papastërti që ngjiten mbi rrobat e mbi trupin e atij që bën sexhde. Vendi i sexhdes duhet të jetë i lejuar dhe jo i rrëmbyer.

Çështje

Sexhdja lejohet të bëhet mbi letër. Kur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) u pyet, nëse lejohet të bëhet sexhde mbi letër, ai tha: "Lejohet."

Dëshmori i dytë në librin "El Lum'atu" ka thënë: "Bazuar në fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst të gradës "Sahijh", sexhde lejohet të bëhet mbi letër."

Me këtë thënie, mbështetur në fjalën e përbashkët të fukahave dhe mbi tekst, ka dalë prej bazës së ligjit të fesë ai që shprehet për moslejimin e bërjes së sexhdes mbi letër, duke dhënë shpjegimin se letra është e përbërë prej dy pjesësh, mbi të cilat nuk

lejohe të bëhet sexhde, që janë gurët gëlqerorë, si dhe kripërat minerale të ngjitura mes tyre me materiale pambuku, ose liri, ose materiale të tjera të ngjashme.”

2- A është apo nuk është e vlefshme të bëhet sexhde mbi fajancë?

Përgjigje:

Në lidhje me këtë çështje nuk ka ardhur tekst i veçantë, as negativ e as pozitiv. Autori i librit “Miftàhul Keràmeh”, ka cituar mendimin e shumë fukahave, të cilët lejojnë të bëhet sexhde. Madje disa prej tyre kanë thënë: “Për këtë çështje ne nuk dimë të ketë ndonjë kundërshtim.”

Një tjetër ka thënë: “Kjo çështje është përfshirë në sprovën.” Megjithëkëtë, nuk është cituar prej askujt nga të mëparshmit ndonjë fjalë për ndalim.”

3- Kur burri bën sexhde mbi një send për të cilin ai e di se është material, mbi të lejohe të bëhet sexhde, por më pas për të bëhet e qartë e kundërta, namazi i tij është i vlefshëm, sipas hadithit: *“Namazi përsëritet vetëm prej pesëve gjërave: pastërtia, koha e faljes, Kibla, rukuja dhe sexhdja.”*

Me lejen e Allahut, për këtë hadith do të flitet më poshtë me hollësi.

4- Burri është duke falur namaz, por humb materialin mbi të cilin lejohe të bëhet sexhdja. Si të veprojë?

Përgjigje:

Kur është brenda kohës së mjaftueshme, ai ka detyrë ta ndërpresë faljen e namazit dhe ta rifillojë namazin nga e para, sepse supozohet se brenda kësaj kohe ai ka mundësi ta falë namazin të plotë, kurse në kohë të tjera namazi do të jetë i prishur. Veç kësaj, ai është i urdhëruar të largohet prej këtij namazi dhe të mos e vërë në konsideratë, sepse si bazë, namazi që ai fali, nuk është i ligjëruar në ligjin e fesë.

Kur koha është tepër e ngushtë dhe mjafton vetëm për të falur namazin që ai ka filluar, ai e ka farz të plotësojë namazin që është duke falur dhe sexhden ta bëjë mbi cepin e rrobës së tij të punuar prej pambuku ose prej liri, ndryshe bën sexhde edhe mbi metal, duke ditur se rroba prej pambuku e prej liri janë të afërta me tokën, ose ai bën sexhde mbi sende të tjera të dala prej tokës, mbi të cilat lejohet të bëhet sexhdja. Ndryshe ai bën sexhde mbi shputën e dorës së tij.

Në lidhje me këtë çështje, kemi një transmetim prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilit një burrë i tha: “Jam në udhëtim, ndërkaq hyn koha për faljen e namazit, por nga nxehtësia e madhe e tokës kam frikë për fytyrën time. Si të veprojmë?” Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Bëj sexhde mbi rrobën tënde.” Burri i tha: “Rroba ime nuk më mundëson të bëj sexhde mbi cepin e saj e as në fundin e saj.” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Bëj sexhde mbi shputën e dorës tënde, sepse ajo është njëra prej vendeve ku bëhet sexhde.”

EZANI DHE IKAMETI

Filozofia e ezanit

Nga pikëpamja gjuhësore, fjala “ezan”, do të thotë “*lajmërim*”, kurse në ligjin e fesë, fjala “ezan” nënkupton fjalë të veçanta që kujtojnë hyrjen e kohës për faljen e namazit dhe që shpallin simbolin më të rëndësishëm të Islamit e të myslimanëve. Me ezanin, myslimani njihet prej jomyslimanit, pavarësisht se në cilin grupim islam e ka atashuar veten. Ezani shpallet vetëm mbi minaret, me thirrjen “Là ilàhe il’la-ll’llàh!”, “Muham’medun resùlu-ll’llàh”.

Prej një grupi dijetarësh të mëparshëm transmetohet se ezani, me ato pak fjalë që ka, përmbledh çështje të shumta të doktrinės islame: Ezani fillon me fjalën “All’llàhu Ekber!” -“Allahu është më i madhi!”, përmban ekzistencën e Allahut dhe plotësimin e Tij, bën falënderimin e lavdërimin për Allahun me fjalën “Là ilàhe il’le-ll’llàh!” -“S’ka zot tjetër përveç Allahut!”, e cila, në të vërtetë, është pohim për njëtimin e Allahut (Allahu është Një dhe vetëm Një). Gjithashtu, me këtë fjalë bëhet mohimi i

shirkut (vënia shok e ortak Allahut). Më pas vjen fjala “Muham’medun resûlu-ll’lâ”-“Muhamedi është i Dërguari i Allahut”. Kjo fjalë është pohimi për mesazhin me të cilin erdhi Muhamedi. Pastaj vjen fjala “Haj’je ale-s’salât”-“Eja në namaz!”, që është thirrja për kolonën parësore të fesë. Më pas vjen thirrja për udhëzimin në rrugën e drejtë dhe për shpëtim. Pastaj vjen nxitja për të bërë punën më të mirë. Të gjitha këto janë të përforcuara me përsëritje.

Ligjërimi i ezanit

Ezani është ligjëruar në vitin e parë të emigrimit (hixhretit) të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ezani është dy pjesësh: ezani që shpall hyrjen e kohës për faljen e namazit dhe ezani për faljen e namazeve farz të përditshme. Në ezanin e parë nuk është kusht as nijeti për afrim te Allahu dhe as pastrimi, kurse në ezanin e dytë, patjetër duhet nijeti për afrim te Allahu. Është bërë praktikë dhe puna ka vijuar sipas kësaj praktike: Ezani i dytë të këndohet pas marrjes abdes, atëherë kur do të fillohet falja e namazit.

Mënyra e ligjëritimit të ezanit është transmetuar me dy rrugë: Rruga e parë është rruga e Ehli Sunetit: Abdullah bin Zejdi pa në ëndërr fjalët e ezanit dhe ai ia lexoi ato të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të*

dhe mbi familjen e tij!) i miratoi ato fjalë ashtu siç i kishte parë në ëndërr Abdullahu.¹

Rruga e dytë është ajo e shiiave: Allahu i Lartësuar i ka shpallur Profetit të Tij mënyrën e këndimit të ezanit, me të gjitha pjesët e tij, me anë të Xhibrilit, plotësisht ashtu siç i kishte shpallur mënyrën e faljes së namazit dhe adhurimet e dispozitat e tjera. Shi'at kanë thënë se marrja e ezanit prej ëndrrës së Abdullah bin Zejdut është e gabuar, sepse punët e ligjit të fesë janë të përfituara vetëm me anë të shpalljes, veçanërisht ato më të rëndësishmet, siç është ezani. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), duke mohuar rrugën e parë, ka thënë: “Shpallja i zbret Profetit tuaj, kurse ju pretendoni se ai i ka marrë fjalët e ezanit prej Abdullah bin Zejdut!”

Mënyra e këndimit të ezanit

Me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, është vërtetuar se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) e këndonte ezanin në këtë mënyrë:

All'llahu Ekber, All'llahu Ekber, All'llahu Ekber, All'llahu Ekber.

Esh'hedu en là ilàhe il'la ll'llàh, Esh'hedu en là ilàhe il'la ll'llàh.

Esh'hedu en'ne Muham'meden resùlu ll'llàh, Esh'hedu en'ne Muham'meden resùlu ll'llàh.

Haj'je ale-s'salàt, Haj'je ale-s'salàt.

¹ “Fethul Bàrij”, koment i Buhariut, autori Ibn Haxher El Askalànij, vëllimi 2, faqe 218, botim i vitit 1959.

Haj'je al-el-felàh, Haj'je al-el-felàh.

Haj'je alà khajril-amel, Haj'je alà khajril-amel.

All'llàhu Ekber, All'llàhu Ekber.

Là ilàhe il'lall'llàh, Là ilàhe il'lall'llàh.

Allahu është më i madhi! Allahu është më i madhi! Allahu është më i madhi! Allahu është më i madhi!

Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut! Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut!

Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut! Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut!

Eja të falësh namazin! Eja të falësh namazin!

Eja në shpëtim! Eja në shpëtim!

Eja në punën më të mirë! Eja në punën më të mirë!

Allahu është më i madhi! Allahu është më i madhi!

Nuk ka zot tjetër përveç Allahut! Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!

Të gjithë dijetarët e fesë kanë rënë në një fjalë të përbashkët se thënia: “Esh’hedu en’ne Alij’jen veliju-ll’llàh” -“Dëshmoj se Aliu është evljia i Allahut!” nuk është prej pjesëve të ezanit. Ai që e këndon ezanin duke shtuar edhe këtë thënie, me njetin se ajo është prej pjesëve të ezanit, në të vërtetë, ai ka bërë një sajësë

(bid'at) në punët e fesë dhe ka futur në fe diçka që është jashtë saj. Kush dëshiron të njihet me fjalët e dijetarëve të mëdhenj dhe me mohimin e kësaj thënieje nga ana e tyre, le të referohet në vëllimin e katërt të librit “El Mustemsek”, kapitulli: “Ezani dhe ikameti”. Në këtë pjesë autori ka sjellë rrugë jo të thjeshta. Prandaj ne do të mjaftohemi me atë që është shkruar në librin “El Lem’atu Dimeshki’jeh” dhe në komentin që i kanë bërë këtij libri dy dëshmorët, ku tekstualisht thuhet: “Nuk është e lejueshme besimi në ligjshmërinë e fjalëve të tjera, përveç fjalëve të ezanit dhe të ikametit, siç është fjala “Esh’hedu en’ne Alij’jen veliju-ll’läh”- “Dëshmoj se Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) është evlija i Allahut!”, ose fjala tjetër “Esh’hedu en’ne Muham’meden ue àlihi khajrul-berr’rrij’jeh, eu khajrul-besher”- “Muhamedi dhe familja e tij janë njerëzit më të mirë!”, edhe pse në realitet është kështu. Por jo çdo realitet e çdo e vërtetë lejohet të futet në adhurimet e ligjëruara e të përcaktuara prej Allahut të Lartësuar, pasi futja e këtyre gjërave është sajese në ligjin e fesë, siç është shtimi i një rekati në namaz, ose këndimi i një tesheh’hudi, ose adhurime të tjera. Në tërësi, këto janë dispozita të besimit (imanit) dhe nuk janë prej pjesëve të ezanit.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Këto (shtesat) janë prej vënieve të mufeo’vidave (anarkistëve), të cilët janë një grupim ekstremistësh.”

Mënyra e këndimit të ikametit

Të gjithë dijetarët e fesë ndajnë një mendim të përbashkët se mënyra e këndimit të ikametit është:

All'llàhu Ekber, All'llàhu Ekber.

Esh'hedu en là ilàhe il'lall'llàh, Esh'hedu en là ilàhe il'lall'llàh.

Esh'hedu en'ne Muham'meden resùlull'llàh, Esh'hedu en'ne Muham'meden resùlull'llàh.

Haj'je ale-s'salàt, Haj'je ale-s'salàt.

Haj'je alel felàh, Haj'je alel-felàh.

Haj'je alà khajril amel, Haj'je alà khajril amel.

Kad kàmeti-s'salàt, Kad kàmeti-s'salàt.

Là ilàhe il'lall'llàh.¹

Allahu është më i madhi! Allahu është më i madhi!

Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut! Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut!

Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut! Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut!

Eja të falësh namazin! Eja të falësh namazin!

Eja në shpëtim! Eja në shpëtim!

Eja në punën më të mirë! Eja në punën më të mirë!

¹ Kjo mënyrë e të kënduarit të ikametit nuk ka ardhur tekstualisht e këtillë në fjalët e Ehli Bejt (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!), por fukahatë i kanë nxjerrë ato prej transmetimeve të shumta, sidomos prej transmetimit të El Xheafij'jit.

Falja e namazit u fillua! Falja e namazit u fillua!

Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!

Dijetarët e fesë ndajnë një mendim të përbashkët se ezani dhe ikameti as nuk lejohen e as nuk janë të ligjëruara, përveçse në farzet e pesë namazeve të përditshme dhe jo në namazet e tjera, siç janë namazet mustehab, falja e të cilave nxitet, por është e lejueshme edhe të lihen. Këndimi i ezanit dhe i ikametit është *"sun'netun muek'kede"* – në gradën e farzit, veçanërisht ikameti në namazet farz të përditshme, qoftë kur ato falen në kohën e vet (*edâen*), qoftë kur ato falen si namaze të prapambetura (kaza), për burrin e për gruan, qoftë kur njeriu fal namaz i vetëm, qoftë kur ai e fal namazin me xhemat, përveç xhematit të dytë, kur nuk është i ndarë prej xhematit të parë. Ai që e fal namazin vetëm, ai e këndon ezanin dhe ikametin, kur të fillojë faljen e namazit. Gjithashtu, radhët (safët) e xhematit nuk prishen, prandaj ai e fal namazin pa ezan e pa ikamet.

Ezani nuk lejohet të këndohet pa hyrë koha e faljes së namazit, përveç namazit të mëngjesit, pasi Ehli Bejti ka lejuar që ky ezan të këndohet përpara hyrjes së kohës për faljen e namazit, qoftë gjatë Muajit të Ramazanit, qoftë jashtë këtij muaji. Megjithëkëtë, është veprim i pëlqyer (*mustehab*) që ky ezan të përsëritet, kur të hyjë koha.

Për hyrjen e kohës është e vlefshme mbështetja në ezanin që këndon myezini i ditur, qoftë ai i shiiave, qoftë i sunive.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për ezanin që këndojnë sunitë. Ai ka thënë: *"Fal namazin me ezanin e tyre, sepse ata janë shumë të përpiktët në respektimin e kohës së faljes së namazit."*

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë:
“Myezini është i besueshëm, edhe imami është i besueshëm.”

Kushtet e ezanit e të ikametit

Për këndimin e ezanit dhe të ikametit është kusht nijeti për afrim te Allahu i Gjithëpushtetshëm, sepse të dy janë adhurim, përveç ezanit që këndohet për njoftim. Gjithashtu, për këndimin e ezanit dhe të ikametit, është kusht që njeriu të jetë i mençur, mysliman, ta këndojë menjëherë dhe me vijueshmëri ndërmjet pjesëve. Të këndohet më parë ezani dhe pastaj ikameti, të këndohen në gjuhën arabe, sapo të hyjë koha për faljen e namazit, me përjashtim të namazit të mëngjesit, kurse abdesi është kusht për këndimin e ikametit dhe jo për këndimin e ezanit. Këtë gjë e ka thënë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Nuk ka problem që burri ta këndojë ezanin pa abdes, por ai nuk mund ta këndojë ikametin pa abdes.”*

* * *

PUNËT E NAMAZIT

Kushti i detyrimit dhe kushti i qenësishëm (shartul vuxhùbi ue shartul vuxhùdi)

Kushtet e obligimeve ligjore janë dy llojesh. Ka prej tyre që janë kusht për detyrim, në atë shkallë, si bazë pa atë kusht nuk bëhet as obligimi, siç është mendja, mosha e pjekurisë (seksuale) dhe fuqia. Gjithashtu, prej atyre kushteve është kushti i qenësishëm e i lejuar, në atë mënyrë që obligimi është i qenësishëm, por ai, nga jashtë, nuk gjendet i saktë dhe nuk realizohet në mënyrën e kërkuar pa kushtin, siç është pastrimi në raport me namazin dhe hapja e varrit në raport me të vdekurin.

Namazi bëhet farz kur plotësohen katër kushte, të cilat referohen në origjinën e bërjes detyrim dhe që orientojnë obligimin. Këto kushte janë: mendja, arritja e moshës, hyrja e kohës, gruaja kur nuk është me menstruacione ose në periudhën e hemorragjisë së lehonisë. Argumenti që këto katër kushte janë detyrim, vërtetohet jo vetëm që ato janë të qenësishme si domosdoshmëri të fesë, por edhe me fjalën e përbashkët të fukahave, pasi nuk ka asnjë prej fukahave të medh'hebeve, nga të mëparshmit e nga të mëvonshmit, që të thotë se namazi është detyrim, ose lejohet të falet para se të hyjë koha për faljen e tij, ose

gruaja me menstruacione, ose gruaja në periudhën e hemorragjisë së lehonisë, ose i çmenduri e fëmija, mbajnë përgjegjësi për faljen e namazit. Madje dy të fundit, i çmenduri e fëmija, në mënyrë absolute, s'kanë asnjë lloj përgjegjësie, sipas hadithit: *"Lapsi është ngritur (nuk i regjistronen punët) për fëmijën, derisa të arrijë moshën e pjekurisë seksuale dhe për të çendurin, derisa të ndërgjegjësohet."*

Është vërtetuar se Imami Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"Urdhëroni fëmijët tuaj të falin namaz, kur ata mbushin shtatë vjeç."*

Në një transmetim tjetër, ka thënë: *"Kur ata të mbushin tetë vjeç."*

Nisur nga fjalët e hadithit dhe nga thënia e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), një grup fukahash janë shprehur se namazi, edhe pse nuk është obligim për fëmijën, namazi që fal fëmija është i vlefshëm, kur fëmija është në moshë që dallon, që do të thotë se Allahu i Lartësuar e pranon atë namaz dhe shpërblimi (*theuàbi*) për faljen e këtij namazi shkruhet për të dy prindërit e atij fëmije. Fëmijë që dallon quhet fëmija që ka arritur moshën që ai di rreth namazit e agjërimit dhe bën dallim mes adhurimit dedikuar Allahut të Gjithëpushtetshëm dhe adhurimit dedikuar jo për Allahun.

Kushtet e qenësishme për vlefshmërinë e namazit janë: Islami, pastrimi prej nevojave njerëzore dhe pastrimi i madh, veshja e trupit me rroba dhe kthimi në drejtim të Kibles. Më sipër kemi trajtuar në mënyrë të detajuar çështjen e pastrimit, të veshjes dhe të kthimit në drejtim të Kibles, kurse Islami është kusht në të gjitha adhurimet (ibàdàt).

Ajeti i nderuar thotë:

“وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ

“Kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk i pranohet dhe në Botën Tjetër ai është prej humbësve.” (Sure “Al Imran”, ajeti 85)

Vlen të theksohet se, nga tërësia e dallimeve mes kushtit të detyrimit dhe kushtit të qenësishëm, kushti i parë, nuk është detyrë të arrihet me anë të studimit rreth tij. Prandaj nuk është detyrim të punosh për të siguruar pasuri, me qëllim që edhe për ty të bëhet obligim një e pesta prej fitimit, zekati dhe Haxhi. Pra, është e kundërta e kërkesës për kushtin e dytë, për të cilin është detyrim të hulumtohet dhe të arrihet ai kusht, ndryshe nuk plotësohet obligimi, i cili është bërë detyrim vetëm nëse ekziston ai kusht, sepse obligimi plotësohet vetëm me kusht. Në rregullin e mendjes ai kusht është detyrim.

Kjo ishte tërësia që mund të thuhet në lidhje me kushtet detyruese e të qenësishme të namazit. Për sa i përket të vërtetës së këtyre kushteve dhe lëndës së tyre, ato përbëhen prej punëve farz e prej punëve mustehab që duhet të kryhen, duke theksuar se punët farz të namazit janë të atilla që e prishin namazin, kur ato punë lihen me qëllim, por nuk e prishin, kur ato lihen për shkak të harresës. Gjithashtu, namazi priset kur në namaz shtohet me qëllim ose nga harresa ndonjë veprim. Ka prej këtyre kushteve që nuk janë farz, domethënë se namazi, pa këto kushte, priset kur ato lihen me qëllim, por nuk priset, kur ato lihen nga harresa. Në vijim shpjegimi:

Nijeti

1- Allahu i Lartësuar ka thënë:

“وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ”

“Ata nuk u urdhëruan për ndonjë gjë tjetër përveçse të adhurojnë Allahun me singëritet...” (Sure “El Bej’jineh”, ajeti 5). I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Punët vlerësohen sipas qëllimit dhe për çdo njeri ka atë që ai ka bërë qëllim.”

Imam Sadiku (Paqja goftë mbi të!) ka thënë: “O Abdullah, kur të falësh namaz farz, fale në kohën e vet, pasi vetëm kështu ai namaz është i depozituar dhe është frikë se do të përsërisësh atë namaz. Mëso se ti je para Atij që të shikon, kurse ti nuk e shikon Atë.”

Përsëri Imam Sadiku (Paqja goftë mbi të!) ka thënë: “Çdo rob, kur fal namaz, i drejtohet Allahut me zemrën e tij. Padyshim që edhe Allahu e ka kthyer fytyrën e Tij në drejtim të këtij njeriu.”

Kur këto fjalë dhe fjalë të tjera kërkojnë prej atij që fal namaz nënshtrim të plotë me argumentin e përputhjes, në fakt kjo tregon se nijeti është kërkesë, të cilën ai detyrimisht duhet ta plotësojë.

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Nijeti është motivi tregues që tregon se namazi është bindje vetëm ndaj Allahut dhe përvetësim i urdhrave të Tij. Për sa u përket mendimeve të ndryshme, që nijeti është pjesë e namazit, ose është prej kushteve të namazit, prandaj

s'ka veprim të detyrueshëm të qëndrojë poshtë namazit, përderisa nijeti është farz në të gjitha gjendjet që mund të jetë njeriu, madje nijeti është njëri prej kushteve pa të cilin namazi priset, kur lihet, me qëllim ose nga harresa, nuk ka arsye për të zgjatur fjalën për nxjerrjen e argumenteve që nijeti është farz, pasi vetë namazi është i pandashëm nga nijeti. Studiuesi i mirënjohur, Fadiki, ka thënë: "Sikur Allahu të kishte obliguar faljen e namazit ose kryerjen e adhurimeve të tjera pa nijet, do të ishte një obligim që nuk përballohet dot."

Duke qenë se nijeti është prej punëve të zemrës, nuk është detyrim që ai të shqiptohet me fjalë. Në lidhje me këtë çështje, autori i librit "El Medàrik", ka thënë: "Shqiptimi i nijetit me fjalë do të qe një punë pa dobi, madje do të qe një futje në fe e një pune që nuk është e fesë, pasi nuk mund të përjashtohet që ndërgjegjja të shqiptojë nijetin në formë adhurimi, çka përbën ligjërimitin e një veprimi haram."

Nijeti është detyrim të përcaktohet, kur është më shumë se për një farz, sepse, nëse nuk përcaktohet, ndodh përngjasimi, siç do të ishte nijeti për faljen e namazit të drekës dhe të namazit të pasdites, prandaj nuk lejohet që falësi i namazit të bëjë nijet për njërin prej dy namazeve, ose për çdo namaz në përgjithësi. Gjithashtu, nuk është detyrim që nijeti të bëhet me qëllim se po fal namaz në kohën e vet apo namaz të prapambetur (*kaza*), ose do të falësh namaz të shkurtuar, apo do të falësh namaz të plotë, ose do të falësh namaz farz apo namaz *mustehab*, për shkak se nuk ka argument që tregon se ndonjë gjë nga këto është detyrim, por nuk ka problem, nëse ai nuk ka qëllim të besojë se shqiptimi i nijetit me fjalë, është detyrim i vënë në ligjin e fesë.

Prej fjalëve të virtytshme është se hipokrizia e prish namazin, sepse hipokrizia prish që në themel nijetin e kërkuar për faljen e namazit, pasi ne shpjeguam që namazi është adhurim i dedikuar me sinqeritet vetëm për Allahun.

Çështje

Është detyrim që nijeti të vazhdojë deri në fundin e faljes së namazit. Nuk lejohet që njeriu të bëjë nijet ndërprerjen e nijetit, ose të heqë dorë prej nijetit. Sikur njeriu të bëjë nijet ndërprerjen e nijetit ose heqjen dorë prej tij dhe bën një veprim tjetër prej namazit pa nijet, ose kryen një punë që është në kundërshtim me punët e namazit, namazi i tij është i prishur. Nëse ai i rikthehet nijetit dhe kryen një veprim nga veprimet e namazit pa nijet, ose diçka që së bashku me nijetin, është në kundërshtim me namazin, ai namaz është i vlefshëm.

Falësit të namazit i lejohet të heqë dorë prej faljes së një namazi të vonuar, ose prej një namazi vijues për të kaluar në një namaz që ka përparësi në gradë, por nuk i lejohet e kundërta. Le të sjellim një shembull: Kur bën nijet të falë namazin e pasdites, por ndërkaq për atë bëhet e qartë se ai nuk ka falur namazin e drekës, ai heq dorë prej namazit që është duke falur, fal namazin e drekës dhe pastaj fal namazin e pasdites. Në qoftë se ai bën nijet të falë namazin e drekës, por më pas i bie ndërmend se ai e ka falur këtë namaz, prej tij kërkohet vetëm të falë namazin e pasdites. Nuk lejohet që këtë namaz ai ta kthejë në namazin e pasdites, por lejohet që namazin farz ta kthejë në namaz nafile, me qëllim që të arrijë të falë këtë namaz me xhemat.

Për shembull: Ti ke bërë nijet të falësh namazin e drekës vetëm, por më pas u formua xhemati, në këtë rast ke detyrë që namazin e drekës, që ishe duke e falur vetëm, ta kthesh në namaz nafile, derisa namazi me xhemat nuk ka arritur deri në rukunë e rekatit të tretë. Gjithashtu, me zgjedhjen tënde ke të drejtë të heqësh dorë nga namazi me xhemat për të kaluar në faljen e vetëm të namazit.

Prej çështjeve të tjera kemi: Kur njeriu fillon të falë namaz me nijet, që të falë namazin që ka detyrim, por ai mendon se namazi farz që ai ka detyrim të falë, është namazi i drekës, por më pas qartësohet se namazi që ai duhet të falë është namazi i pasdites; ose ai mendon se është namazi i pasdites, por pastaj qartësohet se kishte detyrim të falte namazin e drekës, ky namaz që ai fali është i vlefshëm, sepse ky namaz është i bazuar në realitetin, kurse thjesht mendimi ose që i vete mendja, s'ka asnjë rëndësi. Prandaj ky lloj veprimi quhet përngjasim në praktikë. Është e njëjta gjë, sikur t'i jepje te varfërve tepricat vjetore të rezervave të tua ushqimore me nijetin se po jep detyrimin që ke, por më pas imagjino se ajo që ti dhe është prej zekatit. Në realitet, dhënia që bëre, është në vendin e vet, sepse ke dhënë detyrimin e një të pestës dhe kjo është e mjaftueshme, pasi me këtë dhënie njëkohësisht ke dalë edhe nga detyrimi.

Tekbiri i fillimit (tekbijretul ihràmi)

2- Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Veprimi më i afërm që shënon fillimin e faljes së namazit, është tekbiri i fillimit (namazi fillon kur thuhet Allahu Ekber!).”

Gjithashtu, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Fillimi i namazit është abdesi, ndaluesi i punëve të tjera në namaz është tekbiri dhe dalja prej namazit është selami.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që harron të thotë “All’lâhu Ekber”. Si duhet të veprojë ai? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Të përsërisë namazin.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se tekbiri i fillimit është prej farzeve të namazit. Namazi priset kur tekbiri i fillimit lihet, ose, kur nga harresa thuhet më shumë se një herë, pa thënë që namazi është i prishur, kur ai lihet me qëllim. Mënyra e shqiptimit të tekbirit të fillimit është: Falësi i namazit të thotë “All’lâhu Ekber”. Nëse ai deformon qoftë edhe një gërmë prej kësaj fjale, ai nuk ka hyrë në namaz. Është *mustehab* që në fillim të namazit ai të thotë shtatë herë “All’lâhu Ekber” dhe me njërin prej këtyre tekbireve bën nijet tekbirin për hyrjen në namaz. Tekbiret e tjera i thotë si përmendje të Allahut (*dhikr*) dhe lutje (*dua*). Është në përzgjedhjen e falësit të namazit që të bëjë tekbir të fillimit tekbirin e parë ose tekbirin e fundit, ose tekbirin e mesëm nga këto shtatë tekbire, por atij nuk i lejohet të mos përcaktojë që njëri prej shtatë tekbireve të jetë tekbiri për fillimin e namazit.

Është detyrim për atë që fal namaz të thotë tekbirin e fillimit, sapo të ngrihet në këmbë për fillimin e namazit. Ashtu siç

u tha më sipër, nëse ai harron të thotë “All’lלהu Ekber”, ose thotë “All’lלהu Ekber” dy herë, namazi i tij është prishur.

Në tekbinin e fillimit është mustehab që duart të ngrihen deri në lartësinë e dy veshëve, ose përballë fytyrës. Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), duke shpjeguar fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Fal namaz për Zotin tënd dhe bëj kurban.”** (Sure “El Keuther”, ajeti 2), ka thënë: “Fjala “bëj kurban” (nahr) është ngritja e dy duarve të tua përballë fytyrës.”

Qëndrimi në këmbë (El Kijàm)

3- Allahu i Lartësuar thotë:

“وَقُومُوا لِلَّهِ قَانِتِينَ”

“Qëndroni në këmbë të nënshtruar ndaj Allahut.” (Sure “El Bekareh”, ajeti 238) Togfjalëshi “qëndroni në këmbë” (ue kùmù), në këtë ajet, është shpjeguar: qëndroni në këmbë në faljen e namazit.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), duke shpjeguar fjalën e Allahut të Lartësuar:

“الَّذِينَ يَذْكُرُونَ اللَّهَ قِيَامًا وَقُعُودًا وَعَلَىٰ جُنُوبِهِمْ”

“Ata që e përmendin Allahun në këmbë, ndenjor dhe të shtrirë në brinjë...” (Sure “Al Imran”, ajeti 191), ka thënë: “I shëndetshmi e fal namazin në këmbë dhe i sëmuri e fal ulur, kurse fjala e ajetit “shtrirë në brinjë” është për atë person që është më i pafuqishëm se i sëmuri, prandaj ai fal namazin i shtrirë. Gjithashtu, prej Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) transmetohet se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i

Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Kush nuk e drejton drejt trupin e tij në namaz, për atë nuk ka namaz.”

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “I sëmuri e fal namazin në këmbë. Në qoftë se ai nuk ka fuqi të qëndrojë në këmbë, ai e fal namazin ndenjtur. Në qoftë se nuk ka fuqi të qëndrojë ulur, ai e fal namazin i shtirë në shpinë, merr tekbirin, pastaj këndon, kur do të bëjë ruku, mbyll dy sytë dhe, kur këndon tesbijhatet e rukusë (thotë subhàne rab'bijel-adhijm), i hap sytë dhe ashtu me sy hapur ngre kokën prej rukusë. Kur do të bëjë sexhden, mbyll sytë, pastaj këndon tesbijhatet e sexhdes (thotë subhàne rab'bijel-aëla). Gjatë këndimit të tesbijhateve ai i hap sytë, pra, ai i hap sytë kur këndon tesbijhatet dhe kur ngre kokën prej sexhdes. Pastaj këndon tesheh'hudin dhe kështu ai mbaron namazin.”

Fukahatë

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se qëndrimi më këmbë në namaz është detyrim gjatë kohës që ai bën tekbirin e fillimit dhe këndimin e detyrueshëm, gjithashtu, ata kanë një mendim të përbashkët se një pjesë e qëndrimit në këmbë është kusht. Namazi prishet, nëse kjo pjesë e qëndrimit në këmbë lihet nga harresa. Kurse pjesa tjetër e qëndrimit në këmbë, që nuk është kusht, namazi nuk prishet nëse ajo harrohet, por prishet, nëse qëllimisht nuk qëndrohet në këmbë. Pjesa kusht e qëndrimit në këmbë është pjesa e tij e puqur me tekbirin e fillimit dhe pjesa e puqur me rukunë, pra, rukuja të vijë nga pozicioni i qëndrimit në këmbë. Përveç këtyre pjesëve, pjesa tjetër e qëndrimit në këmbë është thjesht detyrim.

Le të supozojmë se ai këndoi tekbirin e fillimit, ndërkaq qëndron në këmbë, por pastaj harron dhe kalon në ruku pa kënduar “Fatihan”, ose suren, ose i harron të dyja së bashku, namazi i tij është i vlefshëm, krahas asaj që dihet se ai ka lënë qëndrimin në këmbë të detyrueshëm për këndimin. Por sekreti këtu qëndron në faktin se e lëna nuk është pjesë. Kur ai këndon tekbirin e fillimit ulur, ose bën ruku, duke mos qenë në këmbë, ose ngrihet vetëm sa për të bërë rukunë, namazi i tij është i prishur, qoftë edhe se këtë ai e bëri nga harresa dhe jo me qëllim, pasi qëndrimi në këmbë në këtë pjesë të veçantë të namazit është detyrim.

Qëndrimi në këmbë është mustehab, kur bëhet tekbiri i “Kunùtit” dhe tekbiri për të rënë në ruku. Me një fjalë, dispozita për rukunë farz e mustehab ndjek dispozitën e veprimit vijues që do të bëjë ai që fal namazin, ndërkaq ai është në këmbë. Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se namazi nafile lejohet të falet ulur, edhe pse ai ka fuqi që atë namaz ta falë më këmbë. Gjithsesi, falja e namazit më këmbë është më e pëlqyer.

Në qëndrimin në këmbë është kusht që trupi të qëndrojë drejt, të zërë vend mirë, të mos mbështet mbi ndonjë send, përveç rasteve që e ka të domosdoshme, pasi për njeriun, në gjendje domosdoshmërie, lejohet të mbështet mbi mur, mbi bastunin, gjithnjë me kusht që është i pamundur të qëndrojë i pavarur. Në qoftë se ai s’ka fuqi të qëndrojë në këmbë, as duke u mbështetur, atëherë, nëse ka mundësin ai e fal namazin i kërrusur, ndryshe e fal ndenjtur. Nëse s’ka fuqi as të qëndrojë ulur, ai e fal namazin shtrirë në brinjën e djathtë, duke kthyer në drejtim të Kibles pjesët e përparme të trupit të tij, plotësisht ashtu siç vihet i vdekuri në varr. Në qoftë se s’ka fuqi as të qëndrojë në brinjë, atëherë ai e fal

namazin i shtrirë në shpinë, koka nga veriu dhe shputat e këmbë kthyer në drejtim të Kibles, si njeriu para përgatitjes për varrimin e tij. Secila nga këto gjendje ka përparësi sipas kësaj renditjeje: falja e namazit në këmbë ka përparësi ndaj faljes ulur, falja e namazit ulur ka përparësi ndaj faljes shtrirë në brinjë, falja e namazit shtrirë në brinjë ka përparësi ndaj faljes shtrirë në shpinë. Ai që fal namaz i shtrirë në brinjë dhe ai që fal namaz i shtrirë në shpinë, rukunë e sexhden i bën me shenjë, gjithashtu, rukunë e sexhden e bën me shenjë edhe ai që ka mundësi të qëndrojë në këmbë, por ka pengesë të bëjë rukunë e sexhden.

Nëse ky kujdes i madh për namazin tregon ndonjë gjë, në fakt ai tregon se njeriu, në çdo gjendje që të ndodhet, e ka detyrim të jetë në lidhje me Allahun e Gjithëpushtetshëm, ta përmendë Atë vazhdimisht dhe të mos harrojë urdhrat e ndalesat që Ai ka vënë, me qëllim që njeriu as të mos neglizhojë e as të mos i rritet mendja, deri në atë shkallë sa të guxojë të kundërshtojë urdhrat e Allahut dhe të bëjë punët shkatërruese të ndaluara për të. Nëse Allahu do të kishte konsideruar të mjaftueshme që njerëzit për të mësuar fenë të thoshin vetëm fjalën e dëshmisë: “Là ilàhe il’le-ll’lilà Muham’medun resulu-ll’lilà!” dhe Kur’ani e mësimet e të Dërguarit të lireshin në harresë të plotë, pavarësisht nga përsëritja e faljes së pesë namazeve të përditshme, do të shihnim se çdo të shihnim prej punëve të urryera. Pa mendo si do të qe puna edhe pa faljen e pesë namazeve!

Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) ka thënë: “Sikur njerëzit të lireshin pa i kujtuar e pa i tërhequr vëmendjen me Profetin (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me siguri që njerëzit do të ishin ashtu siç ishin të mëparshmit, të cilët besuan në fe, shkruan libra dhe ftuan njerëzit për në gjendjen ku ishin vetë. Pastaj ata

i vranë njerëzit, studiuan punën e tyre dhe shkuan aty ku shkuan. Por Allahu i Lartësuar dëshiron që njerëzit të mos harrojnë të përmendim Muhamedin (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Për këtë qëllim, Allahu i Lartësuar i ka obliguar njerëzit të falin çdo ditë pesë namaze, të thërresin ezanin me emrin e tij dhe ta nderojnë atë duke rënë në salavat e duke përmendur Allahun, me qëllim që njerëzit të mos mbeten të shkujdesur nga mësimet e Allahut e të harrojnë Profetin, por gjuhët e tyre vazhdim të përmendin Allahun e Profetin e Tij."

Këndimi

4- Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Kush e le këndimin me qëllim, ai përsërit faljen e namazit dhe, kush e harron këndimin, namazi i tij është kryer."

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) për një njeri që harron të këndojë suren "Fatiha". Ai tha: "Në qoftë se ai nuk ka rënë akoma në ruku, le të kthehet e të këndojë suren "Fatiha", sepse për atë nuk ka këndim, derisa të fillojë këndimin e sures "Fatiha" me zë të lartë, ose pa zë."

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Nuk ka namaz veçse duke kënduar suren "Fatiha" me zë ose pa zë, që do të thotë se asnjë sure tjetër nuk e zëvendëson dot suren "Fatiha", kur njeriu e ka vëmendjen të plotë gjatë faljes së namazit."

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se me çfarë veprimi kryhen në dy rekatet e fundit. Ai tha: "Thuaj 'Subhànall'lah, uel hamdu lil'làh, làilahe il'lall'illàh uell'illàhu ekber!'. Pastaj thuaj 'Allahu Ekber' dhe bjer në ruku."

Njëri nga të pranishmit e pyeti Imam Sadikun (*Paqja goftë mbi të!*) se si të vepronte në dy rekatet e pasmë të namazit. Ai tha: “Nëse dëshiron, këndo suren “*Fatiha*”. Nëse dëshiron, thuaj “*Subhànë-ll’lloh*” dhe përmend Allahun. Të dyja janë të barabarta.”

Pyetësi tha: “Por cila nga këto të dyja është më e mira?”

Imam Sadiku iu përgjigj: “*Pasha Allahun! Të dyja janë të barabarta. Nëse dëshiron, këndo tesbijhatin (thuaj subhànall’lloh) dhe nëse dëshiron, këndo suren “Fatiha*”.

Fukahatë

Mbështetur mbi këto transmetime e mbi shumë transmetime të tjera, si dhe mbi atë që ka thënë i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “*Faleni namazin ashtu siç më shikoni mua të fal namazin.*”; mbështetur në punën e Ehli Bejtit të Profetit, të të pastërve e të të mirëve, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët: Këndimi në namaz është detyrim. Por ata kanë thënë se këndimi në namaz nuk është prej kushteve të domosdoshme, por është vetëm detyrim. Kjo është e mjaftueshme, pasi namazi prishet, kur këndimi lihet me qëllim ose nga harresa. Gjithashtu, fukahatë kanë thënë se këndimi i sures “*Fatiha*” është detyrim në dy rekatet e namazit të mëngjesit, në dy rekatet e parë të namazit të drekës, në dy rekatet e parë të namazit të pasdites, në dy rekatet e parë të namazit të mbrëmjes dhe në dy rekatet e parë të namazit të darkës, së bashku me një sure të plotë, që njeriu e zgjedh prej Kur’anit Famëlartë. Gjithashtu, fukahatë kanë thënë se surja “*El Fijl*” dhe surja “*Li ijlâf*” (sure “*Kurejsh*”) numërohen një sure dhe nuk mund të

ndahen njëra nga tjetra. E njëjta gjë është edhe për suren “Ed Duhà” dhe suren “Elem Neshrah” (“*Inshirah*”), por, duke kënduar “Bismi-l’lâhi-rr’rahmàni-rr’rrahijm” në fillim të secilës sure, sepse “Bismi-l’lâhi-rr’rahmàni-rr’rrahijm”, sipas fjalës së përbashkët të fukahave, është pjesë e çdo njëres prej sureve të Kur’anit, me përjashtim të sures Et Teubeh”.

Është detyrim që surja “Fatiha” të këndohet parapara sures, por, nëse ai e këndon suren përpara sures “Fatiha” me qëllim, namazi i tij është i prishur. Por nëse ai harron dhe këndon suren përpara sures “Fatiha” dhe kujtohet para se të bëjë rukunë, ai këndon suren “Fatiha”, pastaj përsërit suren dhe, pas përfundimit të namazit, bën sexhden e harrimit. Gjithashtu, fukahatë kanë thënë se për shkak sëmundjeje njeriu e ka të lejuar të mos e këndojë suren, siç mund të jetë rasti kur këndimi i sures është i vështirë për të, ose papritur i del një punë që kërkon nxitim dhe, nëse ai nuk e le suren, do të pësojë dëmtim.

Gjithashtu, lejohet të lihet këndimi i sures, kur koha është tepër e ngushtë që surja të këndohet së bashku me suren “Fatiha”. Në një gjendje të tillë, ai mjaftohet të këndojë vetëm suren “Fatiha”. Lejohet të lihet surja në namazet nafile, me të gjitha pjesët e këtyre namazeve. Gjithashtu, në namazet nafile lejohet të këndohet më shumë se një sure.

Është detyrim që këndimi në namaz të jetë i qartë dhe shqiptimi i germave të jetë i saktë. Burri ka detyrë të këndojë me zë në namazin e mëngjesit dhe në dy rekatet e para të namazit të drekës, të namazit të pasdites, të namazit të mbrëmjes dhe të namazit të darkës, kurse në rekatet e tjerë të namazeve, këndimi bëhet pa zë. Në asnjë rast nuk ka justifikim kur këndimi me zë

lihet me qëllim, por është i justifikuar, kur lihet për shkak të harresës, ose ngaqë nuk e di. Është mustehab që këndimi i “Bismi-l’lâhi-rr’rahmâni-rr’rrahijm” në namazin e drekës dhe në namazin e pasdites të bëhet me zë të lartë. Gruaja nuk këndon me zë në të gjitha namazet, gjithashtu gruaja ka të drejtë të këndojë me zë në ato rekate, në të cilat burri e ka detyrim të këndojë me zë, me kusht që gruan të mos e dëgjojë asnjë i huaj. Kufiri i zërit të lartë është aq sa ta dëgjojë ai që është afër, kurse kufiri i këndimit pa zë është që ta dëgjojë vetëm ai që këndon.

Ai që fal namaz, bën zgjedhjen e vet që në rekatën e tretë të namazit të mbrëmjes, në dy rekatet e prapme të namazit të drekës, në dy rekatet e prapme të namazit të pasdites dhe në dy rekatet e prapme të namazit të darkës, mes këndimit të sures “Fatiha” ose të këndojë: “Subhànall’lâh”, “El hamdu lil’lâh”, lâ ilâhe il’lall’lâh” dhe “All’lâhu Ekber”. Këto tesbijhate është mustehab të këndohen tri herë.

Rukuja

5- Allahu i Lartësuar thotë:

“ارْكَعُوا وَاسْجُدُوا”

“...bini në ruku e në sexhde...” (Sure :El-Haxh’xh”, ajeti 77)

Allahu Fuqiplotë thotë:

“وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ ارْكَعُوا لَا يَرْكَعُونَ”

“Dhe kur atyre u thuhej, bini në ruku (falni namaz) ata nuk binin në ruku.” (Sure “El Murselât”, ajeti 48)

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Allahu ka bërë obligim rukunë dhe sexhden.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Namazi është nga një e treta e tri gjërave: një e treta është pastrim, një e treta është ruku dhe një e treta është sexhde.”

Përsëri Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur bën ruku, përqendroje shikimin tënd mes dy këmbëve të tua, të cilat të jenë të hapura nga njëra-tjetra në distancën e një pëllëmbë, në mënyrë që të mundësojnë qetësinë e dy duarve, kur i vendos mbi të dy gjunjët. Më parë vendos mbi gjunjët dorën e djathtë para dorës së majtë, në atë mënyrë që majat e gishtave të tu të mbërthejnë kupën e gjurit dhe, kur të vesh duart mbi gjunjët, hapi gishtat e duarve, por gishtat e duarve në ruku të arrijnë deri te gjunjët. Kështu rukuja është kryer. Për mua, është më e dashur që brenda mundësive, e gjithë shputa e dorës të mbërthejë kupën e gjurit (arrihet përkulja më e realizuar në ruku), gishtat e duarve vëri mirë mbi kupën e gjurit dhe hapi gishtat nga njëri-tjetri, shtrije kurrizin, drejto qafën dhe hidhe shikimin mes këmbëve të tua.”

Kur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) po i mësonte mënyrën e faljes së namazit njërit prej shokëve të tij, bëri ruku dhe me dy duart e tij të hapura mbërtheu dy gjunjët, gjunjëve i dha nga prapa, pastaj rrafshoi shpinën në vijë aq të drejtë sa sikur mbi shpinën e tij të derdhej një pikë ujë ose një pikë vaj, ajo nuk do të rrëshqiste prej shpinës së tij, shtriu qafën, mbylli dy sytë dhe pastaj këndoi tri herë tesbijhatin e rukusë duke thënë: “Subhâne rab’bijel-adhiym ue bihamdihi.”

Autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “Këto dy njoftime janë nga më të mirat që kanë arritur te ne për këtë kapitull.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në ruku ti këndon: “Subhàne rab’bijel-adhiym ue bihamdihi” dhe në sexhde këndon: “Subhàne rab’bijel-a’llà”. Farzi është që këto tesbijhate të këndohen vetëm një herë, por është sunet që ato të këndohen tri herë dhe më e mira është që të këndohen shtatë herë.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka harruar të bëjë rukunë. Si të veprojë më pas? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha: “Ai ka detyrim ta përsërisë namazin.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Namazi përsëritet vetëm për pesë (kur lihen pesë): pastrimi, koha, Kibla, rukuja dhe sexhdja.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se rukuja në namaz është farz, është prej kushteve të domosdoshme të namazit. Pa rukunë, ose duke shtuar rukunë, qoftë edhe me harresë, namazi prishet. Padyshim, namazi prishet kur rukuja lihet ose shtohet me qëllim. Rukuja bëhet nga pozicioni i qëndrimit më këmbë. Kufiri i rukusë është kërrusja e shpinës, derisa duart të mbështeten mirë mbi dy kupat e gjunjëve, çka mundëson rrafshimin e plotë të shpinës. Në ruku është detyrim të këndohet dhikri “Subhàne rab’bijel adhiym ue bihamdihi”, ose tri herë “Subhànall’llàh”, të arrihet qetësia e plotë për aq kohë sa duhet për të kënduar dhikrin e detyrueshëm, kurse arritja e qetësisë së plotë nënkupton qëndrueshmërinë dhe

qetësinë e gjymtyrëve. Gjithashtu, është detyrim që, kur njeriu ngre kokën prej rukusë, të drejtojë trupin dhe të qëndrojë në këmbë. Me një fjalë, për rukunë në namaz, ka një të vërtetë ligjore: Në ruku bihet duke qenë në këmbë, pas rukusë përsëri ngrihet në këmbë duke qenë plotësisht i qetësuar, pra, për rukunë kemi dy qëndrime në këmbë. Kur njeriu ka fuqi e mundësi, por kalon në ruku drejtpërdrejt nga qëndrimi ulur, ose i thotë mendja që të bëjë rukunë duke qenë ulur, namazi i tij është prishur.

Para se të kalohet në ruku, është mustehab të thuhet “All’lëhu Ekber”, si dhe, pasi njeriu ngrihet prej rukusë dhe, pasi ka drejtuar trupin plotësisht, thotë “Semiall’lëhu limen hamideh”. Pastaj thotë “All’lëhu Ekber!”

Kalon në sexhde.

Sexhdja

6- Ka thënë: “Biri i Ademit e bën sexhden me shtatë kocka: me dy duart, me dy këmbët, me dy gjunjët dhe me ballin e tij.”

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) për sexhden e bërë mbi një vend të ngritur. Ai është përgjigjur: “Kur vendi ku ti vë ballin, është më i ngritur se madhësia e një qerpiçi nga vendi ku është trupi yt, nuk ka problem.”

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) për një burrë që në ballë ka një çiban dhe për pasojë nuk ka mundësi të bëjë sexhden. Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) është përgjigjur: “Ai bën sexhde në anën flokëve. Në qoftë se nuk ka mundësi as në anën e flokëve, atëherë ai e bën sexhden me vetullën e tij të djathtë. Nëse as me këtë anë

s'ka mundësi, ai e bën sexhden me vetullën e tij të majtë. Nëse nuk ka mundësi as me këtë anë, atëherë e bën sexhden me mjekrën e tij." Pyetësi tha: "Ka plagë edhe në mjekër. Si duhet të veprojë ky njeri? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: "A nuk e lexuar librin e Allahut të Gjithëpushtetshëm, që thotë:

"يَجُزُونَ لِلْأَذْقَانِ سُجْدًا"

"...ata lëshohen në sexhde në fytyrë për tokë..." (Sure "El Isra", ajeti 107)

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për njeri që harron të bëjë sexhden e dytë, por, kur ngrihet në këmbë, kujtohet, ndërkaq është në këmbë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha: "Le ta bëjë sexhden, derisa nuk ka rënë akoma në ruku. Por nëse ai kujtohet, pasi ka bërë edhe rukunë, le të vazhdojë faljen e namazit dhe, pasi të japë selam, le të bëjë sexhden, e cila tani është sexhde e prapambetur (kadà)."

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha: "Nëse ai dyshon për sexhden, pasi është ngritur në këmbë, le të vazhdojë namazin, sepse për çdo veprim të namazit që ai dyshon nga veprimet që ka kryer më përpara, ndërkaq ka filluar veprimin pasardhës, ai le të vazhdojë faljen e namazit aty ku u kujtua."

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ngrihet prej sexhdes dhe, para se të marrë drejtqëndrimin e plotë, dyshon dhe nuk është i qartë, nëse bëri apo nuk bëri sexhde. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha: "Ai bën sexhden."

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se në çdo rekat është detyrim të bëhen dy sexhde dhe të dyja sexhdet së bashku janë kusht. Namazi prishet, kur bëhen më shumë se dy sexhde, ose kur dy sexhdet lihen pa bërë, me qëllim ose nga harresa. Namazi nuk prishet kur njëra sexhde lihet ose shtohet nga harresa.

Kushti i sexhdes është: Vënia e ballit mbi tokë dhe detyrim në shkallën vaxhib, vënia në tokë e gjymtyrëve të tjera, me të cilat bëhet sexhdja, siç janë dy duart, dy gjunjët dhe dy gishtat e mëdhenj të këmbëve, plotësisht në këtë shkallë detyrimi është edhe këndimi i dhikrit në shexhde: “Subhàne rab’bijel a’là ue bihamdihi”, ose tri herë “Subhànall’lilàh”.

Në të njëjtën shkallë detyrimi është edhe siguria e qetësia gjatë kohës së këndimit të dhikrit në sexhde. Është kusht që sexhdja të bëhet mbi tokë, ose mbi sende që dalin prej tokës, përveç sendeve që hahen e vishen. Vendi ku bëhet sexhdja të jetë i sheshtë për vënien e ballit ose me një diferencë të vogël nga e sheshta, vendi të jetë solid, si dhe drejtimi i trupit në qëndrimin ndërmjet dy sexhdeve. Të gjitha këto veprime të sexhdes janë detyrim në shkallën e vaxhibit dhe nuk kanë asnjë ndërhyrje që ato të jenë kushte, pa të cilat nuk mund të bëhet sexhdja.

Kush ka në ballë ndonjë pengesë, e cila e pengon të bëjë sexhden, por kjo pengesë nuk e ka mbuluar ballin plotësisht, mundohet me të gjitha mënyrat ta bëjë sexhden me pjesën e shëndoshë të ballit, si për shembull, hap një gropë të vogël në tokë, ose merr një mjet të zgavruar të punuar prej tokës ose prej druri dhe mbi këtë mjet ai bën sexhden, në atë mënyrë që pjesa e

sëmurë bie në boshllëkun e këtij mjeti. Nëse kjo është e pamundur, atëherë ai e bën sexhden në njërën prej dy vetullave të tij. Por edhe nëse kjo është e pamundur, atëherë ai e bën sexhden mbi mjekrën e tij dhe, nëse të gjitha këto nuk i mundësojnë atij bërjen e sexhdes, atëherë ai e bën sexhden me shenjë.

Nëse ai harron një sexhde dhe kujtohet që e ka harruar, pasi ka mbaruar faljen e namazit, ose pasi ka rënë në ruku, ai e bën këtë sexhde, pasi të ketë falur namazin. Në qoftë se ai harron të bëjë një sexhde dhe kujtohet para se të kalojë në ruku, ai kthehet dhe bën këtë sexhde. Në qoftë se ai i harron të dyja sexhdet, i bën të dyja sexhdet, derisa nuk ka kaluar në ruku dhe, në qoftë se ka rënë në ruku dhe kujtohet se nuk ka bërë dy sexhdet, pasi ka përfunduar faljen e namazit, namazi i tij është prishur dhe ai ka detyrë të përsërisë faljen e namazit.

Kjo ishte dispozita e harresës, kurse dispozita e dyshimit tregon se ai ka detyrë të bëjë njërën sexhde ose të dyja sexhdet për të cilat ai dyshon, nëse kujtohet para se të kalojë në veprimin tjetër. Por nëse ai ka kaluar në veprimin tjetër, namazi i tij është i vlefshëm, prandaj ai s'ka përse të tregojë kujdes për dyshimin që pati. Më poshtë kjo çështje do të shpjegohet me hollësi.

Farzet (el erkàn)

Nga sa u tha deri tani, u bë e qartë se farzet e namazit janë pesë: nijeti, tekbiri i fillimit, qëndrimi në këmbë në kohën e këndimit të tekbirit të fillimit, si dhe tekbiri që këndohet, kur kalon në ruku. Për një rekat të vetëm, ka një ruku dhe dy sexhde. Është e vlefshme të citojmë atë që thuhet në librin “Miftàhul

Keràmeti”, në lidhje me këtë çështje. Autori i këtij libri, në vijim të fjalës së tij, për farzin e qëndrimit në këmbë në namaz, ka thënë: “Si bazë, të gjitha veprimet e namazit janë farz, në kuptimin që namazi prishet me shtimin ose me lënien mangët të këtyre veprimeve, me qëllim ose nga harresa, sepse adhurimi është sipas udhëzimit. Puna e njeriut që arrin të kuptojë obligimin, është ndërgjegjësimi. Por ai del prej këtij rregulli bazë, sapo të sjellë argumentin që i mundëson daljen dhe mbetet pjesa tjetër.”

Fukahatë, duke analizuar veprimet e namazit, kanë gjetur në namaz punë të shumta dhe argumenti tregon për mosprishjen e namazit, kur këto punë shtohen, ose bëhen mangët për shkak të harresës. Gjithashtu, fukahatë kanë gjetur edhe punë të tjera, prandaj ata i kanë reduktuar punët e namazit vetëm në pesë.”

Tesheh’hudi

7- Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Tesheh’hudi është i kryer, kur ti thua: “Esh’hedu en là ilàhe il’le-ll’llàhu vahdehù là sherijke lehù ue n’ne Muham’meden abduhù ue resùluhù.” “Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, ai është i Vetëm, për Atë s’ka shok e ortak dhe Muhamedi është rob i dërguari i Tij!”*

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Padyshim që prej plotësimit të agjërimit është dhënia e zekatit, sadakaja e fitrit, ashtu si për plotësimin e namazit është salavati mbi Profetin.”*

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se tesheh'huđi është detyrim të këndohet vetëm një herë në çdo namaz me dy rekate. Gjithashtu, është detyrim të këndohet dy herë në namazet me tri rekate dhe në namazet me katër rekate. Kush e le pa kënduar tesheh'huđin, me qëllim, namazi i tij është prishur. Mënyra e këndimit të tesheh'huđit është si vijon: "Esh'hedu en là ilàhe il'lall'llàhu vahdehù là sherijke lehù ue esh'hedu en'ne Muham'meden Resùlull'llàh, ell'llàhum'me sal'li alà Muham'medin ue alà àli Muham'med."

Autori i librit "El Medàrik" ka thënë: "Në mesin e fukahave është mjaft i përhapur reduktimi i detyrimit për tesheh'huđin në këtë fjalë. Nuk është detyrim të shtohet gjë mbi këtë fjalë, por as nuk plotësohet me më pak se kjo fjalë."

Selami

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Fillimi i namazit është tekbiiri dhe dalja prej namazit është selami."

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Kur ti thua: "Es'selàmu alejnà ue alà ibàdil'làhi-s'sàlihijne", kjo është dalja prej namazit."

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se selami është një e vërtetë ligjore e vënë, për të çliruar njeriun nga falja e namazit, në kuptimin që për

të tani lejohen veprimet që atij i ndaloheshin, sapo tha tekbinin e fillimit.

Formula e selamit është: “Es’selàmu alejnà ue alà ibàdil làhi sàlihijne, es’selàmu alejkum ue rahmetullàhi ue berekàtuhù”- “Paqe e shpëtim për ne e për robtë e mirë të Allahut, paqja, shpëtimi, mëshira e mirësitë e Allahut qofshin për ju!”

Shumë fukaha kanë thënë fetva (sentenca) se detyrim është njëri prej dy selameve. Por ai që fal namaz, nëse dëshiron, i këndon të dy selamet, ose, nëse dëshiron, mjaftohet vetëm me njërin selam. Disa fukaha kanë thënë se, kur thotë më përpara: “Es’selàmu alejkum ue rahmetu-ll’làhi ue berekàtuhù”, nuk lejohet që pas këtij selami të thotë: “Es’selàmu alejnà ue alà ibàdil-làhi-s’sàlihijne”; kurse shprehja: “Es’selàmu alejke ej’juhen’nebij’ju ue rahmetu-ll’làhi ue berekàtuhù”- “Paqja, shpëtimi, mëshira e mirësitë e Allahut qofshin për ty o Profet!, është mustehab dhe me fjalën e përbashkët të fukahave, është e varuar prej tesheh’hudit dhe jo prej selamit.

Ka prej fukahave që kanë thënë se në origjinë, selami nuk është detyrim, por është vetëm mustehab, prandaj lejohet lënia e tij. Autori i librit “El Xheuàhir” u është përgjigjur këtyre me transmetimet që kanë ardhur prej Ehli Bejtit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!), me veprimin e Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), me veprimin e shokëve të tij, me veprimin e brezit të dytë të myslimanëve (tàbi’inët), me veprimin e brezit të tretë të myslimanëve (tàbi’ij et’làbi’ijn), si dhe me veprimin e kujtdo që ka hyrë në këtë fe.

Sistemimi dhe vijueshmëria

Të gjitha pjesët e namazit janë të sistemuara e të saktësuara ligjërisht. Secila pjesë ka vendin e vet të veçantë, prandaj nuk lejohet që pjesa që është më prapa, të dalë përpara dhe as të vonohet pjesa që është përpara. Myslimani e fillon faljen e namazit me tekbirin, vijon me këndimin, pastaj bën rukunë, pastaj bën sexhden...etj.

Gjithashtu, është detyrim vijueshmëria ndërmjet pjesëve të namazit, duke filluar menjëherë me pjesën e radhës, sapo të përfundojë pjesa para saj, pa bërë asnjë ndarje mes pjesëve.

Veprime mustehab të namazit

1- Është mustehab të këndohet tekbiri, kur shkon në ruku dhe kur shkon në sexhde. Gjithashtu, të këndohet tekbiri pas ngritjes së kokës prej sexhdes, kur këndohet tekbiri i Kunutit dhe kur këndohen tri tekbiret pas përfundimit të selamit. Gjithashtu, është mustehab ngritja e duarve në të gjitha tekbiret, deri në lartësinë e bulave të veshëve.

2- Tekbiri i Kunutit, shkon në shkallën e përforcimit si mustehab, në të gjitha namazet e përditshme farz e në nafilet e namazeve përkatëse. Vendi ku këndohet tekbiri i Kunutit është pas këndimit në rekatin e dytë dhe para se të bëhet rukuja.

3- Ai që fal namaz, kur është në këmbë, shikon në vendin ku do të vërë ballin për të bërë sexhden. Kur është në ruku, shikon mes këmbëve të veta. Kur është në sexhde, shikon majën e hundës

së vet dhe, kur është duke kënduar tesheh'hudin e duke dhënë selam, shikon në brezin e tij.

4- Kur falësi i namazit është në këmbë, dy duart, me gishta të mbyllura, i shtrin mbi kofshët e veta, përkundrejt dy gjunjëve. Ai i vë duart mbi dy kupat e gjunjëve, kur është në ruku, i vë duart afër veshëve, kur thotë “Esh'hedu en là ilàhe il'lall'llàh ue esh'hedu en'ne Muham'meden resùlull'llàh” dhe i vë dy duart mbi kofshët e tij, kur është ulur.

* * *

PRISHËSIT E NAMAZIT

Prishësit e namazit janë:

1- Jashtëqitjet që prishin pastrimin. Kjo është e barabartë, qoftë kur ndodhin me qëllim, qoftë kur ndodhin nga harresa. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ishte duke falur namaz, ndërkaq ai e merr vesh se prej tij dolën gazra, por nuk nuhat as erën e nuk dëgjon as zë. Si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Ai përsërit abdesin dhe namazin.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që fal namaz dhe prej tij del një farë kungulli. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nëse fara është e ndotur me feçe, ai ka detyrë të përsërisë namazin dhe, nëse është duke falur namaz, ai e ndërpret faljen e namazit, rimerr abdes dhe përsërit namazin.”

2- Katër medh’hebet e Ehli Sunetit thonë: “Vënia e duarve njëra mbi tjetrën është mustehab, kurse mosvënia nuk e prish namazin.”

Fukahatë e shiiave, për çështjen e vënies së duarve njëra mbi tjetrën, kanë tri thënie. E para: Në namaz është haram dhe e

prish namazin. *E dyta*: është haram, por nuk e prish namazin. *E treta*: As nuk është haram e as nuk e prish namazin, me përjashtim të rastit kur njeriu e bën këtë, duke e konsideruar kërkesë dhe veprim të dashur në ligjin e fesë. Nuk ka asnjë problem, nëse ai e bën këtë pa ndonjë qëllim. Ndër fukahatë që mbështesin thënien e tretë është edhe Sej'jid El Hakijm, i cili, në pjesën e tretë dhe të katërt të librit "El Mustemsek", ka thënë: "Nga këto ti mëson sa e dobët është thënia për prishjen e namazit, për shkak se argumentet që flasin se është haram vënia e duarve njëra mbi tjetrën me qëllim dhe kjo është njëra prej pjesëve të namazit, nuk janë të besueshme, ose ai i vë duart njëra mbi tjetrën me qëllim. Namazi nuk është vlefshëm pa këtë veprim, ndryshe nuk do të kishte rrugë për të thënë se namazi është prishur... Gjithashtu, mësove sa e dobët është thënia se vënia e duarve njëra mbi tjetrën është haram, por nuk e prish namazin." Është e qartë se vënia e duarve në namaz njëra mbi tjetrën është përzgjedhje, pa pasur qëllim se ky veprim është i urdhëruar në ligjin e fesë, prandaj namazi që ai fal është i vlefshëm, gjithashtu mbi të nuk rëndon ndonjë mëkat.

Pavarësisht nga sa u tha, pjesa më e madhe e fukahave janë të mendimit se vënia e duarve njëra mbi tjetrën në namaz, është veprim haram dhe e prish namazin. Kur është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që fal namaz dhe ka vënë dorën e djathtë mbi dorën e majtë, i është përgjigjur: "*Është veprim që kërkon shlyerje mëkati, prandaj mos e bëj.*"

3- Namazi prishet kur ti kthen kokën prapa, ose djathtas, ose majtas me të gjithë trupin, ose me të gjithë fytyrën, në atë mënyrë që del nga kufiri i qëndrimit në drejtim të Kibles. Kurse

kthimi i kokës fare pak, pa lëvizur trupin, nuk ka ndonjë problem, derisa qëndrimi drejt Kibles është i plotë.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nëse ti flet, ose largon fytyrën nga Kibla, menjëherë përsërit faljen e namazit.” Babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur ke kthyer fytyrën në drejtim të Kibles, mos e kthe kokën në ndonjë drejtim tjetër veç Kibles, sepse të priset namazi që je duke falur. Për këtë çështje, Allahu i Lartësuar urdhëron e thotë:

“قَوْلَ وَجْهَكَ شَطْرَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ وَحَيْثُ مَا كُنْتُمْ فَوَلُّوا وُجُوهَكُمْ شَطْرَهُ ۚ”

“...kthehu në drejtim të Xhamisë së Shenjtë (Qabes) dhe kudo që të jeni, ktheni fytyrat tuaja nga ana e saj...” (Sure “El Bekare” ajeti 144)

Autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “E gjitha kjo është kur bëhet me qëllim. Nëse moskthimi në drejtim të Kibles ndodh nga shkujdesja, ose devijimi është aq pak dhe nuk e arrin as kufirin e kthimit kah e djathta ose kah e majta, nuk sjell ndonjë dëmtim në namaz. Por nëse devijimi e ka arritur kufirin dhe ai vazhdon të bëjë ndonjë veprim të namazit në këtë gjendje, në qoftë se është brenda kohës për faljen e namazit, ai e përsërit namazin, ndryshe nuk ka përsëritje.”

Kuptimi i këtij shpjegimi është: Kur falësi i namazit anohet pak dhe pastaj drejtohet para se të kryejë ndonjë veprim të namazit, në mënyrë absolute, namazi i tij është i vlefshëm. Por në qoftë se ai kryen ndonjë veprim të namazit në këtë gjendje që është, mbi të mbetet detyrimi të rifalë namazin, në rast se koha është e mjaftueshme, ndryshe nuk e fal kaza. Në qoftë se ai del krejtësisht nga qëndrimi në drejtim të Kibles, namazi i tij është

prishur, qoftë kjo dalje e tij me qëllim, ose nga shkujdesja. Prandaj ai e ka detyrim ta përsërisë namazin, kur namazi është brenda kohës që të falet si namaz i rregullt brenda kohës së tij (*edàen*). Nëse është jashtë kohës, atëherë e rifal si namaz të prapambetur (*kaza*).

4- Namazi priset, kur ai flet në namaz me qëllim, qoftë edhe kur thotë vetëm dy germa që s'kanë kuptim, ose thotë vetëm një germë, por që ka kuptim, kurse fjala e thënë në namaz nga shkujdesja, nuk e prish namazin, por e bën detyrim sexhden e harrimit, ashtu siç do të shikojmë më poshtë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Namazi priset nga fjala e thënë me qëllim, por, nëse flet nga harresa, nuk ke asnjë detyrim.*”

Natyrisht, kur dikush e përshëndet me selam atë që është duke falur namaz, ai ka detyrë t'i kthejë përshëndetjen me të njëjtën fjalë, pa shtuar as edhe një germë më shumë, ose i kthen përgjigjen më përpara, ose e vonon kthimin e përshëndetjes, me kusht që ajo të jetë përshëndetje islame. Por nëse përshëndetja nuk është përshëndetje islame, ai nuk ka detyrë të kthejë përshëndetjen, madje një gjë e tillë as që lejohet gjatë faljes së namazit. Muham' med bin Muslim tregon: “Hyra te Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ai po falte namaz. Unë e përshëndeta: ‘Es’selàmu aleje!’ (Paqe për ty!)’ Ai tha: ‘Es’selàmu aleje!’ Unë i thashë: ‘Si u gdhive?’ Ai heshti dhe, pasi përfundoi faljen e namazit, i thashë: ‘A kthehet përshëndetja me selam gjatë faljes së namazit?’ Ai tha: ‘Po, ashtu siç u tha për selamin, domethënë përshëndet me selam dhe kthimi i përshëndetjes është po me selam.’

5- E qeshura me zë të lartë, qoftë me vetëdashje, ose e imponuar, kurse buzëqeshja nuk sjell asnjë dëm mbi namazin.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Buzëqeshja nuk e ndërpret namazin, kurse e qeshura me zë, e ndërpret atë.”

6- Qarja me zë, vetëm atëherë kur qarja vjen prej frikës së Allahut. Transmetohet se dikush e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për qarjen në namaz. Ai është përgjigjur: “Në qoftë se ai qan nga përmendja e Xhenetit, ose e zjarrit, kjo është puna më e lavdëruar e namazit. Por nëse ai qan, ngaqë i kujtohet ndonjë i vdekur i tij, namazi i tij është prishur. Është thënë: Ky transmetim është i shkallës “*Daijf*” dhe nuk është prej atyre transmetimeve me të cilat punojnë fukahatë.

7- Çdo veprim në namaz, prej të cilit nuk mbetet më asgjë nga pamja e namazit. Argument për këtë është fjala e përbashkët e fukahave, gjithashtu edhe logjika, sepse kur shkon forma e namazit, që në bazë, s’ka mbetur asgjë nga namazi. Transmetimet e ardhura prej Profetit (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe prej Ehli Bejt të tij për veprimet që ata kanë bërë në namaz, ose veprime që kanë lejuar të bëhen gjatë namazit, janë nga lloji i paktë dhe të atilla që, kur bëhen gjatë namazit, nuk e fshijnë formën e namazit, siç është vrasja e një pleshti, e një akrepi e të tjera si këto.

8- Ngrënia e pirja janë veprime që e fshijnë formën e namazit, fshijnë frymën e namazit dhe qëllimin për të cilin falet namazi. Autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “Të gjithë fukahatë kanë këtë pretendim...”

Disa fukaha janë të çuditshëm, kur thonë se ngrënia e pirja gjatë namazit nuk e prishin namazin, por e prishin, kur hahet ose pihet shumë, si të gjitha punët e tjera jashtë namazit. Në të kundërt, në mënyrë absolute, në këtë punë, s’ka farë të mirë. E

kemi thënë më sipër se e mira është thënia: Trashëgimia, ngrënia e pirja e prishin namazin, pa pasur nevojën. I Dërguari dhe Ehli Bejti i tij nuk kanë ngrënë e nuk kanë pirë gjatë faljes së namazit, duke vënë në konsideratë përvuajtutësinë e atyre dhe largimin që ata kishin në namaz prej çdo veprimi që kishte lidhje me punët e kësaj bote, që të sillej si argument për madhështinë e veçantë të namazit.

9- Shumica e fukahave mendojnë se, kush thotë me qëllim “Amin”, pas këndimit të sures “Fatiha”, namazi i tij është prishur. Kështu ka thënë edhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur je prapa imamit dhe ai këndon “El hamdu lil’lâhi...” (Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun!), kur ai të mbarojë këndimin e sures, ti thuaj: “Elhamdu lil’lâhi rab’bil âlemijn” (Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun, Zotin e botëve!) dhe mos thuaj “Amin” (O Allah pranoje lutjen tonë!)¹

10- Dyshimi në rekatet e namazeve të mëngjesit, namazit të mbrëmjes, në dy rekatet e para të namazit të drekës, në dy rekatet e para të namazit të pasdites, në dy rekatet e para të namazit të mbrëmjes dhe në dy rekatet e para të namazit të darkës. Shpjegime më të hollësishme do të jepen në kapitullin: “Dyshimi”.

¹ Vetëm ndalimi për të thënë “Amin”, ose për të thënë dy germa ose më shumë, nuk është e mjaftueshme për të gjykuar për prishjen e namazit, sepse, në vetvete, ai nuk është urdhër për ndalim që të jetë prishës. Prandaj, në këtë rast, duhet të bëhet studim dhe të kërkohet një argument tjetër, që të vërtetojë prishjen e namazit. Më sipër kemi folur me hollësi për veshjen e grabitur, prandaj referohu në këtë kapitull. Sido që të jetë, ne i përmbahemi fjalës më në zë dhe angazhohemi me këtë fjalë, gjithnjë duke bërë kujdes që të mos zgjatemi shumë.

Përmbledhje

Kush le mangët njërën prej pjesëve të namazit, ose ndonjërën prej kushteve të namazit, ose ndonjërën prej cilësive të namazit, sipas të gjitha rregullave dhe bazave të përgjithshme, namazi i tij është prishur, përveç kur ka argument se veprimi i bërë prej tij në namaz nuk është prej atyre që e prishin namazin, siç është për shembull këndimi me zë në vend që të këndonte pa zë, veprimi me pasurinë e tjetrit me harresë ose nga injoranca, ose siç është ndotja me papastërti e rrobës, trupit, ose vendit ku do të bëhet sexhdja, ngaqë nuk e di, por jo kur harron.

* * *

HARRESA

Namazi është veprim pas veprimi

Namazi ka një sistem veprimesh me një renditje të posaçme, ka veprime të detyrueshme e të përcaktuara, mbi të cilat nuk lejohet as të shtohet e as të pakësohet ndonjë veprim prej veprimeve të namazit. Çdo veprim i detyrueshëm i namazit ka vendin e tij të caktuar dhe nuk lejohet që ai veprim të kryhet në një vend tjetër, sepse edhe mosrespektimi më i vogël i renditjes në kryerjen e veprimeve, i bërë me qëllim, ose nga injoranca, ose nga harresa në ndonjërin prej kushteve të namazit, ose në ndonjë pjesë prej pjesëve të namazit, ose në ndonjërin prej cilësive të namazit, bazuar në gjykimin e mendjes e të logjikës, vetvetiu sjell prishjen e namazit dhe mospranimin e tij, sepse moskryerja e kushtit është moskryerje e të kushtëzuarit, moskryerja e pjesës është moskryerje e të cilësuarit.

O Zoti im, vetëm në qoftë se vërtetohet me argument se Ligjvënësi që ka bërë detyrim namazin me këtë formë të veçantë, e pranon atë dhe është i kënaqur edhe atëherë kur nuk plotësohet kushti, ose pjesa, ose cilësia në ndonjërin prej gjendjeve, sepse këto janë prej Allahut dhe bëhen vetëm për Allahun, bazuar në

fitimin e kënaqësisë së Tij dhe është prej vullnetit të Tij; vetëm kur jemi plotësisht të vetëdijsëm për të gjitha këto, atëherë është arritur përvetësimi dhe orientimi sipas këtij vullneti. Me një fjalë, ne s’kemi të drejtë të devijojmë as një fije floku, e as më pak se kaq në çdo gjë që ka të bëjë me namazin, pa lejen e Ligjvënësit. Pikërisht ky është edhe kuptimi i thënies së fukahave se namazi është adhurim pas adhurimi, por patjetër duhet të vërtetohet teksti.

Ku është argumenti i veçantë?

Ti mund të pyesësh: Padyshim që kjo është e vërtetë. Por a ka ndonjë argument të veçantë prej Ligjvënësit se Ai është i kënaqur dhe mjaftohet me namazin e falur, edhe pa kryer të plotë ndonjërin prej kushteve të tij, ose ndonjërin prej pjesëve të tij, ose ndonjë cilësi të namazit në ndonjërin prej gjendjeve? Nëse supozojmë se një argument i tillë ekziston, cila është gjendja në të cilën falësi i namazit justifikohet krahas këtij argumenti? Cila është ajo gjendje në të cilën atij i falet kjo moskryerje e veprimit të namazit?

Përgjigje:

Gjendjet janë disa llojesh:

E para: Qëllimi. Njeriu shton ose pakëson, me qëllim, ndonjërin prej veprimeve të namazit, ose nuk respekton renditjen e sistemimin e veprimeve, këndon suren para sures “Fatiha”, bën sexhden para rukusë, ose nuk zbaton ndonjërin prej cilësive të

namazit, këndon me zë me qëllim aty ku duhet të këndojë pa zë, ose këndon pa zë aty ku duhet të këndojë me zë, ose nuk ka bërë pastrimin dhe nuk ka veshjen e kërkuar për faljen e namazit, ose flet e qesh me zë të lartë në namaz, pa përmendur këtu shumë veprime të tjera. Për të gjitha këto dhe për veprime të ngjashme si këto që u thanë, me fjalën e përbashkët të fukahave, me tekst dhe për shkak të domosdoshmërisë, gjykimi është prishja e namazit. Cili njeri me mend në kokë do të pranonte vlefshmërinë e namazit, krahas mosrespektimit e moskryerjes së ndonjërit prej veprimeve të namazit me qëllim?!

E dyta: Mospasja dijeni. Ai shton në namaz një veprim që është detyrë të lihet, ose le atë veprim që është detyrim të kryhet, duke injoruar se atë veprim ai e kishte detyrim ta kryente. Gjykimi për atë që s'ka dijeni është plotësisht si gjykimi për atë që e bën me qëllim. Shehu El-Hemedani thotë në librin "Misbâhul Fakijh": "S'ka asnjë kundërshtim të sipërfaqshëm, s'ka asnjë pretendim vetjak e kolektiv dhe s'ka asnjë dallim që mospasja dijeni ka të bëjë me lënien mangët e me shkurtimin."

Në të vërtetë, shkurtimi mund të jetë justifikim prej ndëshkimit e dënimit, ose prej shëndetit e shprishjes, të shprehura në shenjat pozitive, në të cilat s'ka dallim as mes të diturit e atij që s'ka dijeni dhe as mes shkurtuesit e të shkurtuarit. Kur ai që s'ka dijeni që shkurton pjesë të namazit, beson se namazi është detyrim të falet në atë mënyrë që e fal ai dhe vazhdon në këtë besim, ai nuk lirohet nga obligimi për të falur namazin të saktë dhe nuk ka dalë nga detyrimi që ka, sepse ai nuk po bën atë që realisht duhet të bëjë dhe nuk e ka përvetësuar urdhrin e Ligjvënësit. Nuk ka dyshim se udhëzimi që ai ka dhe përkushtimi që ai tregon, vërtetojnë se ai është njeri i mirë dhe qëllimin,

gjithashtu, e ka të mirë, por qëllimi i mirë është një gjë dhe përvetësimi i detyrimit, realisht, është një gjë tjetër.

Ky qëllim, në çdo doktrinë, nuk përputhet me realitetin¹, me përjashtim të rasteve kur argumenti tregon se ai është i penguar në ndonjërin prej veprimeve.

Është vërtetuar me argument se ai që s'ka dijeni, është i justifikuar për këndimin me zë e për këndimin pa zë, për ujin e grabitur me të cilin ai bën gusël ose merr abdes, për rrobën e rrëmbyer, për papastërtinë e vendit e të rrobës, për dispozitën e udhëtarit se në udhëtim ai ka detyrë të falë namazin të shkurtuar dhe jo të plotë. Më poshtë, për të gjitha këto, do të flitet me hollësi.

E treta: Dyshimi. Për dyshimin do të flitet në kapitullin vijues.

E katërta: Harresa. Dallimi ndërmjet atij që harron dhe atij që dyshon, qëndron në faktin se dyshuesi ngurron që në fillim dhe në mënyrë absolute nuk është i qartë për asgjë. Kurse ai që harron, e di dhe kujtohet mirë se ai e ka lënë pa bërë një punë thjesht nga pakujdesia. Nga kjo pikëpamje, i shkujdesuri është sinonim i atij që harron, prandaj shpesh fjala shkujdesje thuhet për harresën. Fjala harresë thuhet për shkujdesjen. Ky është edhe qëllimi që këtë kapitull ia kemi dedikuar dispozitës së harresës e të shkujdesjes.

¹ Kjo tërësi nuk përfshin hulumtuesin që gabon në studimin e tij, në të cilin ka dhënë më të mundshmen. Me tekst e me fjalën e përbashkët të fukahave, ai është i justifikuar. Por ne themi: Obligimet e përgjithshme nuk përfshijnë ato veprime që i kundërshton hulumtimi i tij dhe, kur hulumtimi e çon atë të mendojë se këndimi i sures nuk është detyrë, kur në fakt është detyrë, kjo nuk është detyrë në të drejtën e tij nga ana e bindjes dhe e përvetësimit.

Harrimi i farzeve

Më sipër kemi thënë se farzet e namazit janë pesë: nijeti, tekbiri i fillimit, qëndrimi në këmbë në kohën e tekbirit dhe gjatë kohës para rukusë, rukuja dhe dy sexhdet, çka do të thotë se forma dhe e vërteta e namazit është kështu siç është, prandaj nuk do të shikojmë në diturinë, në mospasjen dijeni, kujtimin dhe harresën, me të cilat plotësohen këto pesë farze. Prandaj themi se ai që nuk respekton ndonjë gjë nga këto farze, nga harresa, është si ai që nuk i respekton ato me qëllim. Për shembull: Kush le nijetin nga harresa dhe nuk kujtohet, derisa të këndojë tekbirin e fillimit, ose le tekbirin e nuk kujtohet, derisa të fillojë këndimin, ose le rukunë e nuk kujtohet derisa bie në sexhde, ose le sexhden e nuk kujtohet, derisa të bjerë në ruku, namazi i tij është i prishur dhe ai është i detyruar ta përsërisë faljen e namazit.

Lënia e nijetit e bën të detyrueshme prishjen e namazit, sepse në ligjin e fesë e në praktikën e zakonshme, nuk ka namaz pa nijet, kurse për lënien e tekbirit të fillimit, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), kur është pyetur për një burrë që harron të thotë tekbirin e fillimit, derisa thotë tekbirin për rukunë, është përgjigjur: *"Ai përsërit faljen e namazit."* Në lidhje me qëndrimin në këmbë, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"Kush e ka detyrë të falë namazin në këmbë, por është ndenjur dhe harron të ngrihet në këmbë, derisa fillon falja e namazit, ai ka detyrë ta ndërpresë namazin, të ngrihet në këmbë dhe të fillojë faljen e namazit nga e para, patjetër në këmbë."* Kjo tregon se namazi prishet, kur lihet rukuja dhe sexhdja, bazuar mbi transmetimin mjaft të përhapur: *"Namazi përsëritet vetëm për pesë elemente: pastrimi, koha, Kibla, rukuja e sexhdja."*, duke shtuar edhe shumë veprime të tjera.

Ky ishte gjykimi për lënien mangët të njërit prej këtyre pesë farzeve, kurse shtimi në nijetin, nuk mund të imagjinohet në mënyrë absolute. Por në të ka diferenca për raste shtrëngimi dhe dobësimi. Gjithashtu, nuk mund të përfytyrohet shtim në qëndrimin në këmbë, ose që të ketë ndonjë gjurmë shtimi në të, sepse pa tekbirin e fillimit e pa rukunë, qëndrimi në këmbë nuk mund të quhet prej farzeve të namazit, por me njërin prej këtyre të dyve, domethënë të tekbirit të fillimit të rukusë, nuk ka asnjë gjurmë prej qëndrimit në këmbë. Për të gjitha këto, autori i librit “El Xheuàhir”, ka thënë: “Nuk mund të përfytyrohet shtimi i qëndrimit në këmbë pa tekbirin e fillimit, ose rukunë.”

Për sa i përket shtimit të rukusë ose të dy sexhdeve, me fjalën e përbashkët të fukahave, ky shtim e prish namazin, kurse për shtimin e tekbirit të fillimit, autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë se ky shtim e prish namazin. Për këtë nuk kemi gjetur asnjë kundërshtim të mëparshmit e të mëvonshmit.

Por disa prej të mëvonshmëve të kohëve të fundit, në hulumtimet e tyre, në mënyrë të përmbledhur, janë shprehur për pavlefshmërinë e namazit, veçanërisht për lënien ose harrimin dhe jo për shtimin. Ky hulumtim i tyre nuk është pa ndonjë formë.

Harresa në veprimet jo farze

Kush le pa kryer ndonjërin prej veprimeve të detyrueshme të namazit, por jo farzet e tij, këtij njeriu do t’i kujtojmë një përmbledhje të asaj që thuhet në librin “El Xheuàhir”:

1- Ai nuk ka detyrë as të plotësojë atë çka la pa e kryer e as të bëjë sexhden e harrimit pas namazit dhe është si ai që harron këndimin, derisa bie në ruku. Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Kush e le këndimin me qëllim, ai e përsërit faljen e namazit dhe ai që e harron këndimin, ai e ka plotësuar namazin e tij dhe mbi të nuk rëndon asnjë detyrim.”*

Bazuar në tekst e në fjalën e përbashkët të fukahave, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për atë që harron dhe këndon me zë, aty ku duhet të këndonte pa zë, ose këndon pa zë, aty ku duhet të këndonte me zë, madje, edhe nëse për këtë kujtohet para se të kalojë në ruku, ai nuk ka detyrë ta plotësojë atë çka la mangët, por ai rikthehet, kur kapërcen një fjalë nga këndimi dhe kalon një fjalë tjetër. Argumentet tregojnë se ai, në mënyrë absolute, nuk është i kushtëzuar me ndonjë send apo të kryejë ndonjë veprim. Të njëjtën gjë ka thënë edhe shehu El Hamedanij në librin “Misbàhul Fakijf”.

Në lidhje me atë që harron të këndojë suren “Fatiha” ose suren, derisa të kalojë në ruku, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Në qoftë se nuk ka rënë në ruku, le të kthehet e të këndojë suren “Fatiha”.”*

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Imam Aliu është pyetur për një burrë që ka rënë në sexhde dhe nuk thotë tesbijhatet. Si duhet te veprojë ky burrë? Ai është përgjigjur: “Namazi i tij është plotësuar.”*

Kush harron qetësinë e zemrës në kohën e rukusë, derisa të ngrejë kokën, ose harron të ngrejë kokën prej rukusë, ose harron qetësinë e zemrës në kohën e ngritjes, derisa bën sexhden, mbi atë nuk rëndon asnjë detyrim. Për këtë s’ka asnjë kundërshtim,

gjithashtu, mbi të nuk rëndon asnjë detyrim, kur harron dhikrin që këndohet në sexhde, ose harron qetësinë e zemrës në sexhde, derisa të ngrejë kokën prej sexhdes, ose harron të vërë në tokë njërin prej shtatë pjesëve të trupit, me të cilat bëhet sexhdja. Më pas, autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Mbështetësit, në të gjitha këto, janë njëri prej dy punëve: ose mbylljen e mangësive që kërkon zgjatjen e farzit, ose veprimin sipas fjalës së përbashkët të fukahave.”

2- Ai ka detyrë të plotësojë mangësitë e shkaktuara nga harresa, por ai nuk ka detyrë të bëjë sexhdet e harrimit. Ai është si personi që harron të këndojë suren “Fatihë” dhe këndon vetëm suren që këndohet pas Fatihësë, pastaj kujtohet për këtë para se të kalojë në ruku, ashtu siç u tha në transmetimin e që cituam më lart: “Në qoftë se nuk ka kaluar në ruku, le të kthehet e të këndojë suren “Fatihë”.” Kështu qëndron puna, edhe nëse harron rukunë, por pastaj kujtohet para se të bjerë në sexhde. Në këtë rast, ai ka detyrë të ngrihet në këmbë dhe të bjerë në ruku. Në qoftë se ai harron të dyja sexhdet, ose harron njërën prej dy sexhdeve dhe për këtë kujtohet para se të kalojë në ruku, ai kthehet dhe kryen atë çka harroi, pastaj ngrihet në këmbë dhe këndon ose bën tesbijhatet, sipas obligimit të ligjit të fesë. Për këtë nuk ka asnjë kundërshtim në mesin e fukahave. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka harruar të bëjë sexhden e dytë, derisa është ngritur më këmbë, atëherë ai është kujtuar se nuk e ka bërë sexhden. Si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai le të bëjë sexhden, nëse nuk ka rënë në ruku, ose ka bërë rukunë dhe kujtohet se nuk ka bërë sexhden, ai le të vazhdojë namazin që është duke falur, të japë selam dhe pastaj le të bëjë sexhden kaza.”

3- Pas namazit, ai ka detyrë të plotësojë atë çka e la mangët nga harresa, të bëjë dy sexhdet e harrimit, si dhe ai që le njëren sexhde pa bërë, ose ai nuk këndon tesheh'hudin, ose le salavatën për Profetin (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe nuk kujtohet derisa të bëjë rukunë. Këto fetva janë shumë në zë, madje “janë aq shumë në zë, sa të thuash se janë në gradën e fjalës së përbashkët të fukahave”.

4- Ai ka detyrë të bëjë vetëm sexhden e harrimit, pa falur kaza e pa plotësuar asgjë, kur ai flet nga harresa, ose nga harresa këndon tesheh'hudin, ose jep selam jo në vendin e tesheh'hudit e të selamit, ose dyshon, nëse ka falur katër apo pesë rekate, ashtu siç do vijë më poshtë. Autori i librit “El Xheuàhir, ka thënë: “Kjo është më e përhapura në mesin e shokëve, domethënë fukahave, të mëparshëm e të mëvonshëm, dhe është në përputhje me tekstet e cituara dhe me përfundimet e arritura nga studimet. Në “Sahijhun” e Ibn Haxh'xhàxhit thuhet: “Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që harron dhe flet në namaz dhe thotë: “Drejtoni safët.” Si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai plotëson namazin e tij, pastaj bën dy sexhdet e harrimit dhe të tjera.”

Thuhet: Dy sexhdet e harrimit janë të detyrueshme për çdo shtesë e për çdo lënie mangët, me kusht që këto shtesa e mangësi të mos jenë për shlyerjen e veprimeve që prishin namazin. Autori i librit “El Xheuàhir, duke shpjeguar këtë fjalë, tekstualisht ka thënë: “Ne nuk e dimë qartësisht se kush e ka thënë këtë fjalë para autorit.¹⁽¹⁾

¹ Ai është Xhaferr bin Hasan, i njohur me epitetin muhak'kiku (studiuesi) El Hil'lij. Ka vdekur në vitin 676 hixhreti. Është autor i librit “Esh Sheràiu”, të cilin

Madje në mësimet, ai është shprehur se ne nuk e njohim as personin që e ka thënë këtë fjalë e as burimin nga e ka marrë.”

E njëjta gjë është thënë në librin “Misbàhul Fakijh” të shehut El Hamedànij. Këta dy studiues të nderuar kanë thënë: “Transmetimet që sjell si argument ai që thotë këtë fjalë, në të vërtetë, tregojnë shumë shkurt. Argumenti që ai sjell, është i gradës “*Daijf*”, domethënë se përcjellësit e tij nuk i plotësojnë të gjitha kushtet e kërkuara që transmetimi të jetë në gradën e besueshmërisë së plotë.” Për të gjitha këto, gjykimi për detyrimin për të bërë sexhden e harrimit për çdo shtesë e për çdo lënie mangët, nuk është e ndërtuar mbi ndonjë bazë.

Mënyra e bërjes së sexhdes së harrimit

Kush ka detyrë të bëjë dy sexhdet e harrimit, duhet të presë derisa të përfundojë faljen e namazit dhe të japë selam dhe, para se të vijë te fjala “Esh’hedu en là ilàhe”, bën nijet dy sexhdet për afrimin te Allahu i Lartësuar. Është mustehab të thotë “All’lilàhu Ekber”, pastaj bën sexhden dhe thotë: “Bismil’làhi ue bil’làhi, sal’li alà Muhamedin ue alà àli Muhamed!” (“Me emrin e Allahut dhe për Allahun! O Zoti im, dhuro paqe e bekim për Muhamedin e për familjen e Muham’medit!”), pastaj ngre kokën, pastaj bën sexhde dhe këndon lutjen e mësipërme, edhe në sexhden e dytë, pastaj ngre kokën, këndon tesheh’hudin dhe pastaj jep selam.

e kanë komentuar dijetarët. Konsiderohet komenti më i madh, Por libri më i madh i fik’hut të shi’at është libri “El Xheuàhir”, i shehut Muhamed Hasan En Nexhefij, vdekur në vitin 1266 hixhreti.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në dy sexhdet e harrimit ti thuaj: “Bismil’lâhi ue bil’lâhi sal’li alà Muham’medin ue alà àli Muham’med!”, ose thuaj: “Es’selâmu alejke ej’juhen’nebij’ju ue rahnetull’llâhi ue berekatuhu!” - “Paqja, shpëtimi, mëshira e mirësitë e Allahut qofshin për ty o Profet!” Thuhet se lutjen në sexhden e harrimit e shlyen çdo lutje në përgjithësi.

Përmbledhje

Nga sa u tha më sipër, për ne u bë e qartë se çdo shtim e çdo lënie mangët, me qëllim në veprimet e namazit, e bëjnë të detyrueshme prishjen e namazit dhe përsëritjen e tij. Kurse çdo moskryerje veprimi nga shkujdesja ose nga harresa, nuk e prish namazin, siç mund të jetë shtimi i një rekati në ndonjërin prej pesë farzeve ose lënia mangët e tyre. Gjithashtu, ka edhe veprime të shtuara, ose të harruara, që, në mënyrë absolute, nuk sjellin asnjë detyrim e asnjë plotësim, madje as sexhden e harrimit, siç mund të jetë harrimi i këndimit, moskujtimi e mosvëmendja për lënien e veprimit vetëm pas rukusë, kurse lënia e disa veprimeve bëjnë detyrë vetëm plotësimin, por jo sexhden e harrimit, siç mund të jetë për shembull harresa e këndimit të sures “Fatihâ”, për të cilën ai kujtohet para se të kalojë në ruku. Të tjera veprime bëjnë detyrë sexhden e harrimit, por jo plotësimin, siç është rasti i atij që flet në namaz nga shkujdesja ose ngaqë harron. Të tjera veprime bëjnë detyrë plotësimin dhe sexhden e harrimit, siç është rasti i atij që harron të këndojë tesheh’hudin, ose salavatit mbi Profetin (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Çështje

1- Kur njeriu harron ndonjërin prej farzeve të namazit dhe kujtohet që ka harruar para se të hyjë në farzin tjetër, ai e kryen veprimin që harroi, si dhe veprimin që vjen pas tij. Për shembull, harron të bëjë sexhden, ose të këndojë tesheh'hudin dhe, pasi është ngritur në këmbë, fillon këndimin, por kujtohet para se të kalojë në ruku, ai i bën veprimet që la pa plotësuar nga harresa dhe vazhdon veprimet sipas radhës së përcaktuar në ligjin e fesë. Kur ai kujtohet, pasi ka hyrë në farzin tjetër të namazit, ai nuk e ka detyrë të plotësojë atë që la, pavarësisht se si është veprimi që ai la pa e bërë, sepse plotësimi sjell shtim të farzit, çka në vetvete është prishës i namazit.

2- Kur ai harron rukunë dhe kujtohet, pasi ka bërë sexhden e parë, por para se të kalojë në sexhden e dytë, sipas thënies më në zë të fukahave, namazi i tij është prishur.

3- Kur ai qartësohet se ka lënë pa bërë dy sexhdet, por nuk e ka të qartë nëse ishin të dyja në një rekat, për pasojë prishin namazin dhe bëjnë detyrim përsëritjen e namazit, apo secila nga dy sexhdet ishin në rekate të veçanta, për pasojë namazi në këtë formë është i vlefshëm dhe mbetet detyrë të bëhen kaza vetëm dy sexhdet? Kur problemi shtrohet në këtë formë, është detyrë të veprohet me rezervë, vetëm me përsëritjen e namazit, sepse ai, në përgjithësi, e di që është i obliguar, ose të përsërisë namazin, ose të bëjë kaza dy sexhdet. Nëse e përsërit namazin, ai ka dalë nga përgjegjësia dhe dituria, në përgjithësi, ka gjetur zgjidhje, sepse ai, në këtë rast, është në kuadrin e supozimit. Nëse dy sexhdet e harruara janë në të njëjtin rekat, atëherë detyra e tij është të përsërisë faljen e namazit dhe ai këtë e bëri, ose supozon që secila

nga dy sexhdet të jenë në rekate të veçanta, atëherë ai ka detyrë të bëjë kaza dy sexhdet dhe këtë ai e bëri brenda namazit. Atëherë, ai tani e di se në çdo gjendje është jashtë detyrimit.

4- Kur ai bie në ruku, pastaj kalon në sexhde pa e drejtuar trupin, në qoftë se ai kujtohet, pasi ka bërë të dyja sexhdet, namazi i tij është i vlefshëm dhe ka detyrë të bëjë sexhden e harrimit. Por nëse ai kujtohet, pasi ka bërë vetëm sexhden e parë dhe para se të bëjë sexhden e dytë, prej shehut El Ensàrij, me fjalën e përbashkët të fukahave, ai nuk kthehet të marrë drejtqëndrimin më këmbë. Padyshim që e mira është që ai të përsërisë namazin.

5- Kur ai harron të marrë abdes, ose të bëjë gusël, ose të bëjë tejemum, namazi i tij është prishur.

6- Kur nga shkujdesja ai harron dhe bën sexhde mbi një vend të ndotur me papastërti, ose mbi një send prej kafshës që nuk i hahet mishi, ose mbi një send metalik, namazi i tij është i vlefshëm.

7- Në pjesën e dytë të librit “Miftàhul Keràmeti”, në faqen 290, thuhet: “Shtimi i farzit është i falur në disa vende:

“Nga këto vende”: Kur ai që fal namazin me Imam bie në ruku para Imami, duke kujtuar se Imami ka rënë në ruku, por pastaj qartësohet se Imami akoma nuk ka rënë në ruku, ai drejton trupin, ndjek Imamin dhe bën ruku për herë të dytë së bashku me Imamin, namazi i këtij njeriu është i vlefshëm.

“Nga këto vende”: Kur ai që fal namaz, dyshon në ruku para se të hyjë në sexhde, ai e bën rukunë, por, para se të ngrejë kokën, qartësohet se në të vërtetë ai e ka bërë rukunë, ai kalon

menjëherë në sexhde dhe sipas Dëshmorit të parë të grupit të tij, namazi i tij është i vlefshëm.

“Nga këto vende”: Kur ai që fal namaz, dyshon për numrin e rekateve të namazit të darkës ose të namazit të drekës e të namazit të pasdites, ai e vazhdon faljen e namazit, duke llogaritur numrin më të vogël të rekateve që mendon se ka falur dhe fal një rekat rezervë. Por, pasi përfundon namazin, për të bëhet e qartë se namazi që ai fali është i mangët, në këtë rast rekati rezervë që ai fali, e plotëson namazin, prandaj namazi i tij është i vlefshëm dhe është i falur nga mëkati për shtimin e nijetit e të tekbirit të fillimit.

“Nga këto vende”: Kur udhëtari e fal namazin të plotë në vend që të falte namaz të shkurtuar, duke mos e ditur, ose harron se detyra është të falë namaz të shkurtuar, por për këtë ai kujtohet, pasi ka dalë koha e faljes së namazit, namazi i tij është i vlefshëm dhe shtesa që ai bëri është e falur.

Më poshtë do të flitet më gjerë për këtë çështje.

“Nga këto vende”: Kur ai fillon të falë namaz për eklipsin, por më pas e shikon se ka mbetur pak kohë për të falur namazin e përditshëm farz, të cilin ai akoma nuk e ka kryer, ai e ndërpret namazin për eklipsin dhe fal namazin farz. Pasi të përfundojë namazin farz, kthehet e vazhdon namazin për eklipsin, aty ku e ndërpreu më parë.

* * *

DYSHIMI

Më sipër thamë se dyshues është njeriu në mëdyshje, që ngurron dhe nuk është i bindur për veprimin që në fillim. Tani do të flasim për dispozitën e dyshimit në namaz dhe për disa anë të dyshimit gjatë faljes së namazit: Kemi dyshimin për hyrjen e për daljen e kohës së faljes së namazit, dyshimin për kushtet e namazit e për pjesët e tij, por jo për rekatët. Gjithashtu, kemi edhe dyshimin për numrin e rekateve. Tani le të shpjegojmë dispozitën për të gjitha llojet e dyshimit.

Dyshimi për origjinën e namazit

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur ti vërteton ose dyshon për kohën e një namazi farz, të cilin nuk e ke falur, ose kur ti vërteton, ose dyshon për kohën e një namazi që të ka mbetur pa falur, por që në të vërtetë e ke falur, nëse ti dyshon, pasi ka dalë koha për faljen e tij dhe ka hyrë koha për faljen e namazit pasardhës, ti nuk ke detyrë ta përsërisësh faljen e atij namazi, derisa të vërtetosh plotësisht se nuk e ke falur, atëherë ke detyrim ta falësh atë namaz në çdo gjendje që të jesh.”

Fukahatë

Fukahatë janë shprehur: Ai që dyshon dhe nuk e di, nëse e fali apo nuk e fali namazin farz, ai shikon: Nëse ka akoma kohë, ai ka detyrim ta falë atë namaz, plotësisht ashtu siç e fal ai që e ka vërtetuar se nuk e ka falur. Por nëse ky dyshim i vjen jashtë kohës për faljen e atij namazi, ai s'ka asnjë detyrim për ta plotësuar atë, derisa të arrijë të vërtetojë se me të vërtetë nuk e ka falur atë namaz.

Dyshimi pas përfundimit të namazit

Imam Sadiku (Paqja goftë mbi të!) ka thënë: *“Kur dikush dyshon, pasi ka përfunduar faljen e namazit, ai nuk e përsërit namazin dhe mbi të nuk rëndon asnjë detyrim.”*

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja goftë mbi të!) ka thënë: *“Për çdo dyshim që ti ke për namazin që fale, pasi e ke përfunduar namazin, vazhdoje namazin dhe mos e përsërit faljen e atij namazi.”*

Për këtë çështje, të gjithë fukahatë kanë një fjalë të përbashkët.

Dyshimi për kushtet e namazit

Kur njeriu dyshon për një kusht prej kushteve të namazit, si pastrimi e veshja, nëse dyshimi i vjen para se të fillojë faljen e namazit, ai ka detyrë të bëjë kujdes e të sigurohet nga të gjitha anët, ashtu siç veprohet për të gjitha kushtet.

Në qoftë se dyshimi atij i vjen gjatë faljes së namazit, ai e ndërpret namazin. Në këtë rast nuk zbatohet rregulli i përfundimit në analogji me namazin, sepse ai nuk e ka përfunduar akoma namazin. Gjithashtu, nuk zbatohet as analogjia me abdesin dhe as me ndonjërin prej kushteve të tjera, sepse ai dyshon në origjinën e hyrjes e të daljes së kohës.

Në qoftë se dyshimi është pasi ai e ka përfunduar faljen e namazit, mbi të nuk rëndon asnjë detyrim, ashtu siç u tha në paragrafin e mësipërm. Por ai ka detyrë të bëjë kujdes për kushtet e tjera të namazit.

Dyshimi për punët e namazit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur ai nuk e di, nëse bëri vetëm një sexhde, apo i bëri të dyja sexhdet, le të bëjë edhe një sexhde tjetër.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që dyshon, kur është në këmbë dhe nuk e di, nëse e bëri apo jo rukunë. Si do të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai bën rukunë dhe sexhden.”

Ky shpjegim shërben, kur ai dyshon për ndonjë gjë para se të kalojë në veprimin tjetër.

Gjithashtu, është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që dyshon në ezanin, ndërkaq ka ardhur koha e këndimit të ikametit, madje ka kënduar edhe tekbirin. Si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai vazhdon faljen e namazit.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për dyshimin në tekbirin dhe ka filluar këndimin. Si duhet të veprojë ky burrë, duhet ta ndërpresë këndimin? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “*Le të vazhdojë.*” Përsëri është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) se ai dyshon për këndimin dhe ka kaluar në ruku. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “*Le të vazhdojë.*” U pyet: “*Ai dyshon për rukunë, ndërkaq ka rënë në sexhde.*” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “*Le të vazhdojë.*” Më në fund Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Kur ti del prej një veprimi dhe ke hyrë në veprimin pasardhës, dyshimi yt nuk është asgjë.*” Kjo është kur ai dyshon në ndonjë send, pasi ka kaluar në veprimin tjetër.

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: Dyshimi në ndonjërin prej punëve të namazit, por jo dyshimi për rekatet, ndahet në dy pjesë:

E para: Dyshon në një send, para se të kalojë prej veprimit që është në vendin e vet në një veprim tjetër, si për shembull, kur dyshon për nijetin para se të këndojë tekbirin, ose dyshon për tekbirin, para se të fillojë këndimin e sures, ose dyshon për këndimin, para se të bëjë rukunë, ose dyshon për rukunë, para se të bjerë në sexhde, si dhe për veprime të tjera nga ato që nuk e kapërcejnë vendin e veprimit për të cilin dyshohet. Fukahatë kanë dhënë fetva se ai ka detyrim të kryejë veprimin për të cilin dyshon, pasi në këtë gjendje, origjina e çështjes, mbështetur në transmetimet e Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*) është përforcuar.

E dyta: Ai dyshon për një veprim, pasi ka tejkaluar vendin e atij veprimi dhe ka hyrë në një veprim tjetër, si për shembull, dyshon për tekbinin, kur është duke kënduar suren, ose dyshon për këndimin, kur është në ruku, ose dyshon për rukunë, kur është në sexhde, si dhe për të gjitha veprimet, kur e ka kaluar vendin e kryerjes së tyre dhe ka hyrë në kryerjen e një veprimi tjetër. Fukahatë kanë dhënë fetvanë se ai vazhdon namazin, dyshimi është anuluar dhe ai nuk e kryen veprimin për të cilin dyshoi. Ata kanë pohuar se në lidhje me këtë çështje, kemi edhe mendime të kundërta, të bazuara në transmetimet e vërtetuara të ardhura prej burimit të Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*).

Meriton të theksohet se qëllimi me frazën: “kalim prej vendit të veprimit të dyshuar”, do të thotë se ai kryen një veprim prej veprimeve të namazit dhe jo ndonjë veprim të huaj, që nuk është prej veprimeve të namazit. Gjithashtu, vendi i atij veprimi të jetë i vonuar në renditjen për veprime që ai ka dyshim. Për sa i përket veprimit tjetër që ka hyrë dhe ai është tërësisht i përqendruar në kryerjen e atij veprimi, qëllimi është për çdo veprim të namazit në përgjithësi, qoftë këndim, ose veprim tjetër. Kush dyshon në këndimin si tërësi ose pjesërisht dhe ai është në veprimin tjetër vijues, ose ai dyshon për çdo veprim, ndërkaq ka hyrë në një veprim tjetër, si për shembull, kur ai dyshon për rukunë, ndërkaq po bie në sexhde, ose është në sexhde dhe është ngritur në këmbë, të gjitha këto, si dhe veprimet vijuese, e anulojnë dyshimin dhe ai vazhdon të plotësojë faljen e namazit. Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Sikur ai të jetë shumë dyshues, madje prej disave kemi pretendimin e fjalës së përbashkët të fukahave dhe kjo fjalë është argumenti, duke shtuar

fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nëse ai dyshon për sexhden, pasi është ngritur më këmbë, le të vazhdojë namazin.”

Dyshimi për numrin e rekateve

Dyshimi për numrin e rekateve ndodh në disa forma. Prej këtyre formave ka që janë prishëse të namazit dhe disa të tjera nuk janë prishëse të namazit. Dyshimi prishës i namazit është në disa pjesë:

1- Dyshimi për namazin e mbrëmjes, për namazin e mëngjesit dhe për namazin e udhëtarit, në mënyrë absolute, e bën të detyrueshme prishjen e namazit, me fjalën e përbashkët të fukahave e me tekst. Nga tekstet, kemi fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur ti dyshon për namazin e mbrëmjes, menjëherë përsërite faljen e këtij namazi. Kur dyshon për namazin e mëngjesit, menjëherë përsërite. Kur nuk e di, nëse fale një rekat apo fale dy rekate, përsërite namazin nga e para, gjithashtu, edhe për namazin e xhumasë, kur harron Imami, ka detyrë ta përsërisë faljen e namazit, sepse edhe namazi i Xhumasë është me dy rekate.”

Çdo tekst tjetër që kundërshton këtë tekst të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), është i deformuar dhe i lënë. Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “sepse ai është dy rekate”, shërben si tekst kundër dobësisë së gjykimit dhe është në pozitën e fjalës së Imamit: “Çdo dyshim për namazet dy rekateshe e bën detyrim prishjen dhe pavlefshmërinë e atyre namazeve.”

2- Dyshimi mes një rekati e më shumë. Ky dyshim, me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, është prishës i

namazit. Autori i libri “El Xheuàhir” ka thënë: “Tekstet për këtë çështje janë të shumta, edhe pse janë me shkëputje në vargun e përcjellësve, por ato, me të gjitha llojet e argumenteve, tregojnë për prishjen e namazit.” Nga këto tekste kemi fjalën Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur ti dyshon dhe nuk e di, nëse ti je në një namaz tre rekatesh, apo në një namaz dy rekatesh, apo në një namaz me një rekat, apo në një namaz me katër rekate, atëherë përsërite namazin dhe mos vazhdo të falësh namaz me dyshim.”

3- Dyshimi mes dy rekateve e më shumë, para se të plotësohen dy sexhdet. Dyshimi për këtë gjendje çon në dyshimin për dy rekatet, për pasojë ai që është duke falur namazin dhe nuk është i sigurt, nëse i ka plotësuar apo nuk i ka plotësuar ato dy rekate, atëherë prishja e namazit është domosdoshmëri. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kush dyshon për dy rekatet e para, e përsërit namazin, derisa të ruajë në mendje dhe të jetë i sigurt, domethënë, të jetë krejtësisht i bindur se i ka plotësuar të dy rekatet.”

4- Në qoftë se ai që fal namaz, dyshon, kur është në rekatën e katërt, nëse i ka falur dy rekatet e fundit apo ka falur pesë rekate, namazi i tij është i prishur, edhe nëse dyshimi i ka ardhur atij, pasi ka kryer dy sexhdet. Edhe ky namaz, në të gjitha gjendjet, është i prishur. Nëse në realitet, ai ka falur vetëm dy rekate, namazi prishet për shkak se u la mangët dhe, nëse ai ka falur pesë rekate, përsëri namazi është prishur për shkak të shtimit.

Veç kësaj, theksojmë se dyshimi që e bën detyrë vlefshmërinë e namazit është pikërisht ai dyshim mbi të cilin ai ndërton namazin me numrin më të shumë të rekateve të falur, por të ndërtuar vetëm mbi njërin anë të dyshimit, me kusht që vijimi i namazit, të ndërtuar mbi dyshimin, të mos kundërshtojë

vlefshmërinë e namazit. Nuk ka dyshim se ndërtimi i namazit mbi pesë rekate nënkupton prishjen e namazit për shkak të shtimit.

5- Dyshimi në numrin e rekateve të namazit të xhumasë dhe të dy Bajrameve. Në lidhje me këtë, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Në qoftë se nuk e di se sa rekate ke falur dhe kujdesi yt nuk bie mbi ndonjë numër të caktuar, atëherë përsërite namazin.”*

Dyshimi i saktë

Këtu do të flasim për gjendjet e dyshimit për numrin e rekateve, që nuk e bën të detyrueshëm prishjen e namazit. Madje namazi me këtë dyshim është i vlefshëm dhe i kryer, me kusht që dyshimi të jetë vetëm për katër rekatet. Nga këto gjendje kemi:

1- Kur dyshon, nëse ka falur dy rekate apo tre rekate, pasi ka kryer edhe dy sexhdet. Në këtë rast, ai e vazhdon namazin, bazuar mbi rekatën e tretë dhe fal rekatën e katërt, këndon tesheh’hudin dhe jep selam, para se të kryejë ndonjë veprim që i kundërshton këto. Pastaj, për rezervë, ai fal një rekat, duke u nisur nga qëndrimi në këmbë, ose fal dy rekate, duke qenë ulur. Gjithsesi, rekatë i falur në këmbë, në këtë gjendje, është më i preferuar se dy rekatet e falur ulur. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i ka thënë njërit prej shokëve të tij: *“Dëgjo, a dëshiron të të mësoj një gjë, të cilën ti e bën në faljen e namazit, por, pasi e ke bërë, mendohesh, nëse e ke bërë të plotë apo e ke lënë mangët dhe, që mbi ty të mos rëndojë asnjë detyrim? Kur të dyshosh, vazhdoje namazin, duke u bazuar mbi numrin më të madh të rekateve që ke falur. Pasi të përfundosh namazin e të japësh selam, ngrihu dhe fal nga namazi aq sa mendon se ke lënë mangët. Nëse ti e ke falur namazin të plotë, mbi ty*

nuk rëndon asnjë send. Por në qoftë se kujtohesh se me të vërtetë e ke lënë mangët, rekatet që fale pas përfundimit të namazit janë plotësim i asaj që le mangët.”

Qëllimi i Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është fare i qartë, me këtë shembull: Një burrë dyshoi, nëse ka falur tre apo ka falur katër rekate. Ai e vazhdon namazin sikur ka falur katër rekate dhe pas përfundimit të namazit, ai fal një rekat rezervë. Në këtë rast, namazi i tij bazë nuk është i paplotësuar. Dyshimi ishte nëse ai, në fakt, kishte falur tri rekate apo kishte falur katër rekate. Nëse ishin tri rekate, u plotësuan me rekatën rezervë dhe, nëse ishin katër rekate, rekatë rezervë është nafile. Kjo gjendje është e ngjashme me rastin kur ti i ke borxh një personi një shumë, por ti dyshon, nëse i ke borxh tre dirhemë apo katër dirhemë. Ti i jep atij katër dirhemë. Në qoftë se shuma që kërkohej ishte plotësisht katër, atëherë, në mënyrë laksative, ti ke dalë nga detyrimi, gjithashtu, në qoftë se shuma që të kërkohej ishte vetëm tre dirhemë, dirhemi që dhe më shumë, shkruhet bamirësi e sadeka.

2- Kur ai dyshon, nëse ka falur tre apo ka falur katër rekate namaz, në çdo pjesë të namazit që të ndodhet, ai do të vazhdojë namazin sikur ka falur tri rekate, pastaj fal edhe rekatën e katërt, këndon tesheh’udin, jep selam dhe pastaj, për rezervë, fal një rekat namaz, duke u nisur nga qëndrimi në këmbë, ose fal dy rekate, duke qenë ulur, plotësisht ashtu siç thamë për herën e parë, me ndryshim se kësaj here është më e pëlqyeshme të falë dy rekate ulur. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që nuk e dinte, nëse fali tri rekate namaz apo fali katër rekate. Për më tepër, kur hamendja i tij për të dyja gjendjet ishte e barabartë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Kur hamendja barazohet në tre dhe në katër, atëherë ai ka të dejtë të

përzgjedhë, nëse dëshiron, fal një rekat, duke qenë në këmbë, nëse dëshiron, fal dy rekate ulur dhe bën katër sexhde."

3- Kur ai dyshon, nëse fali tre apo fali katër rekate, pasi ka plotësuar dy sexhdet, ai e vazhdon namazin, sikur ka falur katër rekate dhe, pasi plotëson namazin, për rezervë, duke qenë në këmbë, fal edhe dy rekate. Imami Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"Kur ti nuk e di, nëse fale dy rekate apo katër rekate dhe hamendja nuk të shkon në asnjë anë, këndo tesheh'hudin, jep selam, pastaj fal edhe dy rekate me katër sexhde. Në të dy rekatet do të këndosh suren "Fatiha", pastaj këndo tesheh'hudin dhe jep selam. Nëse ti kishe falur vetëm dy rekate, këto dy rekatet e fundit plotësojnë namazin me katër rekate dhe, nëse ti kishe falur të katër rekatet, dy rekatet rezervë janë namaz nafile."*

4- Kur dyshon, pasi ka plotësuar dy sexhdet, nëse ka falur dy apo katër rekate, ai e vazhdon namazin, sikur ka falur katër rekate, plotëson namazin dhe pastaj, për rezervë, fal dy rekate namaz në këmbë dhe dy rekate të tjerë ulur. Është më e pëlqyeshme, më përpara, të falen dy rekatet në këmbë dhe më pas të falen dy rekatet ulur.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që fal namaz, por nuk di, nëse ka falur dy rekate, ka falur tri rekate, apo ka falur katër rekate, si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *"Ai ngrihet në këmbë dhe fal dy rekate në këmbë, jep selam, pastaj fal dy rekate ulur dhe jep selam."* Në qoftë se ai kishte falur katër rekate, dy rekatet janë namaz nafile, ndryshe janë plotësuar katër rekatet e namazit.

5- Kur dyshon, nëse ka falur katër rekate apo ka falur pesë rekate, në këtë rast, ai shikon: Nëse dyshimi i vjen, kur është në këmbë, ulet dhe, me këtë veprim, dyshimi i tij kthehet ndërmjet tri

rekateve dhe katër rekateve, atëherë ai e vazhdon namazin, sikur ka falur katër rekate dhe plotëson namazin. Pastaj fal ulur dy rekate, ose fal një rekat në këmbë.

Nëse dyshimi i vjen, pasi ka bërë dy sexhdet, ai e vazhdon namazin sikur ka falur katër rekate, këndon tesheh'hudin, jep selam dhe pastaj bën dy sexhdet e harrimit.

Në qoftë se ai qartësohet, pasi ka përfunduar faljen e namazit se namazi që ai fali është i mangët, namazi është i vlefshëm dhe ai nuk ka detyrim ta përsërisë atë. I njëjti gjykim është, edhe kur për të bëhet e qartë gjatë kohës që është duke falur rekatet rezervë se namazi që ai fali ishte i mangët. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nëse namazi ishte i mangët, atë e plotësojnë rekatet rezervë dhe përfshihen të dyja gjendjet së bashku.”

Dyshimi në namazet nafile

Dyshimi në numrin e rekateve në namazet nafile nuk e prish namazin dhe ai që fal namaz, ka të drejtë të përzgjedhë: nëse dëshiron, e vazhdon namazin, bazuar mbi numrin më të vogël të rekateve që ka falur. Kjo është më e pëlqyeshme, ose, nëse dëshiron, e vazhdon namazin, bazuar mbi numrin më të madh të rekateve, me kusht që ky numër më i madh të mos jetë prishës i namazit. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për harrimin në namazet nafile dhe ai ka thënë: “Mbi ty nuk rëndon asnjë detyrim.”

Thuhet se ai që fal namaz, ka të drejtë ta ndërpresë namazin nafil dhe pastaj, nëse dëshiron, e rifillon nga e para.

Dyshimi i shumtë

Kushdo që ka shumë dyshim, ai le të vazhdojë faljen e namazit dhe, në mënyrë absolute, të mos bëhet merak për dyshimin e tij. Kjo është e barabartë, qoftë kur dyshimi i tij është për numrin e rekateve, qoftë kur është për veprime të tjera të namazit, ose për këndimin. Gjithashtu, është e barabartë, kur dyshimi është për hyrjen e kohës, ose për daljen e kohës, ose dhe për vlefshmërinë e namazit. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që i vijnë shumë dyshime për namazin që fal, madje i vijnë aq shumë, sa ai nuk di sa rekate ka falur dhe sa i kanë mbetur për të falur. Çfarë duhet të bëjë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Përsërit namazin.”

Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) i thanë: “Kjo është shumë, sepse atij i kthehet dyshimi shpesh.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Le të vazhdojë namazin, krahas dyshimit të tij... mos ia bëni zakon të keqit nga vetja juaj prishjen e namazit, sepse kështu ju e ushqeni atë. Bëni kujdes. Djalli është i keq dhe sulmon me atë që i bëhet zakon. Prandaj secili prej jush le të vazhdojë namazin, krahas hamendjes dhe mos e shumoni prishjen e namazit. Nëse ai e bën shpesh këtë, atij nuk do t’i kthehet më dyshimi. I keqi do që t’i bindeni atij, por, kur ai kundërshtohet, nuk kthehet më te asnjëri prej jush.”

Mënyra e faljes së namazit rezervë

Në faljen e namazit rezervë është detyrim gjithçka që është detyrim në faljen e namazeve të pavarura: pastrimi, veshja, mosgrabitja, kthimi në drejtim të Kibles, nijeti, tekbiri i fillimit, këndimi, që është vetëm këndimi i sures “Fatiha” dhe jo këndimi i

suress dhe as Kunuti. Gjithashtu, në namazin rezervë është detyrim të bëhet ruku e sexhde, të këndohet tesheh'hu di dhe të jepet selam. Në namazin rezervë është detyrë që këndimi të bëhet pa zë, sepse në këtë namaz nuk lejohet këndimi me zë.

Ky është një argument i qartë se ai namaz është i pavarur dhe nuk është pjesë prej namazit farz. Ajo që është e mjaftueshme me namazin rezervë, është vlerësimi për mangësinë e namazit, e cila nuk mund të mendohet që është pjesë e namazit. Autori i librit "El Xheuàhir" ka thënë: "Patjetër që në namazin rezervë duhet nijeti e tekbiri i fillimit dhe nuk është i mjaftueshëm as nijeti i parë e as tekbiri i parë. Në lidhje me këtë namaz, ka tekste dhe janë dhënë feta, që ky është namaz i pavarur prej namazit të parë dhe ka ndodhur pas përfundimit të namazit të parë me selam. Gjithashtu, namazi rezervë është urdhëruar të kryhet në veçanti me tesheh'hud e me selam të veçantë. Të njëjtin shpjegim jepet edhe te libri "Misbàhul Fakijh" i shejkh El Hamedànij.

Çështje

1- Kur atij i vjen dyshimi dhe herën e parë ai nuk e vazhdon faljen e namazit mbi numrin më të shumtë të rekateve që ka falur, por e plotëson namazin, pastaj fal namazin rezervë. Në radhë të parë, do të qe më mirë që ai të meditonte pak, mbase kështu do t'i kalonte dyshimi dhe do të arrihej qetësimi i zemrës.

2- Kur atë që fal namaz e mposht hamendja dhe dyshimi anon i barabartë nga të dyja anët, ai vepron plotësisht sipas mendimit të vet, ashtu siç vepron kur është plotësisht i sigurt për veprimin e bërë. Shehu El Hamedànij ka thënë në librin e tij

“Misbàhul Fakijh”: “Kjo është thënia më në zë. Hadithi profetik tregon: “Kur dyshon ndonjëri prej jush, ai le të mendojë mirë.”

Autori i librit “El Urvetul Vuthkà” ka thënë: “Hamendja në numrin e rekateve është sipas gjykimit të asaj që ai di më mirë dhe është e barabartë, qoftë kur dyshimi është në dy rekatet e para, qoftë kur është në dy rekatet e pasmë.

3- Kur ai jep selam dhe pastaj prej tij del gjë ndonjë prej atyre që e prishin namazin, si për shembull, ai flet në namaz me qëllim, ose të tjera veprime prej prishësve të namazit, para se ta falë namazin rezervë, ai ka detyrim ta falë të plotë namazin rezervë ashtu siç duhet të falet dhe pastaj përsërit namazin që po falte, sepse ai e di mirë që është i obliguar ta falë namazin.

* * *

FALJA E NAMAZIT KAZA

Parathënie

1- S'ka dyshim se falja e namazit kaza ndjek faljen e namazit në kohën e vet dhe është degë e këtij të fundit. Kur njeriu nuk i përgjigjet dot detyrimit në origjinën e tij, patjetër që është më mirë të kryejë degën e dalë prej origjinës. Shembulli më i qartë për këtë është fëmija dhe i çmenduri, të cilët, në mënyrë absolute, nuk janë të obliguar me asgjë nga punët e fesë. Si fëmija dhe i çmenduri është edhe ai që ka humbur vetëdijen, por që i kthehet në kohën e faljes së namazit. Prej Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*) transmetohet: *"Ai s'ka asnjë detyrim. Ai nuk kryen kaza as agjërimin e as namazin, sa herë që mbi atë mposhtësh është Allahu, prandaj, në radhë të parë, justifikimi kërkohet vetëm te Allahu."*¹

Kjo është kërkesa bazë e detyrueshme, që duhet të ndiqet, krahas mospasjes së argumentit, që të vërtetohet kundërtën. Kur

¹Shejkh El Hamedanij ka thënë në librin "Misbàhul Fakijh": "Njoftimet tregojnë detyrimin që ka për të falur kaza namazin, ai që ka humbur vetëdijen (përkohësisht), megjithëse, në gradën mustehab. Kjo gjë është njoftuar prej Sadukut, Shejkhut e prej të tjerëve, përveç këtyre të dyve. Madje në librin "El Hadàik", detyrimi për atë që ka humbur vetëdijen është shumë i njohur.

argumenti vërtetohet të kundërtën, atëherë është detyrim të lihet baza dhe të ndiqet argumenti. Argumentet e ligjit të fesë, bëjnë të qartë për ne se disa nga ato janë në përputhje të plotë me bazën dhe nuk shprehen në kundërshtim me të. Si shembull shërben fëmija, i çmenduri dhe personi që ka humbur dy pastrimet (abdesin e guslin), sepse asnjë prej këtyre që u përmendën, nuk kanë detyrim të falin namazin as kaza e as në kohën e vet (*edàen*). Gjithashtu, nuk e kanë farz të falin namazin, as kaza e as namazin në kohën e vet, gratë në periudhën e menstruacioneve dhe gjatë periudhës së hemorragjisë së lehonisë.

Të tjera raste kemi kur është detyrim që adhurimi të kryhet kaza dhe jo në kohën e vet, siç është kryerja e agjërimit kaza prej gruas për ditët e agjërimit që ka lënë për shkak të menstruacioneve, ose për shkak të hemorragjisë së lehonisë. Të tjera argumente tregojnë se është detyrim që adhurimi të kryhet në kohën e vet dhe jo kaza, siç është rasti i mohuesit (kàfir) me rrënjë e me degë, i lindur prej babe e nëne mohuese, i cili, në të vërtetë, është i obliguar plotësisht me të gjitha urdhërimet e fesë, kurse te fukahatë ai është i obliguar në origjinë, megjithëkëtë ai nuk ka detyrim të falë kaza namazet që nuk ka falur namaz, para se të pranonte Islamin.

Në lidhje me këtë çështje i Dërguari më madh (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Islami shemb ato që ishin para tij.”

2- Obligimi bie me njërin prej të treve: bindje dhe kryerja e punës prej të obliguarit, ashtu siç është urdhëruar të kryhet dhe kundërshtimi me ngritjen e subjektit. Për shembull: Kur një person, bindja ndaj të cilit për ty është detyrim, të thotë:

“Respektoje Zejdin, në filan datë.” Në qoftë se ti e respekton Zejdin në atë datë, detyrimi që kishe, ka rënë, pasi ti e përvetësove urdhrin. Në qoftë se ti nuk e respekton atë deri në datën e caktuar, detyrimi që kishe, gjithashtu, ka rënë, sepse veprimi i urdhëruar ishte që të kryhej në kohë të përcaktuar. Prandaj, me kalimin e kohës së caktuar për kryerjen e tij edhe urdhërimi bie, por ti, si kundërshtues, meriton dënimin. Gjithashtu, edhe kur ngrihet objekti, siç mund të jetë rasti: Zejdi vdes para datës së caktuar, atëherë detyrimi që kishe, ka rënë dhe ti nuk përgjigjesh për asgjë. Por argumenti tregon që kundërshtuesi ka detyrë të kryejë obligimet që i kanë mbetur pa kryer.

Me lejen e Allahut, shumë shpejt do ta trajtojmë këtë çështje.

3- Obligimet e ligjit të fesë përfshijnë dijetarin dhe atë që s’ka dijeni për obligimet e fesë. Gjithashtu, obligimet përfshijnë atë që harron dhe atë që kujtohet gjatë kryerjes së veprimit, ose pas kryerjes së veprimit, përfshijnë atë që është në gjumë dhe atë që është zgjuar. Kurse dallimi ndërmjet këtyre qëndron vetëm në masën e dënimit, sepse dijetari, ai që kujtohet dhe ai që është zgjuar, dënohen, kur lënë pa kryer obligimin, por s’ka dënim për atë që është në gjumë, as për atë që e le, ngaqë nuk ka dijeni për obligimin e as për atë që harron, derisa të qëndrojë pengesa që e justifikon lënien e obligimit. Por kur ai që s’ka dijeni, mëson, kur ai që harron, kujtohet dhe ai që është në gjumë, zgjohet, këta kanë detyrim ta plotësojnë faljen e namazit që s’kanë falur, kur është brenda kohës. Gjithashtu, kanë detyrim që namazin e humbur ta falin kaza, kur koha e faljes së atij namazi ka kaluar.

4- Ai që ka njërin prej dy prindërve mysliman dhe një herë të vetme e le pa falur namazin, duke e konsideruar hallall lënien e

namazit, megjithëse e di mirë se namazi është detyrim që duhet të kryhet patjetër, ai menjëherë ka dalë prej Islamit dhe në origjinën e tij të krijimit është bërë renegat, për pasojë është hallall që ai të ekzekutohet si renegat, sepse ai mohoi atë që e dinte se ishte e vërtetuar si domosdoshmëri e fesë, përveçse kur pretendon ndonjë dyshim të mundshëm në të drejtën e tij, siç mund të jetë, për shembull, rasti kur ai është lindur e rritur në një vend ku s'ka kush ta mësojë dhe s'ka asnjë gjurmë prej Islamit e prej myslimanëve. Ky shfajësim ndodh kur kufijtë shtrembërohen me dyshimet.

Në qoftë se ai ka lindur prej dy prindërve mohues dhe vetë ka pranuar Islamin, pasi ka arritur moshën, kur njeriu ngarkohet me obligimet e fesë, por më pas ai bëhet renegat, duke konsideruar hallall lënien e namazit, për bashkësinë islame (*mil'letul Islam*) ai është renegat, por ai nuk është renegat në origjinën e krijimit të tij. Ky renegat i nënshtrohet rregullit që e urdhëron atë të bëjë teube dhe, nëse nuk bën teube, madje edhe këmbëngul për të mos bërë teube, atëherë është hallall që ai të ekzekutohet, përveçse kur pretendon ndonjë dyshim të mundshëm në të drejtën e tij, siç mund të jetë, për shembull, rasti kur ai sapo e ka pranuar Islamin.

Për sa i përket atij që e lë faljen e namazit nga shkujdesja, por ai nuk e konsideron hallall lënien e namazit, beson se falja e namazit është detyrim dhe nuk e mohon namazin si detyrim, këtë njeri sundimtari e qorton. Në rast se ai e le përsëri namazin, sundimtari e qorton për herë të dytë. Në rast se ai përsëri e le namazin, sundimtari e qorton edhe për herë të tretë dhe, nëse ai e lë përsëri, atëherë për herë të katërt, ekzekutimi i tij është bërë hallall.

Falja e namazit kaza është detyrim

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që fal namaz pa pastrim, ose ai e ka harruar dhe nuk është falur, ose në kohën e namazit e ka zënë gjumi. Si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai e kryen faljen e namazit në çdo orë të natës e të ditës, që të kujtohet.” Në qoftë se hyn koha për faljen e namazit të radhës dhe ai akoma nuk e ka falur namazin që ka lënë, le të vazhdojë ta falë namazin kaza, nëse nuk ka frikë se i kalon koha për faljen e namazit të radhës, sepse ky namaz ka më shumë të drejtë të falet në kohën e vet, prandaj ai le të falë namazin e radhës dhe vetëm, pasi ta përfundojë atë, le të falë namazin kaza që ndërpreu, pa e plotësuar. Por ai nuk fal rekatin e vullnetshëm, derisa ta kryejë të gjithë farzin.

Gjithashtu, është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që i ka mbetur pa falur namazi në udhëtim dhe kujtohet që nuk e ka falur, vetëm kur kthehet në vendbanimin e tij. Si duhet të veprojë ai? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai fal kaza namazin që humbi, ashtu siç e humbi.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se kujt i mbetet pa falur një namaz farz, ai ka detyrim ta falë atë namaz kaza, qoftë kur e ka lënë pa falur me qëllim, qoftë kur e ka harruar. Siç u tha më sipër, edhe gjumi hyn në dispozitën e harrimit.

Ai që pi pije që çojnë drejt çmendurisë ose drejt humbjes së mendjes, nëse vjen në vete, ai ka detyrim ta falë kaza namazin e lënë, sepse shkakun ai e sajoi me vullnetin e me përzgjedhjen e tij, prandaj është plotësisht e drejtë që ky njeri të quhet person që ka lënë namazin pa falur. Pikërisht për këtë shkak, ai nuk mund të renditet në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “*Sa herë që atë e mposht Allahu, në radhë të parë, ndjesa i kërkohet Allahut.*”

Ai që e ka detyrim faljen e namazit të Xhumasë, por e lë, derisa kalon koha, ai fal namazin e drekës me katër rekate. Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Kujt i mbetet pa falur namazi i Xhumasë për shkak se nuk e arrin, ai le të falë katër rekate namaz.*”

Ai që nuk arrin ta falë namazin e Bajramit, por e konsideron detyrë, ai nuk ka detyrim të falë namaz kaza. Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Ai që nuk fal namazin e Ditës së Bajramit me Imam e me xhemat, ai nuk ka detyrim ta falë kaza këtë namaz.*”

Kujt i mbetet pa falur një namaz farz gjatë udhëtimit, ai e fal këtë namaz kaza të shkurtuar, edhe nëse është në vendbanim. Por kur le pa falur një namaz farz në vendbanim, ai ka detyrë ta falë këtë namaz kaza të plotë, edhe nëse është në udhëtim. Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Kush humb një namaz, e fal atë ashtu siç e humbi.*”

Fale namazin kaza, ashtu siç e humbe, fal kaza namaz të shkurtuar në vendbanim, namazin e humbur në udhëtim dhe në udhëtim fal kaza të plotë namazin e humbur në vendbanim.

Dikush është udhëtar në fillim të hyrjes së kohës për faljen e namazit dhe është në vendbanim në fundin e kohës, domethënë: Nëse do ai ta falte namazin në fillim të kohës, do të falte namaz të shkurtuar dhe, nëse do ta falte namazin në fundin e kohës, ai do ta falte këtë namaz të plotë. Sikur çështja do të paraqitej e kundërta e kësaj që u tha, domethënë që ai ishte në vendbanim në fillim të kohës për faljen e namazit dhe u bë udhëtar në fundin e kohës për faljen e atij namazi, por atij i mbeti pa falur namazi farz, ky person, a duhet ta falë kaza të shkurtuar apo të plotë këtë namaz?

Përgjigje

Ky njeri ka detyrë të shikojë se ç' detyrime kishte, nëse do ta kishte falur namazin në kohën e vet. Nëse ai kishte detyrim që këtë namaz ta falte të shkurtuar në kohën e vet, ai e fal këtë namaz kaza të shkurtuar edhe jashtë kohës, siç mund të jetë rasti kur ai është banor vendas në fillim të kohës dhe udhëtar në fundin e saj, në qoftë se ai kishte detyrë që namazin ta falte të plotë brenda kohës, përsëri ka detyrim ta falë atë namaz kaza të plotë jashtë kohës së tij, ose ai është udhëtar në fillim të kohës dhe banor vendas në fundin e kohës.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai që harron të falë katër rekate, le të falë kaza katër rekate, udhëtar ose banor vendas qoftë dhe, ai që harron dy rekate, kur të kujtohet, do të falë dy rekate, qoftë udhëtar ose banor vendas.

Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët, se atij që i mbetet pa falur një namaz farz, është i detyruar ta falë patjetër atë namaz kaza në kohën e namazit të radhës, nëse koha është e mjaftueshme

që ai të falë dy namazet njëri pas tjetrit, ndryshe ai fal kaza namazin që humbi dhe pastaj fal namazin e radhës brenda kohës së vet. Në qoftë se koha është shumë e ngushtë, aq sa mjafton vetën për të falur namazin e radhës, ai ka detyrë të falë më parë namazin e radhës dhe të lërë namazin kaza, sepse namazi i radhës ka më të drejtë të falet në kohën e vet. I këtij mendimi është edhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*).

Por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, nëse namazi kaza duhet të falet menjëherë, sapo t'i kujtohet, apo lejohet që ai ta shtyjë faljen e namazit kaza dhe nuk është i detyruar që më parë të plotësojë namazet që i kanë mbetur pa falur, pasi ai që ka për të falur kaza namazet e humbura, është më mirë të falë namazin e radhës në fillimin e kohës së tij, të merret me adhurime e me veprime të tjera dhe namazin kaza ta shtyjë për një kohë tjetër?

Përgjigje:

Nuk është detyrim që namazi i humbur të falet menjëherë, por lejohet që falja e tij kaza të shtyhet për kohë tjetër, sepse urdhri nuk tregon që duhet falur menjëherë, sepse origjina e mosmbajtjes përgjegjësi e mohon detyrimin për faljen e tij menjëherë.¹

¹ Në shkencën e bazave të ligjit të fesë është saktësuar, se, sa herë bëhet fjalë për hedhjen e fjalës mbi një kuptim që ka nevojë për shpjegime shtesë dhe në hedhjen e saj mbi një kuptim që nuk ka nevojë për shpjegime shtesë, del detyrë të përmbahemi në të parën, sepse baza është që të mos ketë shtesë, derisa të vërtetohet e kundërta. Prandaj shpejtimi është një punë e shtuar mbi bazën e detyrimit. Për këtë s'ka shpjegim, sepse mohon bazën.

Kjo është fjala më e përhapur në kohët e hershme e në kohët e mëvonshme. Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Është thënia më në zë ndërmjet fukahave të mëvonshëm.” Madje në librin “Edh Dhekhijreh” thuhet se është edhe thënia më në zë të mëparshmit. Edhe në librin “El Mesàbijh” thuhet se kjo thënie është më në zë në të gjitha shtresat e fukahave tanë të mëparshëm e të mëvonshëm. Më poshtë, autori i librit “El Xheuàhir” thotë: “Në fakt, këtë e vërteton vijueshmëria e fjalëve të tyre.” Pastaj ai përmend dhjetëra emra fukahash të mëdhenj.

Shejkh El Hamedànij, në librin “Misbàhul Fakijh”, ka thënë: “Më e fuqishme është thënia më në zë ndërmjet fukahave të mëvonshëm se sa fjala për gjerësi të ndërsjellë.” Mbase thënia e mësipërme është mjaft e njohur, edhe te fukahatë e mëparshëm, edhe pse atyre u atribuohet, në më shumë se në një vend, thënia e përhapur për ngushtim të kohës dhe për vlerësimin e realizimit të raportit. Prandaj thënia më në zë tek të mëvonshmit është shumë më e besueshme në këtë pozitë, ashtu siç nuk mund të fshihet forma e kësaj thënieje.”

Thënia e fukahave të mëvonshëm është më e besueshme, duke ditur devotshmërinë dhe përkushtimin e të gjithëve, megjithëse i mëvonshmi është njohur me fjalën e të mëparshmit e me argumentin e tij. Këtë dituri e argument ai e ka shtuar mbi njohjen e teorive të ripërtërira e të lëvizjeve ideore. Përveç faktit që dituria nuk qëndron e ngurtë, në të kundërt, dituria është lëvizje këmbëngulëse dhe e vazhdueshme, prandaj dijetari i vërtetë mendon vazhdimisht, shkruan e ushqehet në mendimet e tij. Nisur nga ky fakt, si i mëvonshëm, ai është më i besueshëm, sepse i mëparshmi, edhe nëse ishte në të drejtën, pasuesi e thekson dhe

e përforcon, por, nëse i mëparshmi nuk ishte në të drejtën, pasuesi e korrigjon gabimin.

Nga sa u tha më sipër, u bë e qartë se koha për faljen e namazit të lënë pa falur është mjaft e gjerë, prandaj namazi që është detyrim të falet në kohën e vet dhe në vendbanim, në mënyrë absolute, nuk mund të ngushtohet në kohën e tij. Pikërisht ky është edhe qëllimi i fukahave kur kanë lëshuar shprehjen: “Gjerësi e ndërsjellë”. Qëllimi i tyre me fjalën “ngushtim”, është detyrimi për të nxituar e për të shpejtuar faljen e namazit të humbur. Pavarësisht se krijohet një lloj konkurrence mes faljes së namazit të lënë para namazit të radhës në kohën e vet, kur koha është e mjaftueshme, nuk lejohet të falet namazi i radhës para namazit të humbur, përveç rastit kur koha për faljen e namazit të radhës është tepër e ngushtë dhe ka mbetur aq kohë sa brenda asaj kohe mund të falet vetëm namazi i radhës. Me një fjalë, namazi i humbur merr prej namazit të radhës aq kohë sa është e nevojshme për faljen e tij, qoftë në fillim të hyrjes së kohës, qoftë në mesin e kohës. Kur për të falur kaza namazin e humbur, ka mbetur vetëm koha e fundit, mbi të cilën nuk mund të shtohet asnjë çast për faljen e namazit të humbur, atëherë më parë falet namazi i radhës.

Ky ishte kuptimi i grupit emëror “ngushtim i ndërsjellë”. Ashtu siç thamë më lart, thënia për faljen me përparësi të namazit të lënë, është thënie e lënë dhe s’ka asnjë argument që të tregojë në favor të saj. Për sa i përket thënies së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ai fal kaza namazin e humbur në çdo orë të natës e të ditës që i kujtohet.”, tregon se falja kaza e namazit të humbur është detyrim dhe nuk lejohet të lihet pa u falur, por nuk tregon se duhet të shpejtohet dhe duhet të falet menjëherë, kurse për namazin e

radhës nuk është detyrim nxitimi për ta falur atë në fillim të kohës. Nuk ka dyshim se me fjalën e përbashkët të fukahave, është mustehab që namazi të falet në kohën e vet ose kaza sa më parë. Sikur të kishte argument që tregon nxitimin, patjetër që ai do të kishte vepruar sipas këtij argumenti.

Falja e namazeve kaza sipas radhës

I është thënë Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Një njeri humb namazin e drekës, të pasdites e të mbrëmjes dhe kujtohet për këtë në kohën e namazit të darkës. Si duhet të veprojë?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai fillon me kohën në të cilën nuk është i siguruar nga vdekja, pasi ai e ka lënë pa falur namazin farz, kur kishte hyrë koha për faljen e atij namazi, prandaj, kur të falë kaza namazet e lëna, të falë të parin e pastaj të dytin dhe të tretin, sipas radhës që i ka lënë ato namaze.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur ti harron një namaz, ose e ke falur namazin pa abdes, kur kishe detyrim të kryeje kaza namazet e lëna, atëherë fillo të falësh kaza namazin e parë të lënë dhe pastaj sipas radhës vazhdo të falësh kaza namazet e tjera.”

Fukahatë

Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët, se ai që lë pa falur disa namaze dhe e di radhën e namazeve të lëna, ai ka detyrë t’i falë kaza ato namaze, sipas radhës që i ka lënë, fal të mëparshmin, pastaj fal namazin që vjen pas të parit. Sikur të dijë se ka lënë pa

falur pesë namazet e një dite, duke filluar që nga namazi i mëngjesit, atëherë më parë do të falë kaza namazin e mëngjesit, para namazit të drekës, namazin e drekës, para namazit të pasdites, namazin e pasdites, para namazit të mbrëmjes dhe namazin e mbrëmjes, para namazit të darkës. Sikur të dijë se gjatë javës së kaluar ditën e diel ka lënë pa falur namazin e pasdites dhe ditën e hënë ka lënë namazin e drekës, ditën e martë ka lënë pa falur namazin e darkës dhe ditën e mërkurë ka lënë namazin e mbrëmjes, ai fal kaza namazin e pasdites, para namazit të drekës dhe namazin e darkës, para namazit të mbrëmjes. Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Për këtë s’ka asnjë kundërshtim në mesin e fukahave.”

Kur ai nuk e di radhën e namazeve të humbura, ka detyrim të përsërisë faljen e namazeve, derisa të arrijë të mësojë plotësisht. Nëse një ditë ai ka lënë pa falur namazin e drekës dhe një ditë tjetër ka lënë pa falur namazin e pasdites, por nuk e di se më parë ka lënë pa falur namazin e darkës, apo më parë la pa falur namazin e pasdites, në këtë gjendje ai do të falë namazin e drekës dhe pastaj do të falë namazin e pasdites, pastaj kthehet e fal namazin e pasdites dhe pastaj fal namazin e darkës. Gjithsesi, renditja nuk është detyrë, edhe sikur të ketë dijeni, përveç pesë namazeve të përditshme, për faljen e namazeve të ajeteve e në namazeve nafile.

Namazi i falur për të vdekurin

Namazi për të vdekurin falet në disa lloje:

Dhurimi i shpërblimit

E para: Ai fal dy rekate namaz të vullnetshëm dhe shpërblimin e këtyre dy rekateve e dhuron për të vdekurin. Nuk ka dyshim se në ligjin e fesë ky veprim është i lejuar. Transmetohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) falte dy rekate namaz çdo natë për djalin e tij dhe falte dy rekate të tjera çdo ditë për babën e vet.

Gjithashtu, transmetohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Çfarë e pengon ndonjërin prej jush të bëjë bamirësi për prindërit e tij të gjallë e të vdekur, që për ata të dy të falë namaz, të japë sadaka dhe të agjërojë, le të jetë ai që bën bamirësi për dy prindërit e tij, pasi edhe ai për vete ka të njëjtin shpërblim, pasi Allahu i Lartësuar, për punën e tij të mirë e për namazin që ai fali, i shton atij mirësi të shumta.”

Gjithashtu, transmetohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur, nëse mund të falte namaz për të vdekurin. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur: “Po, madje edhe nëse ai është ngushtë nga gjendja. Me këtë namaz, ngushtica zgjerohet dhe pastaj ai jep.”

Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) i thanë: “Allahu e lehtësoi për ty këtë ngushticë, për shkak të namazit që fali filani, vëllai yt për ty.”

A lejohet që njeriu të falë namaz, të kryejë Haxh dhe të japë sadaka të vullnetshme për të gjallët, përveç të vdekurve?”

Më sipër pamë fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Çfarë e pengon ndonjërin prej jush të bëjë bamirësi për prindërit e tij të gjallë e të vdekur?”

Është pyetur Imam Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*), djali i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “A të kryej Haxh, të fal namaz dhe të jap sadaka për të afërmit e për shokët e mi të gjallë e të vdekur?” Imam Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po. Jep sadaka e fal namaz për atë, sepse edhe ti ke shpërblim për namazin që fal.”

Falja e namazit kaza për të vdekurin

E dyta: Kur për të vdekurin ka mbetur detyrë të falë namaze farz të lëna prej tij, çdo njeriu i lejohet që ato namaze t'i falë kaza për të vdekurin, si bamirësi ndaj tij. Sipas transmetimeve të mësipërme, në mënyrë absolute, shpërblimi është për të vdekurin.

Por, a lejohet që dikush të falë namaz për të vdekurin kundrejt pagesës?

Përgjigje:

Patjetër që lejohet. Sej'jid El Hakijm thotë në librin “El Mustemsek”: “Për këtë dëshmon thënia shumë në zë e fukahave të mëvonshëm, madje thënia e tyre është aq në zë, sa është bërë si thënie e përbashkët e të gjithë fukahave. Gjithashtu, tregohet se kjo ishte edhe thënia e përbashkët e të gjithë fukahave të mëparshëm, ashtu siç vërteton për këtë, Dëshmori i parë, në librin

“Edh’dhikrà”, shehu i tij në librin “Ijdàh” dhe studiuesi i dytë në librin “Xhàmiul Mekàsìd.”

Padyshim që edhe rregullat ndihmojnë për këtë çështje, sepse zëvendësimi për të vdekurin, është prej punëve të lejuara në ligjin e fesë dhe, çdo punë e lejuar, lejohet që ajo të kryhet edhe kundrejt pagesës.

Personi që do të kryejë adhurimin kundrejt pagesës është e detyrueshme që të jetë njeri besnik dhe të njohë dispozitat e namazit, të jetë i fuqishëm për të kryer veprimet farz të namazit, si për shembull qëndrimin në këmbë. Kur emërohet personi që do të kryejë adhurimin, ai do të veprojë sipas porosisë që ka lënë i vdekuri, ose sipas porosisë së porositësit, ose sipas pikëpamjes së ndonjërit prej hulumtuesve, prandaj personi i emëruar për faljen e namazit për të vdekurin, detyrimisht duhet ta falë këtë namaz sipas detyrimit që ka marrë përsipër kundrejt pagesës që i jepet, ndryshe, personi i emëruar e fal këtë namaz sipas detyrimit të veçantë që ka marrë përsipër, plotësisht ashtu sikur të ishte ngarkuar të kryente një shit-blerje, ose të kryente punë të tjera të ngjashme.

Lejohet që edhe gruaja të paguhet për të falur namaz për burrin, ose burri të falë namaz për gruan, gjithashtu, personi i angazhuar për të falur namazin për të vdekurin kundrejt pagesës, ose personi që zëvendëson të vdekurin për faljen e namazit kaza të lënë prej të vdekurit, ka detyrë të bëjë nijetin për të vdekurin, plotësisht ashtu siç bën nijetin për Haxh dhe për vizitën, sepse nuk është e mjaftueshme vetëm dhurimi i shpërblimit për të vdekurin, pa bërë edhe nijetin që adhurimi kryhet në emër të tij.

Djali më i madh kryen adhurim kaza për dy prindërit e vet

E treta: Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Agjëron dhe fal namaz për të vdekurin njeriu më i afërm i tij.” Imami iu tha: “Sikur njeriu më i afërm i të vdekurit të jetë grua?” Imami tha: “Jo, vetëm burrat.”

Imami Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Namazin e radhës që vjen, para se njeriu të vdesë, këtë namaz e fal për të vdekurin njeriu më i afërm i tij.”

Fukahatë

Shejkhu¹ dhe pjesa më e madhe e atyre që erdhën pas tij, kanë thënë: “Djali më i madh fal për dy prindërit e tij namazet që ata të dy kanë lënë pa falur.”

Më vonë fukahatë kanë pasur kundërshtime mes tyre: A duhet të falë djali të gjitha namazet që kanë lënë pa falur dy prindërit e tij, qoftë namazet e lëna gjatë sëmundjes së tyre, qoftë namazet që ata kanë lënë në kohë të tjera, apo ai ka detyrë të falë vetëm namazet që ata kanë lënë gjatë sëmundjes?

Shejkh El Ensàrij, në shtojcat e librit “El Mekàsib”, kapitulli: “Falja e namazit për të vdekurin”, thotë: “Thënia që tregohet prej më të famshmit të parë, është thënia më e fortë, sepse tekstet përfshijnë të gjitha namazet e lëna.”

¹ Shiit emrin “shejkh” e përdorin pa asnjë kusht për Muham’med bin Hasen bin Alij Et Tùsij, vdekur në vitin 460H, i cili është autori i dy librave, ndër katër librat e famshëm. Këta dy libra janë: “El Istibsa” dhe “Et Tehdhijb”.

Kur babai ka dy djem me moshë të barabartë, detyra për të falur namazet e lëna prej babës së tyre pjesëtohet mes dy djemve. Njeriu më i afërm i të vdekurit shkarkohet nga detyrimi për të falur namazet e lëna prej të vdekurit kur një bamirës paguan dikë që t'i falë ato namaze për të vdekurin. Gjithashtu, njeriu më i afërm shkarkohet nga detyrimi, kur ai paguan dikë që t'i falë ato namaze, domethënë që njeriu më i afërm i të vdekurit ka të drejtë të paguajë një tjetër që të falë namazet që ai vetë kishte detyrim t'i falte për të vdekurin e tij.

Çështje

1- Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka harruar se cilin namaz ka lënë pa falur. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Ai fal tri rekate, pastaj fal katër rekate dhe pastaj fal dy rekate, nëse namazi që ai ka lënë ishte namazi i drekës, ose namazi i pasdites, ose namazi i darkës, ai për këto namaze fali katër rekate, nëse namazi që ai ka harruar ishte namazi i mbrëmjes, ose namazi i mëngjesit, edhe për këto dy namaze ai i fali rekatet përkatës.”*

Kjo thënie ka miratimin e përbashkët të fukahave.

2- Kur namazi që ka mbetur pa u falur mund të falej vetëm nën kushtet e imponimit, domethënë, se kur të hynte koha për faljen e atij namazi, s'kishte rrugë tjetër përveçse ai namaz të falej me tejemum, ose ulur, ose shtrirë, ose në ecje e sipër, por pastaj pengesa në kohën që duhet të falet kaza ka kaluar, a duhet ta falë kaza atë namaz, ashtu siç e humbi, në kushtet kur ishte i detyruar, apo duhet ta kryejë të plotë atë namaz, sipas të gjitha kushteve e pjesëve të namazit?

Përgjigje:

Po, ai ka detyrë ta falë atë namaz të plotë, sepse detyrimi parësor është që namazi të falet me mënyrën e tij origjinale, qoftë kur falet në kohën e vet, qoftë kur falet kaza dhe, kur domosdoshmëria imponon faljen e namazit në kohën e vet me tejemum, ose ulur, rregulli i detyrimit nga domosdoshmëria dhe efektet e asaj domosdoshmërie nuk mund të jenë të vazhdueshme deri në kohën e faljes kaza të atij namazi, duke ditur se tani domosdoshmëria ka kaluar. Edhe i sëmuri, që për shkak të sëmundjes mund ta falte namazin vetëm i shtrirë në shpinë, ka detyrë që namazin e lënë pa falur nga sëmundja, ta falë kaza në këmbë.

Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Bazuar mbi këtë dhe në fjalët e më shumë se një prej shokëve, madje edhe në librin “Miftàhul Keràmeh”¹, të marrë prej librit “Irshàdul Xha'ferij'jeh”, tregohet se detyrë është ruajtja e formës së faljes së namazit në kohën e faljes dhe jo si ishte në kohën, kur ai namaz mbeti pa u falur.

Kjo çështje ka miratimin e përgjithshëm të fukahave, prandaj askush nuk ka ndonjë kundërshtim, madje është prej çështjeve tepër të qarta që s'kanë nevojë fare për meditim.”

¹ “Miftàhul Keràmeh” është një libër madhështor e tepër i vyer, autori i të cilit është Sejjid Muhamed Xhevàd El Àmilij, i cili ka qenë mësuesi i autorit të librit “El Xheuàhir”. Unë e përmenda këtë shpjegim për të cituar cilësimin që i ka bërë autori i librit “El Xheuàhir”, mësuesit të tij të lartpërmendur në kapitullin: “Namazi”, nëntitulli: “Detyra për faljen e namazeve të humbura sipas renditjes”. Ja se ç'ka thënë ai fjalë për fjalë: “Kështu thuhet në mesazhin e mikut tim erudit, zotërisë së argumentit, profesorit tim, Muhamed Xhevàd.”

Autori i librit “El Xheuàhir” ka vdekur në vitin 1266H.

3- Shikohet në gjendjen e zëvendësuesit dhe jo në gjendjen e atij që ai zëvendëson, në lidhje me këndimin me zë ose pa zë gjatë namazit, sepse këndimi me zë ose pa zë, janë cilësi që kanë lidhje me personin që fal namaz dhe jo me karakterin e me të vërtetën e namazit. Bazuar mbi këtë, burri këndon me zë në dy rekatet e namazit të mëngjesit, në dy rekatet e para të namazit të mbrëmjes dhe në dy rekatet e para të namazit të darkës, qoftë edhe kur burri është zëvendësues për një grua. Por, kur gruaja zëvendëson burrin, ajo e fal namazin me zë ose pa zë, sipas përzgjedhjes që do të bëjë.

4- Kur porositësi pretendon se ai që paguhet nuk e ka falur namazin për të vdekurin, por thotë e kam kryer, fjala e parë është fjala e atij që është paguar të falë namazin, sepse ai është njeri besnik, plotësisht ashtu siç është porositësi (el-vesij) e i porosituri (el vekijl). Në këtë rast, për të porositurin nuk mbetet rrugë tjetër përveç betimit.

* * *

FALJA E NAMAZIT ME XHEMAT

Mirësia e xhematit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Xhemati i parë ka ndodhur, kur i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka falur namaz. Së bashku me të ishte edhe Prijësi i besimtarëve, Ali bin Ebu Talibi. Pranë tyre kaloi Ebu Talibi, së bashku me Xhaferrin. Ebu Talibi i tha djalit të tij: “O bir, fal namaz përkrah djalit të xhaxhait tënd dhe, kur i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ndjeu se ata të dy po afroheshin, Ebu Talibi u largua i gëzuar.”

Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) i thanë: “Njerëzit thonë se namazi i falur me xhemat është njëzet e pesë namaze më mirë se namazi që njeriu fal vetëm.” Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) ia ktheu: “Ata kanë thënë të vërtetën.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kush e le namazin, ngaqë ka dëshirë ta lërë dhe le xhematin e besimtarëve, pa pasur ndonjë pengesë, për atë nuk ka namaz.”, domethënë, për atë nuk ka namaz të plotë.

Fukahatë

Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Xhemati është mustehab në të gjitha librat, në Librin e Allahut, në rrugën e Profetit, në praktikën e bazuar nga njoftimet e pashkëputura dhe në fjalën e përbashkët të fukahave. Madje falja e namazit me xhemat është nga domosdoshmëritë e fesë. Ai që e mohon faljen e namazit me xhemat, ka hyrë në rrugët e mohuesve.”

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se xhemati, në mënyrë absolute, nuk lejohet në namazet nafile. Për këtë, Imam Rizai, nipi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Nuk lejohet që njeriu të falë namaz të vullnetshëm me xhemat, sepse kjo është sajese (*bid’at*) dhe çdo sajese është shkarje në rrugën e humbjes, por çdo shkarje në rrugën e humbjes, është në zjarr.”

Sipas rregullit bazë të ligjit të fesë, xhemati është detyrim vetëm në namazin e Xhumasë dhe në namazin e dy bajrameve, krahas plotësimit të kushteve. Me lejen e Allahut, më poshtë do të flitet edhe për këtë çështje. Xhemati është detyrë edhe në namazet e rastësishme, si për shembull, kur burri e ka taksur të falë namaz (nedhr), ose ka dhënë fjalën për mbajtjen e besës, ose fal namaz për betimin. Gjithashtu, namazi është detyrim për atë që nuk di të këndojë Kur’an dhe në saje të xhematit i jepet mundësia të kryejë namazin farz pas Imamit.

Kushtet e xhematit

Formimi i xhematit kushtëzohet nga:

Numri

1- Numri më i vogël i kërkuar për formimin e xhematit është dy vetë, dy burra, ose dy gra, ose edhe një burrë e një grua. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “A formojnë xhemat dy burra?” Imami është përgjigjur: “Po.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Dy vetë formojnë xhemat, por jo në namazin e Xhumasë dhe në namazin dy bajrameve, sepse, që të formohet xhemati në këto dy namaze, patjetër, më e pakta, duhet të jenë pesë vetë.”

Qëllimi për të falur namazin me Imam

2- Ai që fal namaz me Imam, ka detyrë të bëjë nijet të falë namazin me atë që është duke falur të njëjtin namaz, pasi është naivitet që vetëm falja e namazit prapa Imamit, ose përkrah Imamit, pa bërë nijet se je ujdishur pas atij Imami, nuk realizohet xhemati, ashtu siç nuk realizohet namazi vetëm nga rukuja e sexhdja, pa bërë nijetin për faljen e namazit. Hadithi mjaft i dëgjuar tregon: “Në të vërtetë, Imami është bërë Imam që të tjerët ta marrin atë për Imam.”. Autori i librit “El Xhevâhir” ka thënë: “Për këtë çështje s’ka asnjë kundërshtim, pasi kjo është njëra prej bazave e rregullave të medh’hebit.”

Imami

3- Është kusht që Imami i xhematit të jetë njeri i mençur, pasi i çmenduri s'ka detyrim as të falë namaz e as të bëjë ndonjë adhurim tjetër. Gjithashtu, është kusht që Imami të ketë arritur moshën e pjekurisë (*bàlig*), madje edhe kur ne shprehemi për vlefshmërinë e adhurimit të fëmijës që dallon (hallallin prej haramit). Përsëri fjala "Imam i xhematit", vetvetiu, nënkupton burrin që ka arritur moshën në të cilën ai obligohet me detyrimet e fesë. Gjithashtu, është kusht që Imami të jetë ndjekës i njërit prej dymbëdhjetë Imamëve.

Shejkh El Hamedànij, në librin "Misbàhul Fakijh", ka thënë: "Për këtë kusht të Imamit, te ne nuk ka asnjë kundërshtim, madje ky kusht numërohet prej domosdoshmërive të medh'hebit." Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*), nipi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: "Mund të prijë për Imam vetëm një ndjekës i vijës së imamëve."

Gjithashtu, është kusht që Imami të jetë njeri i drejtë. Autori i librit "El-Xhevàhir" ka thënë: "Me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, nuk lejohet që mëkatari të prijë për Imam." Madje tregohet se edhe disa prej Ehli Sunetit kanë të njëjtin mendim me shi'at për këtë çështje, duke sjellë si argument transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*). Prej transmetimeve të ardhura prej Ehli Bejtut kemi: "Imami yt është ndërmjetësuesi për ty te Allahu, prandaj të mos jetë ndërmjetësuesi yt as naiv e as mëkatar. Ke detyrë të falësh namaz vetëm pas atij personi, për fenë e të cilit je i sigurt... dhe mos fal namaz pas të panjohurit, ekstremistit dhe atij që mëkaton

sheshit.” Nuk po përmendim cilësi të tjera që nuk arrihen të numërohen.

Është kusht që Imami të mos falet ulur dhe ata që falen pas tij, ta falin namazin në këmbë. Me rrugët e përcjelljes së njoftimeve të shi’ave e të Ehli Sunetit transmetohet se i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) gjatë sëmundjes, ka falur namazin ulur me shokët e tij. Pasi përfundoi falja e namazit, ai tha: “Pas kësaj here, asnjëri prej jush të mos prijë për Imam ulur.”

Nuk përbën problem që Imami të falë namazin ulur më të ngjashëm me të, ose që Imami të falë namazin në këmbë dhe xhemati të falë namazin ulur.

Lejohet që burri të jetë Imam për burrat e për gratë, kurse gruaja lejohet të jetë Imam vetëm për gratë, por jo për burrat.

Ai që nuk e këndon mirë Kur’anin nuk lejohet të prijë për Imam për atë që e këndon mirë, por ai lejohet të jetë Imam për ngjashmit me të, pasi në këtë rast, qoftë Imami, qoftë xhemati, kanë të përbashkët se nuk e këndojnë mirë Kur’anin. Në rast se Imami nuk di të këndojë të gjithë suren “Fatiha”, ose kur Imami e di mirë suren “Fatiha” por jo suren, kurse xhemati di mirë suren, por nuk di suren “Fatiha”, atëherë nuk lejohet që ai të prijë për Imam.

Për atë që fal namazet e përditshme nuk lejohet të vërë për Imam atë që fal vetëm namazet e ngjarjeve të shënuara, ose namazin e Bajramit, ose namazin e xhenazes, por jo e kundërta.

Ai që ka tejmemum, ose që ka lidhur me fasho vendin e kockave të thyera, lejohet të jetë Imam për atë që ka marrë abdes dhe për të shëndoshin, gjithashtu, lejohet që udhëtari të prijë Imam për banorin vendas, si dhe e kundërta. Gjithashtu, ai që fal namaz kaza, lejohet të jetë Imam për atë që fal namazin e radhës, ose e kundërta, ai që fal namaz me zë, lejohet të jetë Imam për atë që fal namaz pa zë, ose ai që fal namazin farz, lejohet të prijë Imam për atë që në rrugë mustehabi përsërit namazin, ai që fal namazin e pasdites prin Imam për atë që fal namazin e drekës. Të gjitha këto pohime janë shumë të njohura në mesin e fukahave, sepse për të gjitha këto ka tekste.

Ai që fal namaz pas një Imami, patjetër duhet të përcaktojë me veten e vet Imami me emër, ose me cilësinë e tij si Imam, ose me shenjë.

Ndarësja

4- Nuk lejohet që mes Imamit e xhematit të ketë ndarëse që pengon shikimin, vetëm nëse Imami është burrë dhe xhemati është grua, me kusht që kjo ndarëse të mos i pengojë gratë të dinë gjendjet e Imamit gjatë namazit dhe që ato të kenë mundësi ta ndjekin Imamin. Gjithashtu, ndarësja nuk duhet të dëmtojë safet, sado shumë që të jenë, sepse çdo saf shikon safin që ka përpara dhe kështu derisa përfundon në safin e parë, i cili e shikon drejtpërdrejt Imamin.

Autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “Rreth kësaj dispozite janë të bashkuar të gjithë fukahatë dhe, si argument për këtë, kanë fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur disa njerëz falin

namaz dhe mes tyre e Imamit ka diçka që nuk lejon të hidhet hapi, ky Imam nuk është Imami i tyre, domethënë se njerëzit e rreshtuar në një saf që falin namazin me Imamin, në qoftë se ndërmjet tyre e ndërmjet safit që kanë përpara ka ndonjë send të lartë, që nuk i lejon të hedhin hapin, ai namaz nuk është për ta namaz. Gjithashtu, në qoftë se ndërmjet tyre ka një perde, ose mur, përsëri ky namaz, për ta, nuk është namaz, me përjashtim të atij që është pranë derës.

Për sa i përket ndarësit, në raport me gruan, për këtë flet transmetimi i ardhur prej Amarit, i cili tregon: *“Pyeta Ebu Abdullahun, domethënë Imam Sadikun (Paqja qoftë mbi të!), për një burrë që u prin Imam disa njerëzve dhe prapa tij është një shtëpi, në të cilën ka gra. A lejohet që këto gra të falin namaz pas këtij Imami?”* Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Po, kur Imami qëndron më poshtë se gratë.”* I thashë: *“Ndërmjet Imamit e grave ka një mur ose një rrugë.”* Imami tha: *“Nuk ka problem.”*

Lartësia

5- Kur vendi ku qëndron Imami është në të njëjtin nivel lartësie me vendin ku xhemati fal namazin pas këtij Imami, ose ndryshimi në lartësinë është fare i vogël, aq sa nuk mund të zihet me gojë, namazi i xhematit është i vlefshëm, por, nëse diferenca në lartësi është e madhe, atëherë shikohet: në qoftë se ai që fal namaz pas Imamit është më lart, në mënyrë absolute, namazi i xhematit është i vlefshëm dhe, është e barabartë, qoftë kur lartësia është vertikale, si për shembull, kur xhemati fal namazin mbi tarracën e një ndërtese, kurse Imami e fal namazin në tokë, qoftë kur lartësia është e pjerrët afër harkimit. Në qoftë se vendi i Imamit është më i

lartë se vendi ku falet xhemati dhe, nëse lartësia është vertikale, atëherë namazi i këtij xhemati është prishur. Por namazi është i vlefshëm, nëse lartësia është e pjerrët.

Autori i librit “Misbàhul Fakijh” ka thënë: “Kjo është thënia më e dëgjuar, madje shumë fukaha pretendojnë se kjo thënie gëzon fjalën e përbashkët të të gjithë fukahave. Këtë e tregon edhe fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nëse Imami qëndron mbi një vend më të lartë se vendi ku qëndrojnë ata, domethënë vendi ku qëndrojnë ata që falin namazin pas Imamit, namazi me këtë Imam nuk është i vlefshëm. Por nuk ka problem, nëse Imami qëndron më poshtë se vendi ku falet xhemati prapa tij.”

Dalja para Imamit

6- Ai që fal namaz prapa Imamit, nuk del para tij. Nuk ka problem, kur të dy qëndrojnë në të njëjtën radhë, në atë mënyrë që thembrat e këmbëve barazohen, edhe pse nuk mund të barazohen kokat gjatë rukusë e sexhedes, për shkak se Imami mund të jetë i shkurtër dhe ata që falin namaz prapa tij janë të gjatë. Në qoftë se ai që fal namaz prapa Imamit del para tij, namazi i xhematit është prishur, sepse prej fjalës së Imamit kuptohet që xhemati duhet të qëndrojë pas Imamit dhe të mos e parakalojë atë, sado pak qoftë.

Në përgjithësi, ai që fal namaz prapa Imamit mund të gjendet në njërën nga këto tri gjendje kundrejt Imamit: ose del para Imamit, ose qëndron prapa Imamit, ose është baraz me Imamin. Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët: Xhemati është prishur në rastin e parë dhe është i vlefshëm në rastin e dytë, kurse për rastin e tretë, kanë mendime të ndryshme. Mendimi më

në zë është ai që flet për vlefshmërinë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Dy burra, njëri prej tyre prin Imam për shokun e vet dhe qëndron në të djathtën e tij. Në qoftë se janë më shumë se kaq, atëherë ata qëndrojnë prapa Imamit.”

Transmetohet se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Kur një njeri vjen dhe s’ka mundësi të hyjë në saf, atëherë ai qëndron përkrah Imamit.”

Largësia

7- Nuk lejohet që largësia mes Imamit dhe atyre që falin namaz pas tij, të jetë më shumë se sa largësia e zakonshme, në atë mënyrë që me të vërtetë ata mund të quhen xhemat, që i janë ujdísur Imamit. Dihet që dispozitat ndjekin titujt dhe emërtimet, prandaj nuk sjell asnjë dëm mbi namazin numri i madh i safëve, sado shumë të jenë, derisa emri xhemat përputhet me xhematin në fjalë. Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim.”

* * *

DISPOZITAT E XHEMATIT

Kur ai e gjen Imamin në ruku

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur ti e arrin Imamin në ruku dhe, pasi këndove tekbirin (the All’llàhu Ekber), kalove në ruku, para se Imami të ngrejë kokën, në fakt ti e ke arritur rekatin. Por nëse Imami e ka ngritur kokën, para se ti të kalosh në ruku, atëherë këtë rekat e humbe.”

Fukahatë

Fukahatë më të dëgjuar kanë punuar sipas këtij transmetimi, kurse transmetimet e tjera janë të lëna. Kur Imami dëgjon që dikush hyri, është veprim mustehab që ai ta zgjasë pak rukunë, derisa edhe ai që hyri të bashkohet me të.

Kur ai që vjen, hyn në namaz prapa Imamit, këndon tekbirin dhe bën rukunë. Pastaj dyshon, nëse e ka bërë apo jo rukunë para se Imami të ngrejë kokën nga rukuja. Në këtë rast, ai shikon: Në qoftë se dyshimi i vjen, pasi e ka kryer rukunë, rukuja është kryer dhe ai s’ka arsye të bëjë kujdes për dyshimin e tij,

sepse ai është dyshim pas kryerjes së veprimit. Por nëse atij ky dyshim i vjen gjatë kohës që vazhdon të jetë në ruku, namazi i tij është prishur dhe ai e rifillon faljen e namazit.

Ai mund të pyesë: Përse nuk ndjekim rregullin e shoqërimit dhe të marrim qëndrimin e Imamit në ruku, derisa edhe ai që vjen, të falë namazin me Imam, të kalojë në ruku? Kështu mund të gjykojmë për vlefshmërinë e namazit.

Përgjigje:

Shoqërimi mund të jetë argument që ndiqet, kur renditja e veprimeve të namazit bëhet që në fillim dhe pa ndonjë ndërmjetësimin e pa ndonjë efekt ligjor, siç është shoqërimi i vazhdimësisë së pastrimit, mbi të cilin është renditur lejimi ligjor i hyrjes në namaz. Por, kur sistemimi mbi këtë rregull kërkohet të bëhet sipas një domosdoshmërie logjike, pa efekt ligjor, atëherë shoqërimi nuk është argument, ashtu siç rezulton çështja në problemin që ne kemi, sepse rregulli i shoqërimit nënkupton qëndrimin e Imamit në ruku, derisa rukuja e atij që vjen të falë namaz me Imam të jetë shoqëruese me rukunë e Imamit. Është naivitet të mendohet se kjo përputhje të mos jetë prej efekteve ligjore, madje ajo është edhe prej domosdoshmërive logjike. Prandaj rregulli i shoqërimit për këtë çështje nuk mund të merret si argument.

Këndimi së bashku me Imamin

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për dy rekatet e para, në të cilat Imami këndon pa zë. A ta këndojë xhemati suren “Fatihë”? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nëse e këndon, s’ka ndonjë problem. Por edhe nëse nuk e këndon, përsëri s’ka ndonjë problem.”

Gjithashtu, është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “A këndon burri në rekatën e parë suren “El Asr”, kur është prapa Imamit, duke mos e ditur që Imami po këndon?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai nuk duhet të këndojë, ai duhet të mbështet te Imami.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se Imami nuk mban përgjegjësi për këndimin që bën ai që fal namaz me Imamin në rekatën e tretë të namazit të mbrëmjes dhe në dy rekatet e pasmë të namazeve: të mbrëmjes, të darkës, të drekës dhe të namazit të pasdites. Gjithashtu, ai që fal namaz me Imam, mund të për zgjedhë që në dy rekatet e pasmë, ose të këndojë suren “Fatihë”, ose këndon tesbijhatet, plotësisht ashtu siç vepron, kur burri fal namazin pa xhemat.

Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur je prapa Imamit, mos këndo në dy rekatet e para dhe këndimin për ty në dy rekatet e pasmë e shlyen këndimi i tesbijhateve.”

Gjithashtu, fukahatë kanë thënë: “Imami mban përgjegjësinë e këndimit për xhematin në dy rekatet e para. Por fukahatë kanë kundërshtime, nëse është e ndaluar dhe në mënyrë absolute, nuk lejohet këndimi për xhematin në namazet, ku këndimi bëhet me zë dhe në namazet, ku këndimi bëhet pa zë, ose këndimi lejohet pa kerahet, ose këndimi lejohet, por me kerahet, ose patjetër duhet të bëhet një shkoqitje mes namazeve ku këndimi bëhet me zë dhe namazeve ku këndimi bëhet pa zë.

Autori i librit “Miftàhul Keràmeh” ka thënë: “Rreth kësaj çështjeje fukahatë kanë pasur kundërshtime të shumta, madje kishin aq shumë sa edhe një fekih i vetëm kishte kundërshtim me vetveten.” Kurse autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “Thëniet rreth kësaj çështjeje janë mjaft të përhapura dhe, që të ekspozohen këtu, s’kanë ndonjë dobi të madhe.”

Ne do të mjaftohemi të përmendim përfundimin e arritur prej autorit të librit “El-Xhevàhir”, i cili pohon lejimin e këndimit në dy rekatet e para me kerahet, duke bashkuar për këtë pohim transmetimet që flasin për ndalim dhe transmetimet që flasin për lejim. Ajo që i bashkon të gjitha këto transmetime është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Në qoftë se ai këndon, s’ka ndonjë problem dhe, në qoftë se ai hesht, përsëri s’ka ndonjë problem.”

Përmendim edhe fjalën tjetër të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ai nuk duhet të këndojë.”

Fjala “nuk duhet” (në tekst “lâ jenbegij”) tregon se këndimi është kerahet.¹

Si do që të jetë, më e pëlqyeshme është lënia e këndimit, derisa këndimi, me fjalën e përbashkët të fukahave, nuk është farz.

Ndjekja e Imamit në veprime e në fjalë

I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*Imami është Imam që të ndiqet dhe, kur Imami bën rukunë, edhe ju bëni rukunë. Kur ai bën sexhde, edhe ju bëni sexhde.*”

¹ Bashkimi mes argumenteve kontradiktore reduktohet në dy çështje: Bashkimi tradicional që konsiston në hedhjen e të përgjithshmes mbi të veçantën dhe absoluten mbi të kushtëzuarën. Kur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: “Uji ndotet, kur preket nga papastërtia.” (*nexhâset*) dhe: “Uji i shumtë nuk ndotet nga papastërtia.”, ne themi: Qëllimi me ndotjen është, kur papastërtia kalon mbi ujin e paktë. Uji nuk ndotet, kur ajo kalon mbi ujin e shumtë. Gjithashtu, tradita nuk ka ndonjë problem për këtë çështje, madje edhe e miraton; kurse bashkimi, bazuar në ligjin e fesë, konsiston në gjetjen e një argumenti të tretë në ligjin e fesë, që të bashkojë nga jashtë argumente kontradiktore ligjore, siç është, për shembull, fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Mos këndo, kur je duke falur namaz me imam.”

Gjithashtu, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) ka ardhur edhe një fjalë: “*Lejohet këndimi, kur je duke falur namaz me Imam.*” Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: “*Ti nuk duhet të këndosh (Kur’an), kur je duke falur namaz me Imam.*” Pikërisht kjo fjala e tretë është bashkuesja mes dy fjalëve të para. Prandaj ne themi: Qëllimi është lejimi i këndimit, por me kerahet.

Fukahatë

Fukahatë janë bashkuar të punojnë bazuar mbi këtë hadith profetik. Shejkh El Ensàrij, në shtojcat e librit “El Mekàsib”, kapitulli: “Përparësia e faljes së namazit me xhemat”, ka thënë: “Me fjalën e përbashkët të fukahave, ndjekja e Imamit në veprime e në fjalë, është detyrim. Bazë për këtë pohim të përbashkët të fukahave shërben hadithi i transmetuar prej Ehli Sunetit, i cili tregon se Dërguari më i madh (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Imami është imam, që të ndiqet.”

Qëllimi me fjalën “të ndiqet”, do të thotë: Ai që fal namaz me Imam, të mos e parakalojë Imamin e tij në asnjë veprim e në asnjë fjalë, por të vonohet pak. Gjithashtu, lejohet që veprimet e fjalët e atij që fal namaz me Imamin, të jenë të puqura me fjalët e Imamit, pasi qëllimi i tij është lidhja e punës e tij me punën e Imamit.

Kur ai bie në ruku para Imamit

Ai që fal namaz me Imam, bie në ruku e në sexhde para Imamit, me qëllim ose nga harresa. Nëse e bën me qëllim, ai qëndron në gjendjen ku është, derisa të bashkohet me Imamin, pastaj vazhdon plotësimin e namazit së bashku me Imamin. Namazi i tij është i vlefshëm, por ai si person, është mëkatar për shkak të veprimit të bërë me qëllim, sepse ndjekja e Imamit në veprime, në vetvete, është detyrim, por është detyrim i pavarur dhe nuk është kusht për vlefshmërinë e xhematit ose për vlefshmërinë e namazit. Këtij personi nuk i lejohet të bëjë ruku e sexhde për herë të dytë së bashku me Imamin, sepse kjo përbën

shtesë në namaz dhe shtesa, me fjalën e përbashkët të fukahave, e prish namazin, madje edhe në gjendjen që po trajtojmë.

Ai që fal namaz me Imam, bie në ruku ose në sexhde para Imamit, nga harresa, ngrihet dhe bën rukuknë ose sexhden së bashku me Imamin.

Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për një burrë që falte namaz me Imam dhe kaloi në ruku para Imamit, duke kujtuar se Imami kaloi në ruku dhe pa e ngritur kokën, pa Imamin që nuk kishte rënë akoma në ruku. Ai rikthehet në ruku së bashku me Imamin. A është prishur namazi i këtij burri apo rukuja e tij është e vlefshme? Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Ai plotëson namazin e tij, ashtu siç veproi dhe namazi nuk është prishur.”

Duke qenë se argumentet flasin për prishjen e namazit me shtimin e një veprimi farz nga harresa, në mënyrë absolute e të përgjithshme, kur njeriu e fal namazin vetëm dhe me xhemat. Ky transmetim është specifik dhe i kushtëzuar për faljen e namazit me xhemat, prandaj është detyrë ndjekja e kushtëzimit dhe mbartja e këtij kushti mbi këtë çështje. Rezultati është se shtimi i një farzi nga ana e këtij burri, prish namazin, kur ai fal namaz vetëm dhe nuk prish namazin që ai fal me xhemat.

Kjo është dispozita e ndjekjes së Imamit në veprime. Kurse për ndjekjen e Imamit në fjalë, fukahatë kanë një mendim të përbashkët dhe janë shprehur se ndjekja e Imamit është detyrim në tekbinin e fillimit. Fukahatë kanë mendime të ndryshme në lidhje me këndimet e tjera. Shumica e fukahave janë shprehur se ndjekja e Imamit në këto veprime nuk është detyrim, ashtu siç thuhet edhe në librin “Miftahul Keràmeh”.

Sikur ai ta ngrejë kokën para Imamit

Supozimi i mëparshëm ishte, nëse ai që fal namaz me Imam, bie në ruku e në sexhde para Imamit. Supozimi i tanishëm është e kundërta, domethënë, ai e ngre kokën prej rukusë e prej sexhdes para Imamit.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që fal namaz me Imam, por ai e ngre kokën prej sexhdes, para se Imami ta ngrejë kokën prej sexhdes. Si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “*Le të bëjë sexhden.*”

Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për një burrë që bie në ruku së bashku me Imamin, të cilit i është ujdur, por e ngre kokën prej rukusë para Imamit. Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “*Përsërit rukunë së bashku me Imamin.*”

Këtu dispozita është e njëjtë me dispozitën në supozimin e mëparshëm, sepse të dy supozimet janë në të njëjtën hulli. Autori i librit “*Miftàhul Keràmeh*” është shprehur: “Nëse ai ngre kokën me qëllim, ka detyrë ta presë Imamin dhe të vazhdojë namazin me Imamin, por, nëse ai, në këtë gjendje kthehet në ruku ose në sexhde, namazi i tij është prishur për shkak të shtesës së qëllimshme nga ana e tij.”

Në qoftë se ai e ngre kokën nga harresa, ai kthehet në ruku, ose në sexhde së bashku me Imamin. Kjo shtesë është e falur në namazin që falet me xhemat. Bazuar mbi këto dy transmetime të kushtëzuara që tregojnë se bërja e rukusë dhe e sexhdes shtesë nga harresa, e prish namazin. Kjo prishje është specifike vetëm për namazin që falet vetëm.

Ne themi: Dy transmetimet e lartpërmendura, në mënyrë absolute, e bëjnë detyrim kthimin në ruku e në sexhde, pa asnjë dallim, mes qëllimit e harresës. Atëherë mbi ç'argument janë mbështetur fukahatë, kur kanë bërë ndarjen mes tyre?

Përgjigje:

Po, fjala e dy transmetimeve përfshin atë që e bën me qëllim dhe atë që e bën nga harresa, por duke ditur se, në shumicën e rasteve, ai që fal namaz me Imam nuk e ngre kokën prej rukusë e prej sexhdes para Imamit veçse nga harresa, prandaj fukahatë e kanë lëshuar këtë fjalë në rrjedhën e shumicës. Me fjalën e përbashkët të tyre janë shprehur se ai që e ngre kokën me qëllim, nuk rikthehet në ruku e në sexhde. Fukahatë, këto dy transmetime, i kanë bërë specifike vetëm për rastin kur ai e bën këtë nga harresa.

Imami i ndyrë (nexhis)

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për disa njerëz që janë nisur prej Horasanit, ose prej disa maleve dhe në namaz atyre u ka prirë Imam një burrë. Kur ata arritën në Kufe, mësuan se ai Imam ishte jehudi. A është i vlefshëm namazi i tyre? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ata nuk e përsërisin namazin.”

Është pyetur Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), në lidhje me disa njerëz që kanë falur namazin me Imamin e tyre, por Imami nuk ishte me pastrim. A është i vlefshëm namazi i tyre, apo ata

duhet të përsërisin namazin? Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ata nuk kanë detyrë të përsërisin faljen e namazit, por as Imami nuk e ka detyrë t’i njoftojë ata për gjendjen në të cilën ai ishte.”

Fukahatë

Fukahatë kanë rënë në një fjalë të përbashkët që të punojnë me këto dy transmetime. Ne, kur përshkruam cilësitë e Imamit, ndër kushtet që duhet të plotësojë Imami i xhematit, kemi përmendur besimin dhe drejtësinë. Është domosdoshmëri të tërheqim vëmendjen se ky është kusht vetëm për diturinë dhe nuk është kusht faktik, pra, është i njëjtë me papastërtinë e keqe, si për shembull: Kush fal namaz me një Imam mëkatar, duke e ditur këtë fakt, namazi i tij është prishur për shkak të urdhrit për të mos falur namaz me një imam mëkatar. Por ai që e fal namazin, duke qenë i sigurt për fenë e për besimin e Imamit dhe pastaj për atë bëhet e qartë e kundërta, namazi që ai fali me këtë Imam, është i vlefshëm. Për të njëjtën arsye, as Imami nuk e ka detyrë të njoftojë xhematin, kur ata të marrin vesh se ai ishte pa pastrim, madje edhe sikur ai t’i njoftojë, përsëri xhemati nuk e ka detyrë ta përsërisë faljen e namazit. Detyra për të përsëritur namazin mbetet vetëm mbi këtë Imam.

As hulumtues e as imitues

Sikur një njeriu të zakonshëm t’i mbushet mendja se është hulumtues, kur në realitet ai është injorant në të gjitha drejtimet, puna e tij është prishur, sepse është punë e bërë pa imitim e pa

hulumtim. Bazuar mbi këtë gjykim, rezulton: Kush fal namaz, duke pasur Imam këtë person, duke e ditur gjendjen e tij, namazi i tij është prishur. Allahu të na falë, përveçse kur namazi përputhet me realitetin, në atë mënyrë kur Imami i kryen të gjitha veprimet e namazit, që ka marrë përsipër të drejtojë, me farzet dhe me të gjitha pjesët e kushtet e namazit.

Në lidhje me këtë çështje, nuk ka dallim ndërmjet atij që le mangësi nga injoranca dhe ndërmjet atij që le mangësi me qëllim, sepse vlefshmëria e prishja janë prej dispozitave përshkruese, në të cilat nuk ka ndryshim mes të madhit e të voglit dhe as mes të mençurit e të çmendurit, veçse në masën e ndëshkimit e të dënimit.

Me këtë rast, do të përmend një pjesë të dialogut që kam zhvilluar me një sheh të medh'hebit hanefij. Gjatë dialogut, ndër të tjera, i thashë: "Ti je hulumtues apo imitues?"

Ai tha: "Jo, jam imitues."

E pyeta: "Cilin imiton?"

Ai tha: "Ebu Hanifen."

I Thashë: "Ebu Hanifja nuk e lejon imitimin. Bazuar mbi këtë, ti nuk je as hulumtues e as imitues."

Ai qeshi dhe me kaq mjaftoi.

Sikur ky sheh të dinte gjendjen tonë, patjetër që do të përgjigjej se kjo është përgjigjja e shumicës së atyre që pretendojnë se janë hulumtues, në një kohë që nuk janë prej hulumtuesve. Për pasojë, edhe puna e tyre është pa hulumtim dhe pa imitim.

Kur ai ka frikë se i humb rekati

Kur një person hyn aty ku po falet namaz me xhemat dhe Imamin e gjen në ruku, por ai ka frikë se mos i humb rekati, derisa ai të hyjë në saf. Si duhet të veprojë ky person?

Përgjigje:

Ai bën nijetin, këndon tekbirin dhe bie në ruku aty ku është, pastaj, ashtu në ruku, siç është, shkon dhe hyn në saf. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që hyn në xhami dhe ka frikë se mos i humb rukuja. Si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Ai bie në ruku para se të shkojë te safi dhe, duke qenë në ruku, ecën, derisa arrin te të tjerët.”

Veprimi më i pëlqyer është që ky person të tërheqë vëmendjen e Imamit duke thënë “Jà All’läh”, ose diçka të ngjashme, me qëllim që Imami të zgjasë rukunë. Allahu të na falë, në qoftë se safët janë shumë dhe tërheqja e vëmendjes bëhet e vështirë.

Ndërprerja e namazit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në qoftë se je duke falur namaz nafile, ndërkaq këndohet ikameti, menjëherë ndërprite namazin nafile dhe fal farzin me Imamin.”

Gjithashtu, është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që hyn në xhami dhe fillon të falë namaz. Ndërsa ai

është në këmbë, muezini këndon ikametin për të falur namazin me xhemat. A duhet ta ndërpresë namazin ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: *“Ai le të falë dy rekate, pastaj le të fillojë namazin me Imamin dhe ato dy rekatet që ai fali, janë rekate të vullnetshme.”*

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Kur burri që do të falë namaz me Imam, ka filluar të falë namaz nafile, ndërkaq Imami këndon tekbinin e fillimit dhe xhemati është formuar, ai e ndërpret namazin nafile. Nëse ka frikë se i humb ndonjë rekat prej namazit farz, ai menjëherë rifillon të falë namazin farz me Imamin. Por nëse namazi që ai kishte filluar ishte namaz farz, ai e kthen nijetin nga namazi nafile në namaz farz. Ndodh kështu, sepse në pikëpamjen e ligjit të fesë, falja e namazit me xhemat, është veprim tepër i rëndësishëm.

Fukahatë kanë thënë: “Nuk lejohet heqja dorë prej nijetit për të falur namazin vetëm dhe për ta kthyer nijetin në faljen e namazit me xhemat, por lejohet e kundërta, domethënë, lejohet heqja dorë prej nijetit të xhematit për ta kthyer në nijet për të falur namazin vetëm.

Imami është para tij në veprime

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Kur të humb diçka nga namazi që je duke falur me Imamin, bëj fillim të namazit tënd*

atë pjesë të namazit që ka mbetur dhe mos e bëj fillim të namazit tënd fundin e tij."

Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) është: "Mos bëj fillim të namazit tënd fundin e tij", është mohim i fjalës që thonë hanefitë, malikitë dhe hanbelitë, të cilët janë shprehur se ai që fal namaz me Imam, në një gjendje të këtillë, ka detyrë që pjesën e fundit ta bëjë të parë dhe pjesën e parë ta bëjë të fundit, që do të thotë: Atë pjesë namazi që ai fali me Imam dhe që e arriti Imamin në rekatin e fundit, e bën fundin e namazit të tij, kurse atë pjesë të namazit që fali pas faljes me Imam, e bën fillimin e namazit të vet.

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: "Kur burri arrin të falë me Imam një pjesë të namazit dhe pjesën tjetër nuk arrin ta falë me Imam, pjesën që fali me Imam e bën fillim të namazit të tij. Për shembull: Në qoftë se ai arrin të falë prej namazit të drekës, ose të namazit të pasdites, ose të namazit darkës dy rekate, kurse dy rekatet e tjera nuk arrin t'i falë me Imam, në rekatet që arriti të falë me Imam këndon (pa zë) suren "Fatiha" dhe një sure, sepse Imami nuk mban përgjegjësi për këndimin në dy rekatet e fundit të namazit për këdo që fal namaz me këtë Imam.

Nëse ai që fal namaz me Imam, nuk arrin të këndojë suren të plotë, këndimin e tij e shlyen këndimi i sures "Fatiha". Pastaj, kur Imami jep selam, ai ngrihet e fal dy rekatet e humbur, por në të dy rekatet ai nuk këndon, sepse në namaz këndohet vetëm në dy rekatet e para. Në çdo njërin prej dy rekateve të para këndohet surja "Fatiha" dhe një sure, kurse në dy rekatet e pasmë nuk këndohet, sepse këndimi në këto dy rekate është tesbijhu (Subhànall'Ilàh), tehlijli (Là ilàhe il'lall'Ilàh) dhe lutje. Në qoftë se ai arrin të falë me Imam një rekat, në këtë rekat këndon pas

Imamit dhe, kur Imami jep salam, ai ngrihet, këndon suren “Fatiha” dhe një sure. Pastaj qëndron ulur, ku këndon tesheh’hudin, pastaj ngrihet dhe fal dy rekatet që s’ka këndim, domethënë, nuk është detyrim që ai të këndoje suren “Fatiha” në këto dy rekate. Por ai ka të drejtë të zgjedhë mes këndimit dhe tesbijhut, ashtu siç tregojnë transmetimet e fundit, të cilat ne i sollëm për këndimin e Kur’anit në namaz.

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Kur një person vjen të falë namaz me xhemat dhe konstaton se Imami tashmë ka falur një rekat të namazit ose edhe më shumë, ai bën nijetin, këndon tekbinin e fillimit, vazhdon faljen e namazit me Imam dhe pjesën e namazit që arriti të falë me imam, ai e bën fillimin e namazit të tij. Pastaj ai plotëson pjesën e namazit që i ka mbetur pa kryer sipas obligimit të ligjit të fesë, ashtu sikur do të falte namazin i vetëm që nga fillimi.

Bazuar mbi sa u tha, nëse ai që fal namaz me Imam, e arrin Imamin në rekatën e dytë, ai e bën këtë rekat, rekatën e parë të namazit të tij, prandaj nuk këndon asgjë, sepse Imami mban përgjegjësinë e këndimit në rekatën e parë e në rekatën e dytë për atë që fal namazin me Imam. Por duke qenë se rekati që ai arriti, ishte rekati i dytë për Imamin, ky që është duke falur namazin me Imamin fillon këndimin në rekatën e tretë të Imamit, sepse ky rekat për atë është rekati i dytë, kur dihet se Imami nuk mban përgjegjësinë e këndimit në rekatën e tretë e të katërt për atë që fal namazin me Imam.

Në qoftë se ai e arrin Imamin në rekatin e tretë ose në rekatin e katërt, ky që po fal namazin me Imamin do të këndojë në të dy këto rekate. Çështja qëndron e këtillë, nëse ai e ka arritur Imamin para se ai të bëjë rukunë, por, nëse e arrin, kur Imami është në ruku, këndon tekbinin dhe bie në ruku së bashku me Imamin, atëherë ai nuk ka më detyrë të këndojë.

Kur koha është e ngushtë për të kënduar suren “Fatiha” dhe suren, pasi, nëse ai do t’i këndonte të dyja, Imami do të dilte prapa tij në veprimet e namazit dhe konkretisht do të ishte në ruku, atëherë ai do të mjaftohet të këndojë vetëm suren “Fatiha”. Ai që fal namaz me Imam, ka detyrë që këndimin ta bëjë pa zë, edhe sikur namazi të jetë namaz, në të cilin këndimi bëhet me zë, siç është për shembull, namazi i mbrëmjes e namazi i darkës, në përputhje me fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Në rekatet që arrin të falë me Imam, këndon me vete suren “Fatiha”.

Kush ka përparësi të prijë Imam?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon se Profeti (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Njerëzve u prin për Imam ai që di të këndojë Kur’an më mirë. Në qoftë se në këndimin e Kur’anit janë të barabartë, prin ai që ka përqafuar besimin më përpara. Në qoftë se edhe në besimin janë të barabartë, prin më i moshuari. Nëse edhe në moshë janë të barabartë, atëherë prin Imam, ai që di më mirë Sunetin dhe ai që di më mirë rregullat e ligjit të fesë. Asnjëri prej jush të mos dalë për Imam para të zotit të shtëpisë në shtëpinë e tij dhe para pushtetarit në zonën e tij të juridiksionit.”

Gjithashtu, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se Profeti (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka ndaluar që burri t'u prijë Imam njerëzve pa lejen e tyre.

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Kur janë disa imamë, Imami i xhamisë, ka përparësi të prijë Imam ndaj gjithë të tjerëve. Përparësi që të prijë Imam, ka i zoti i shtëpisë, personi me të cilin ata që do të falin namazin me të janë të kënaqur, që ai t'u prijë atyre Imam ka përparësi ndaj atij që ata nuk janë të kënaqur prej tij, qoftë ky i fundit edhe më i ditur. Gjithashtu, ka përparësi të prijë Imam ai që di më mirë Kur'anin ndaj atij që nuk di të këndojë mirë Kur'an, edhe nëse ky i fundit është më i ditur. Ka përparësi të prijë Imam edhe ai që është më i hershëm në besim ndaj të tjerëve, pastaj vjen më i moshuari dhe ai që ka fytyrë të bukur, kurse hashimiu (anëtarë të fisit Hashimi) ka përparësi të prijë Imam në respekt të stërgjyshërve të tij të nderuar, përvese kur ka argument kundër tij, ashtu siç ka thënë autori i librit “El Mesàlik” dhe autori i librit “Misbàhul Fakijh”. Autori i librit “El Xheuahir” ka cituar prej librit “Err Rreud” se shumica e fukahave të mëparshëm, në mënyrë absolute, nuk e kanë përmendur këtë.

Dyshuesi kthehet te ai që mban mend

Kur ai që fal namaz me Imam dyshon dhe mban mend Imami, ose dyshon Imami dhe mban mend ai që fal namaz me

Imam, cildo që të jetë dyshuesi prej këtyre të dyve, duhet të veprojë sipas atij që mban mend. Shejkh El Hamedànij, në librin “Misbàhul Fakijh”, thotë: “Pa asnjë kundërshtim, në asgjë prej këtyre të dyve, nga jashtë e në tërësi, ashtu siç tregon fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “*Imami s’ka detyrim të bëjë sexhdet e harrimit dhe as ai që fal namaz me Imam, s’ka detyrim të bëjë sexhdet e harrimit.*”

* * *

NAMAZI I UDHËTARIT

Shkurtimi namazit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Namazi në udhëtim është dy rekate dhe s’ka asgjë tjetër, as para e as pas këtyre dy rekateve, me përjashtim të namazit të mbrëmjes që mbetet tri rekate.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai që fal namazin të plotë në udhëtim është si ai që e fal namazin të shkurtuar në vendbanim.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Namazi katër rekatesh në udhëtim bëhet dy rekate, prandaj udhëtari e fal namazin e drekës, të pasdrekës dhe namazin e darkës dy rekate, kurse namazi i mbrëmjes mbetet në gjendjen e tij, tri rekate.” Gjithashtu, fukahatë kanë thënë: “Shkurtimi i namazit në udhëtim është vendosmëri e durim dhe nuk është lejim.”

Kuptimi i fjalës “lejim” këtu është që udhëtari të ketë të drejtën e përzgjedhjes: nëse dëshiron, e fal namazin të shkurtuar, nëse dëshiron, e fal namazin të plotë. Kuptimi i fjalës “azijmeh” – “vendosmëri e durim”, do të thotë që ai duhet të përmbahet në faljen e namazit të shkurtuar, sepse namazi i falur i plotë prej udhëtarit, në asnjë gjendje, nuk është i vlefshëm.

Këtu është me vlerë të përmendim bisedën e zhvilluar mes Zuares dhe Muhamed bin Muslimit me profesorin dhe me Imamin e tyre, Imam Bakirin (*Paqja qoftë mbi të!*), babain e Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*). Ata të dy i thanë atij: “Ç’na thua për namazin në udhëtim dhe si është ai namaz? Sa rekate është?”

Ai tha: “Allahu i Lartësuar urdhëron e thotë:

“وَإِذَا صَرْتُمْ فِي الْأَرْضِ فَلَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ أَنْ تَقْصُرُوا مِنَ الصَّلَاةِ...”

“Kur jeni në udhëtim, nuk është mëkat për ju të falni namazin të shkurtuar...” (Sure “En Nisa”, ajeti 101), pra, shkurtimi i namazit në udhëtim është bërë detyrim, ashtu siç është detyrim falja e plotë e namazit në vendbanim.”

Ata të dy i thanë: “Por, Allahu i Lartësuar thotë **“...nuk është mëkat për ju...”** dhe nuk thotë: “Bëjeni.” Atëherë si mund të jetë detyrim shkurtimi? Domethënë, si nuk qenka lejim, por qenka vendosmëri e durim?

Ai tha: “A nuk thotë Allahu i Gjithëpushtetshëm, në lidhje me Safan e Merven:

“...فَمَنْ حَجَّ الْبَيْتَ أَوْ اعْتَمَرَ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِ أَنْ يَطَّوَّفَ بِهِمَا...”

“...dhe kush shkon në shtëpinë (Qabe) për Haxh, ose për Umre, për atë nuk është mëkat të ecë edhe në ato të dyja...” (Sure “El Bekare”, ajeti 158).

A nuk e shikoni se ecja nga njëra kodër në kodrën tjetrën është detyrim? Allahu i Lartësuar, këtë e ka përmendur në Librin e Tij dhe e ka praktikuar Profeti i Tij. Gjithashtu, edhe faljen e shkurtuar të namazit në udhëtim Allahu e ka përmendur në Librin e Tij dhe e ka praktikuar Profeti i Tij.

Rrëzimi i namazit nafile

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Namazi në udhëtim është dy rekate dhe para e mbrapa këtyre dy rekateve s’ka asgjë tjetër, me përjashtim të namazit të mbrëmjes, pas të cilit falen katër rekate dhe këto katër rekate kurrë mos i le as në udhëtim e as në vendbanimin tënd. Gjithashtu, në udhëtim nuk ke detyrë të falësh namazet nafile të ditës, por fal vetën namazin e natës.”

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) për namazin nafile ditën në udhëtim. Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) është përgjigjur: “O bir, sikur namazi nafile në udhëtim të ishte i vlefshëm, do të ishte plotësuar namazi farz.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Babai im nuk linte pa falur çdo natë trembëdhjetë rekate, qoftë në udhëtim, qoftë kur ishte në vendbanim.” Me trembëdhjetë rekate ai ka qëllim namazin e natës dhe namazin e mëngjesit.

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Në udhëtim bie detyra për të falur rekatet nafile të namazit të drekës e të namazit të pasdites, por nuk bien detyra për të falur rekatet nafile të namazit të mbrëmjes e të namazit të mëngjesit. Gjithashtu, nuk bien as detyra për falur namazin e natës.”

Pastaj fukahatë patën kundërshtime: A bie detyra për të falur rekatet nafile të namazit të darkës? Autori i librit “El Xheuàhir”, ka thënë: “Thënia më në zë është ajo që kanë treguar shumë prej fukahave, që falja e nafileve në udhëtim bie si detyrë.” Pas diskutimit që bënë mbështetësit e mosrënies së detyrës për të falur këto rekate nafile, ai sjell edhe argumentet që ata parashtruan. Ai thotë: “Nga sa u tha dhe duke u bazuar në argumentet për mosrënien e detyrës për të falur këto rekate nafile, u bë e qartë se ka përparësi e kundërta e saj.”, domethënë mbetet detyra dhe jo rënia e detyrës.

Kushtet e shkurtimit

Për shkurtimin e namazit në udhëtim kërkohet plotësimi i disa kushteve, të cilat patjetër duhet të ekzistojnë, pasi kur nuk ekziston njëri prej këtyre kushteve, nuk ekziston as vetë shkurtimi dhe mbetet detyrimi për ta falur të plotë namazin. Këto kushte janë:

Largësia

1- *Udhëtimi*. Këtu nuk është qëllimi për udhëtimin, në kuptimin e tij të zakonshëm, domethënë që udhëtari i zakonshëm është udhëtar, edhe në ligjin e fesë. Jo, qëllimi për udhëtimin këtu ka një kuptim të veçantë, të cilin e shpjegon dhe e përkufizon vetë Ligjvënësi. Kjo është edhe arsyeja që për udhëtimin nuk është qëllimi për ndonjë largësi të veçantë, ose ai me udhëtimin e tij ka qëllimi mëkatin, ose ai të qëndrojë dhjetë ditë në ndonjë vend të veçantë gjatë udhëtimit të tij, ose udhëtimin e ka bërë profesion.

Në pikëpamjen e ligjit të fesë, të gjithë këta nuk janë udhëtarë, ashtu siç do ta sqarojmë më poshtë. Atëherë rezulton se në ligjin e fesë ka një të vërtetë ligjore dhe një term të veçantë për kuptimin e fjalës udhëtim. Nga sa u tha, del qartë konfuzioni e injoranca në fjalën e atij që ka thënë: “Detyrimi për të shkurtuar namazin dhe për të prishur agjërimin në udhëtim, është dita e udhëtimit, e cila është një pjesë prej mundimit të zjarrit.”

Kështu janë shprehur të mëparshmit në kohën e të cilëve s’kishte mjet tjetër udhëtimi përveç këmbëve e kafshëve. Sot, veçanërisht pas daljes së avionit e makinës, në të vërtetë udhëtimi është shndërruar në një shëtitje të këndshme, aq sa mund të mendohet se nuk ka mbetur më shkak që e bën detyrim shkurtimin e namazit dhe prishjen e agjërimit.

Ky thënës ka përzierë urdhrin të Ligjvënësit me zakonet e njohura në mesin e njerëzve (në kapitullin e adhurimeve) Atij i ka dalë nga mendja se kuptimi i udhëtimit te arabët dhe te të gjithë njerëzit është një gjë, kurse kuptimi i udhëtimit, në ligjin e shenjtë

të fesë, veçanërisht në lidhje me agjërimin e me namazin, është një gjë tjetër.

Si do që të jetë, cildo që flet për çështje fetare e ligjore, ka detyrë të mos mbështetet vetëm në të kuptuarit personal, sepse feja e Allahut, nuk matet dot me mendjet e njerëzve, ashtu siç ka ardhur prej Ehli Bejtit (*Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta!*), por ai ka detyrim të referohet në burimet e fesë e të ligjit të fesë dhe pastaj t'i nxjerrë ato nga goja me dituri të plotë.

Para se të kthehemi te këto burime, parashtrojmë sa më poshtë vijon:

Nëse supozohet se ligji i fesë e ka përcaktuar udhëtimin që e bën të detyrueshëm shkurtimin e namazit e prishjen e agjërimin me sipërfaqe e me vend dhe jo me orë e me kohë, por ka thënë: “Kur udhëton tetë “*ferseh*”¹ shkurto namazin dhe prishe agjërimin.”

Në këtë gjendje, kushdo që e përshkon këtë largësi, ose edhe më shumë, ka detyrim ta falë namazin të shkurtuar dhe të prishë agjërimin, pavarësisht se ai e përshkon largësinë e përcaktuar për një sekondë, ose për një ditë e për një natë.

Nëse supozohet se ligji i fesë e ka përcaktuar udhëtimin me orë e me kohë dhe jo me sipërfaqe e me vend, ka thënë: “Kur udhëton një ditë të plotë, shkurto namazin dhe prishe agjërimin.”

¹ Një “*fersekh*” është i barabartë me 5760 m. Nëse llogarisim katër “*fersekh*”, ato bëjnë 23 km e 40 m, kurse tetë “*ferseh*” bëjnë 46 km e 80 m. “*Mexhmau Lugah*”, autori, shejkh Ahmed Riza.

Në këtë gjendje, atij që i vazhdon udhëtimi një ditë të plotë, e ka detyrim të shkurtojë namazin dhe të prishë agjërimin, qoftë edhe nëse ai përshkon vetëm një *"ferseh"* në ditë. Nëse udhëtimi nuk vazhdon një ditë të plotë, nga fillimi i ditës deri në fundin e saj, ai as nuk e shkurton namazin e as nuk e prish agjërimin, edhe nëse përshkon një mijë *"ferseh"*.

Nëse supozohet që ligji i fesë e ka përcaktuar udhëtimin me kohë e me vend dhe ka thënë: "Kur në një ditë të vetme përshkon tetë *"ferseh"*, ai ka detyrim të shkurtojë namazin e të prishë agjërimin.", domethënë: Vetëm nëse udhëtari përshkon tetë *"ferseh"* në një ditë vetme, ai shkurton namazin e prish agjërimin. Nëse udhëtari përshkon një mijë *"ferseh"*, por udhëtimi nuk ka vazhduar një ditë të plotë, ose udhëtimi ka vazhduar gjithë ditën, por ai ka përshkuar tetë *"ferseh"* pa një metër, për këtë udhëtar nuk lejohet as të shkurtojë namazin e as të prishë agjërimin.

Sikur të supozohet që ligji i fesë e ka bërë detyrim shkurtimin e namazit dhe prishjen e agjërimin për udhëtarin, sipas njërit prej dy përcaktimeve, domethënë, kur udhëton një ditë të plotë, ose kur përshkon tetë *"ferseh"*, shkurtoje namazin dhe prishe agjërimin. Pra, është detyrim shkurtimi i namazit e prishja e agjërimin për këdo që udhëton një ditë të plotë, edhe nëse ai nuk përshkon tetë *"ferseh"*. E ka detyrim të shkurtojë namazin e të prishë agjërimin udhëtari që përshkon tetë *"ferseh"*, edhe nëse udhëtimi i tij nuk vazhdon gjithë ditën. Nuk lejohet as shkurtimi i namazit e as prishja e agjërimin, për udhëtarin që ka përshkuar më pak se tetë *"ferseh"* dhe udhëtimi i tij ka vazhduar më pak se një ditë.

Pyetje: Cilën nga këto dy njësi matëse ka vënë në konsideratë ligji i fesë? A ka vënë në konsideratë vetëm kohën, ose vetëm vendin, ose i ka vënë të dyja së bashku, ose njërën prej të dyjave të papërcaktuara?

Përgjigje:

Në të vërtetë, ai që ndjek transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit, do të gjejë se disa transmetime e përcaktojnë udhëtimin me sipërfaqen e me vendin. Fadl bin Shadhan tregon se Imami Riza (*Paqja qoftë mbi të!*) i shkroi Memunit: “*Shkurtimi është në tetë “ferseh” e më shumë. Kur të shkurtosh namazin, prish edhe agjërimin.*” Edhe Muham’med bin Muslim transmeton prej Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: “*Shkurtimi i namazit bëhet detyrim në dy “berijd”.*” Një “berijd është i barabartë me katër “ferseh”.

Transmetime të tjera të ardhura prej Ehli Bejtit e përcaktojnë udhëtimin me kohë. Ibn Jaktijn tregon se Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Shkurtimi i namazit bëhet detyrim kur ecet një ditë.*”

Të tjera transmetime e përcaktojnë udhëtimin me njërën prej të dyjave. Ebu Besijri tregon: “Pyeta Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*): “*Sa e shkurton namazin burri?*” Ai tha: “*Në të bardhën e një dite, ose në dy “berijd”.*”

Transmetimi i parë për përcaktimin e udhëtimit vinte në konsideratë vendin. Atëherë bëhet e detyrueshme përmbajtja me këtë transmetim dhe në asnjë gjendje nuk shkëputet prej tij, sepse,

bazuar në tekstin e dy transmetimeve, ai që përshkon tetë *"ferseh"*, e ka detyrim të shkurtojë namazin e të prishë agjërimin.

Patjetër që këto dy transmetime dhe transmetimet e tjera, që janë në rrjedhën e dy transmetimeve të mësipërme, duhet të merren në një kuptim të vetëm. Në atë mënyrë që ky kuptim të jetë origjinë e bazë, kurse kuptimet tjera, veç këtij, duhet të shpjegohen vetëm duke u mbështetur në kuptimin që ne i dhamë. Ky kuptim themelor nuk mund të mos përmbajë njërin prej tre njësive të përcaktimit: ose vetëm vendin, domethënë tetë *"ferseh"*, ose vetëm kohën, domethënë të bardhën e një dite, ose njërën prej të dyjave të papërcaktuara. Por argumentet përcaktojnë tetë *"ferseh"*, kurse njësitë e tjera të udhëtimit, si dita, shpjegohen me argumentet e mëposhtme:

E para: Dita nuk ka kufi të caktuar, pasi është më e gjatë ose më e shkurtër, sipas ndryshimit të stinëve dhe është e kundërta e *"ferseh"*, që ka të njëjtën gjatësi. Atëherë del si domosdoshmëri që dita të shpjegohet me *"ferseh"* dhe jo e kundërta.

Abdurrahman bin Haxh'xhaxhit i ka tërhequr vëmendjen ndryshimi i gjatësisë së ditëve, prandaj për këtë çështje ai ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*). Imami e shpjegoi ditën me *"ferseh"*.

Abdurrahmani tregon: "I thashë Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): "Sa është koha më e shkurtër, në të cilën shkurtohet namazi?" Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) mu përgjigj: "Suneti është me bardhësinë e një dite." I thashë: "E bardha e një dite ndryshon. Burri ecën pesëmbëdhjetë *"ferseh"* në një ditë dhe një burrë tjetër ecën katër *"ferseh"*, kurse një tjetër ecën pesë *"ferseh"* në një ditë. Imami tha: "Këto gjëra nuk shikohen. A nuk e ke parë mbartjen e atyre peshave prej Mekës në

Medine? Pastaj bëri me shenjë me dorën e tij njëzet e katër milje që janë tetë “ferseh”.

I ngjashëm me këtë tregim është edhe transmetimi i ardhur prej Semahit, i cili tregon: “E pyeta Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) se sa e shkurtor udhëtari namazin. Ai tha: “Aq sa ecën në një ditë. Kjo largësi është e barabartë me dy “*berijd*” që bëjnë tetë “ferseh”.”

Pasi Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) e shpjegoi largësinë që duhet përshkuar me “ferseh”, nuk ka më vend që udhëtimi të përcaktohet me kohën.

E dyta: Njeriu mund të ecë në një ditë tetë “ferseh”, mund të ecë edhe më shumë, por mund të ecë edhe më pak se kaq, pasi ecja në një ditë përfshin tetë “ferseh” e të tjera. Prandaj patjetër absolutja duhet të mbartet mbi të kushtëzuarën. Përveç kësaj, transmetimet që tregojnë sipërfaqen dhe vendin janë ku e ku më të shumta se sa transmetimet që tregojnë për ditën e për kohën.

E treta: Fjala e përbashkët e fukahave: “Ai që përshkon tetë “ferseh”, ka detyrim ta falë namazin të shkurtuar dhe të prishë agjërimin, edhe kur ai e përshkon këtë largësi në më pak se një ditë.”

Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Fjala e përbashkët e fukahave me të dyja pjesët, është e realizueshme në përcaktimin me dy “berijd”, edhe kur kjo largësi përshkohet në një pjesë të ditës.” Autori i librit “Misbàhul Fakijh” ka thënë: “Merret në konsideratë arritja e këtij kufiri dhe është e barabartë, qoftë kur përshkohet në një ditë, qoftë kur përshkohet në më pak se një ditë,

ose edhe më shumë se një ditë, pasi kufiri i vërtetë është dy “berijd”, që bëjnë tetë “ferseh”.

Nga sa thamë më sipër, u bë e qartë se për ligjin e fesë ka një të vërtetë ligjore dhe një terminologji praktike të veçantë në lidhje me kuptimin e udhëtimit e të ecjes që e bëjnë detyrim shkurtimin e namazit e prishjen e agjërimit. Gjithashtu, ligji i fesë e ka përcaktuar këtë kuptim dhe e ka shpjeguar me tetë “ferseh”. Do të ishte naivitet, nëse do të mendohet të kishte hulumtim kundrejt tekstit, sidomos në adhurimet, pasi për adhurimet nuk gjendet shembull as në filozofitë, as në komentimin me kohën e as në shpjegimet me lodhjen e me vështirësitë e udhëtimit.

Largësia vajtje-ardhje

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Sa është largësia më e afërt në të cilën udhëtari fal namaz të shkurtuar?” Ai është përgjigjur: “Një “berijd” vajtje dhe një “berijd” ardhje.”

Përsëri është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për shkurtimin e namazit. Ai tha: “Në katër “ferseh”.”

Është pyetur Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), se sa duhet të ishte largësia që të bëhet shkurtimi i namazit. Ai është përgjigjur: “Një “berijd”.” Pyetësi u çudit dhe tha: “Një “berijd”?!” Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha atij: “Kur shkoi, eci një “berijd” dhe kur u kthye, eci një “berijd” dhe kjo vajtje-ardhje i hëngri atij ditën të gjithë.”

Fukahatë

Fukahatë kanë një mendim të përbashkët për të mos bërë dallim në tetë *“ferseh”*, si gjatësi lineare, në atë mënyrë që udhëtari i përshkon tetë *“ferseh”* vetëm në vajtje, apo tetë *“ferseh”* janë të përbërë nga katër *“ferseh”* ose më shumë vajtje dhe katër *“ferseh”* të tjerë ose më pak në ardhje, apo kjo shumë vajtje-ardhje bëjnë tetë *“ferseh”*, me kusht që vajtja të mos jetë më pak se katër *“ferseh”* dhe udhëtari të kthehet në banesën e vet brenda 24 orësh gjatë të cilave ai ka udhëtuar.

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët që udhëtari as nuk shkurton namazin e as nuk prish agjërimin, kur ai ka bërë nijet të qëndrojë dhjetë ditë në vendin ku ka qëllim të arrijë dhe nuk ka dëshirë të kthehet prej aty në më pak se dhjetë ditë. Gjithashtu, fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët, kur rruga që përshkon udhëtari vajtje-ardhje, brenda një dite të plotë, është më pak se katër *“ferseh”*, këtij udhëtari nuk i lejohet as ta falë namazin të shkurtuar e as të prishë agjërimin.

Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) është: *“Një “berijd” vajtje dhe një “berijd” ardhje.”* Kjo fjalë e Imamit (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon fare qartë se shuma e vetëm e një vajtje-ardhjeje të rezultojë tetë *“ferseh”* dhe të mos jetë rezultat i shumës së disa vajtjesh e të disa ardhjesh. Fukahatë kanë pasur kundërshtime mes tyre rreth dy çështjeve:

E para: Kur rruga e vajtjes është më pak se katër *“ferseh”* dhe rruga e ardhjes është më shumë se katër *“ferseh”*. Shuma përsëri është tetë *“ferseh”*. Ky udhëtar a e fal namazin të shkurtuar apo jo dhe a e prish apo nuk e prish agjërimin? Autori i librit “El

Urvetul Uthkà”, Sej’jid Kadhim, ka thënë: “Bazuar në transmetimin më të fuqishëm, ai e fal namazin të shkurtuar dhe e prish agjërimin.”

E dyta: Kur udhëtari nuk kthehet brenda ditës dhe qëndron në vendin ku kishte qëllim të shkonte disa ditë, por qëndron më pak se dhjetë ditë. Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Ai e fal namazin të shkurtuar, sepse për largësinë, merret qëllimi që ajo ka dhe jo që kjo largësi të përshkohet brenda një ditë të vetme.” Por mbi atë mbetet detyrë të agjërojë, si të kishte bërë nijet për të qëndruar aty dhjetë ditë, sepse me këtë qëndrim ai e ndërpreu udhëtimin e tij. Këtë çështje do ta sqarojmë më poshtë.

Nijeti për të përshkuar largësinë

2- Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për qëllimin e largësisë për një person që del prej Bagdadit, që të bashkohet me një burrë, derisa arrin në Neheruan. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Ai as nuk e shkurton namazin dhe as nuk e prish agjërimin, sepse ai doli prej shtëpisë së tij jo me nijet që të udhëtonte tetë “ferseh”, por që të takonte shokun e tij në një pjesë të rrugës, pavarësisht se udhëtimi i tij vazhdoi deri aty ku kishte bërë nijet të arrinte.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se kushti i dytë prej kushteve të shkurtimit të namazit është: Udhëtari bën nijet që në fillim të udhëtimit se do të përshkojë tetë “ferseh” linear, ose kjo largësi të

jetë e përbërë vajtje-ardhje. Prandaj kush del prej shtëpisë së tij pa këtë nijet, është si ai që del të kërkojë ndonjë send për të cilin ka nevojë dhe kthehet vetëm atëherë kur e gjen sendin që i duhet. Ky njeri nuk e shkurton namazin, veçse kur ka ecur tetë *"ferseh"*. Atëherë ai e shkurton namazin, që kur fillon kthimin. Në këtë gjendje, argumentet e bëjnë detyrim shkurtimin e namazit.

Kur ai përshkon më pak se tetë *"ferseh"* pa nijetin se do të ecë tetë *"ferseh"*, por pastaj përtërin nijetin se do të ecë edhe disa *"ferseh"* të tjerë, që si shumë së bashku me *"ferseh"*-ët e kthimit, bëjnë tetë *"ferseh"*, ai fal namazin të shkurtuar dhe prish agjërimin, me kusht që të ketë vendosur të kthehet, kur përtërin nijetin e udhëtimit. Me fjalë të tjera, rregulli për shkurtimin e namazit është se ai që në fillim bën nijet të ecë tetë *"ferseh"*, në atë mënyrë që të gjitha këto *"ferseh"* ai i bashkon në një nijet të vetëm. Por, nëse ai në fillim bën nijet të udhëtojë vetëm katër *"ferseh"*, pastaj pesë, pastaj gjashtë dhe pastaj shtatë *"ferseh"*, ai nuk e shkurton namazin, edhe pse e di që largësia që ai ka përshkuar, arrin tetë *"ferseh"*, ose edhe më shumë.

Ashtu siç është detyrim nijeti i udhëtimit, po ashtu është detyrim edhe vijimësia e këtij nijeti. Sikur ai të heqë dorë nga nijeti për udhëtim, ose shkon e vjen gjatë kohës që është në rrugë, kushti nuk ekziston më, por është i mjaftueshëm nijeti i dy udhëtimeve, pavarësisht se nijetin ai e kishte të arrijë vetëm në një vend ose në disa vende. Le të supozojmë, për shembull, se ai ka nijet të shkojë në Damask. Por gjatë rrugës heq dorë dhe i duhet të shkojë në Kajro. Me këtë rast, s'ka asnjë problem, derisa nijeti bazë është realizuar. Me një fjalë, synimi është që nijeti të vazhdojë kundrejt mospasjes nijet me një herë të vetme.

Nuk ka asnjë dallim ndërmjet nijetit për largësinë, sipas ligjit të fesë dhe nijetit autentik, ose nijetit për të ndjekur dikë, për shembull, gruaia ndjek burrin, ose shërbyesi ndjek personin që i shërben. Gjithashtu, nuk ka dallim as ndërmjet faktit që nijeti të arrijë dëshirën ose për zgjedhjen, ose kur nijeti është nga nevoja e nga detyrimi, si për shembull, robi i luftës, derisa është në dijeni që largësia që do të përshkojë është vetëm një herë.

Qëndrimi dhjetë ditë në një vend

3- Kushti i tretë është që ai të mos e ndërpresë udhëtimin e tij me nijet për të qëndruar dhjetë ditë në një vend. Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Kur ti hyn në ndonjë vend dhe dëshiron të qëndrosh aty dhjetë ditë, fale namazin të plotë, kur të arrish. Por nëse dëshiron të qëndrosh më pak se dhjetë ditë, namazin fale të shkurtuar dhe, nëse do të qëndrosh, thuaj: “Nesër do të shkoj, ose do të shkoj pasnesër.” Gjithsesi, nuk mblidhen dhjetë ditë, atëherë të falësh namazin të shkurtuar, edhe deri një muaj, duke e shtyrë udhëtimin me këtë mënyrë. Por kur të mbushet muaji dhe ti akoma nuk ke udhëtuar, atëherë fale namazin të plotë.”*

Fukahatë

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët mes tyre, për të punuar me këtë transmetim dhe janë shprehur: *“Kur ai ka qëllim distancën ligjore, por ai, në të njëjtën kohë, me veten e tij, bën nijet të qëndrojë në një vend të veçantë gjatë kësaj distance, para se të kalojë më shumë se dhjetë ditë, udhëtimi i tij ndërpritet dhe ai e ka*

detyrim ta falë të plotë namazin. E njëjta gjë është edhe kur tejkalohej dhjetë dittë. Ai, pasi vjen dhjetëditëshi i ri, ka detyrë ta përsërisë nijetin për të qëndruar dhjetë ditë. Në këtë rast, ai e fal namazin të plotë dhe nuk i rikthehet rregullit për të falur namaz të shkurtuar, përveçse kur dëshiron të ndërmarrë një udhëtim të ri, sipas të gjitha kushteve të udhëtimit, plotësisht ashtu sikur doli prej shtëpisë së tij.

Ai që e kapërcen largësinë dhe arrin në vendin ku dëshiron, por nuk ka bërë nijet të qëndrojë aty dhjetë ditë, por gjatë kësaj kohe ai shkon e vjen, ky njeri fal namazin të shkurtuar dhe prish agjërimin për një muaj të plotë dhe, pas përfundimit të muajit, ai ka detyrim ta falë të plotë namazin, qoftë edhe kur i ka mbetur vetëm një orë.

Atdhe

Në ligjin e fesë nuk ka ndonjë të vërtetë ligjore ose ndonjë term të veçantë në lidhje me kuptimin e fjalës atdhe, kur kjo fjalë përdoret si subjekt në argumentet ligjore, prandaj për të shpjeguar e për të përkufizuar këtë fjalë, ne i referohemi traditës, plotësisht ashtu siç veprojmë për subjekte të tjera, kuptimin e të cilave Ligjvënësi e ka lënë detyrë për njerëzit. Kur Ligjvënësi vendos të thuhet “atdhe” për një vend, kuptimi nuk është se Ligjvënësi e ka konsideruar atë vend “atdhe ligjor”, ose i ka dhënë këtë status, sepse, në realitet, ai është “atdhe”. Kurrsesi, pasi kush bën nijet të qëndrojë në një vend dhjetë ditë, ose shkon e vjen aty gjatë tridhjetë ditëve, te Ligjvënësi ai është me statusin e banorit vendas, duke e ditur që ky cilësim do të mbarojë për udhëtarin e

për vetë vendin, sidomos tani që kemi mësuar se është prej rrugës së Ligjvënësit të bashkojë në një gjykim të vetëm subjektet e shpërndara dhe të ndajë në vendin e duhur ato që janë të bashkuara.

Kushdo që qëndron në ndonjë vend, me qëllim që të banojë aty përgjithmonë, ky vend, tradicionalisht, si dhe nga ana gjuhësore e ligjore, për këtë njeri bëhet “atdhe”, pavarësisht se ai ka ose nuk ka pasuri në atë vend. Gjithashtu, është e barabartë, qoftë kur ai kalon, qoftë kur nuk i kalon në atë vend gjashtë muaj. Njeriu mund të ketë dy ose më shumë atdhe, si për shembull, të supozojmë se ai bëri nijet të verojë në një vend dhe të dimërojë në një vend tjetër gjatë gjithë jetës së tij. Ose ai ka dy gra në dy vende dhe shkon e banon te secila grua një javë, ose një muaj, derisa të jetë gjallë. Kush largohet prej një vendi të cilin ai e kishte bërë atdhe, ai menjëherë bëhet i huaj për këtë vend, madje, edhe nëse aty ka pasuri, ose ka tokë, gurë e pemë.

Fukahatë kanë rënë në konsensus se prej kushteve për shkurtimin e namazit është që udhëtari të mos e ndërpresë udhëtimin e tij, kur arrin në këtë atdhe as me nijetin për të qëndruar dhjetë ditë e as të qëndrojë në një vend, duke vajtur e duke shkuar për tridhjetë ditë. Por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre për atë person që arrin në një vend që ai nuk e merr për atdhe, por ai aty ka pasuri. Fukahatë shtrojnë pyetjen: A është ndërprerë apo jo udhëtimi i këtij personi? Autori i librit “Miftâhul Kerâmeh” ka thënë: “Thënia më në zë ndërmjet fukahave të mëvonshëm thotë se thjesht një pasuri, qoftë ajo një rrënjë e vetme hurme, është e mjaftueshme që të prishet udhëtimi i tij, me kusht që ai të banojë në atë vend gjashtë muaj.”

Autori i kësaj thënie është dijetari poliedrik, Muhak'kik, ndër dijetarët më të dëgjuar të kohës së tij dhe të atyre që erdhën pas tij. Në librin “Et Tedhkireh” thuhet: “Sikur gjatë përshkimit të distancës, ai të kalojë nëpër një vend, në të cilin ai ka pronë dhe ku ka banuar për gjashtë muaj, udhëtimi i tij ndërpritet, sapo ai të arrijë në atë vend. Prandaj ai tani, në pikëpamjen e dijetarëve tanë, ka detyrim ta falë të plotë namazin. Në librin “Err Rreud” flitet për pretendimin e fjalës së përbashkët të fukahave në lidhje me këtë thënie, pa asnjë diferencë në kuptim.”

Bazuar mbi këtë transmetim, arritja në atdhe e ndërpret udhëtimin, kur në gjykimin e këtij udhëtari kemi njërën nga tri punët: nijetin për të qëndruar aty dhjetë ditë, vajtje-ardhje për të qëndruar tridhjetë ditë, ose arrin në një vend, ku ai ka pronë, me kusht që në të këtë vend ai të ketë banuar gjashtë muaj pa ndërprerje, udhëtimi i tij nuk ndërpritet, edhe nëse banon në atë vend gjashtë muaj, pa disponuar pronë, ose disponon pronë, por nuk banon aty.

Përsërisim për herë të dytë dhe theksojmë se për Ligjvënësin s’ka as të vërtetë ligjore e as ndonjë term specifik për kuptimin e fjalës “atdhe”, pasi atdheu është një gjë dhe dhënia e gjykimit për të konsideruar atdhe një vend të çfarëdoshëm, është një gjë tjetër.

Ligjërimi i udhëtimit

4- Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) ka thënë: “Kush udhëton, ai fal namaz të shkurtuar dhe prish agjërimin, me përjashtim të atij që udhëton për gjah, ose për të kryer ndonjë mëkat ndaj Allahut, ose është

postier për atë që kryen mëkate ndaj Allahut, ose ai udhëton në kërkim të urrejtjes e të armiqësisë, ose udhëton që të shkojë i shoqëruar me dikë te pushtetari, ose udhëton për të dëmtuar ndonjë grup myslimanësh.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që del për gjah dhe udhëton një ditë, ose dy ditë, ose edhe tri ditë, a e fal namazin të shkurtuar ky njeri apo e fal të plotë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Në qoftë se ka dalë për gjueti për të siguruar ushqim për vete e për familjen e tij, ai le ta prishë agjërimin dhe le ta falë namazin të shkurtuar, por në qoftë se ka dalë për gjah që të zbavitet, ai as nuk e prish agjërimin dhe as nuk e shkurton namazin, madje ai s’ka asnjë nderim.”

Fukahatë

Prej kushteve të shkurtimit të namazit e të prishjes së agjërimin në udhëtim është: Motivi e shtytësi i parë për udhëtimin të mos jetë mëkati e kryerja e mëkatit, si për shembull, ai që udhëton me qëllim që të tregtojë verë, ose të vrasë një të pafajshëm, ose për të dëshmuar gënjeshtren, ose për të sjellë ngatërresa, ose të përhapë thashetheme e të tjera punë të ngjashme me këto. Në qoftë se qëllimi parësor me udhëtimin e tij është kryerja e haramit, ai ka detyrim të agjërojë dhe namazin ta falë të plotë. Në qoftë se qëllimi i udhëtimit dhe motivi që e bën atë të udhëtojë është një punë hallall, por ai gjatë udhëtimit kryen një punë haram, ashtu si e kryen atë, kur është në vendin e në shtëpinë e tij, ai fal namazin të shkurtuar dhe prish agjërimin, sepse rregulli është që udhëtimi, në vetvete, të mos jetë haram, si për shembull, ai që i fshihet drejtësisë, ose udhëtimi është për një qëllim haram, si për shembull ai që udhëton për të rrëmbyer e për

të grabitur. Nëse ai e bën punën haram gjatë udhëtimit e në gjendjen që është udhëtar, udhëtimi i tij nuk ndërpritet.

Sikur ai të udhëtojë që në fillim me qëllimin për të kryer punë haram, por gjatë rrugës ai bën teube dhe kthehet, ai fillon një udhëtim të ri. Nëse plotësohen kushtet e udhëtimit, ai e fal namazin të shkurtuar dhe prish agjërimin. Udhëtimi i parë që bëri, konsiderohet sikur s'ka udhëtuar fare. Në qoftë se ai udhëton për një qëllim hallall, por gjatë rrugës heq dorë nga qëllimi i tij i udhëtimit dhe kryen një punë haram, ai e fal namazin të plotë dhe agjëron, madje edhe sikur të ketë përshkuar me nijetin e bindjes ndaj urdhrave të Allahut tetë "*ferseh*" ose edhe më shumë.

Gjuetia

Gjuetia është tri llojesh: njeriu herë gjuan për të ushqyer veten e familjen e tij, herë tjetër gjuan për të tregtuar gjahun dhe herë gjuan për zbavitje. Me fjalën e përbashkët të fukahave, gjahu i parë është hallall. Kush udhëton me këtë qëllim, ai fal namazin të shkurtuar dhe prish agjërimin. E dyta është fushë kundërshtimesh mes fukahave të mëparshëm e të mëvonshëm. Shumica e fukahave të mëparshëm janë shprehur se gjuetia për tregti është haram. Por në udhëtimin për këtë gjueti, ata kanë ndarë mes agjërimit e namazit dhe kanë thënë se ai që udhëton për gjueti, me qëllim që të shesë gjahun, ai prish agjërimin dhe nuk e shkurton namazin. Shumica e fukahave të mëvonshëm janë shprehur se kjo gjueti është hallall dhe ai që udhëton për këtë lloj gjuetie, ka të drejtë ta prishë agjërimin dhe të shkurtojë namazin.

Ne gjithmonë jemi së bashku me fukahatë e rinj, dijetarë e të përkushtuar, ashtu siç e kemi shpjeguar në kapitullin “Falja e namazit kaza”. Prandaj me ndarjen mes agjërimit e namazit, nuk kuptojmë ndonjë formë tjetër, pasi është vërtetuar se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Kur shkurton namazin, prish edhe agjërimin dhe, kur prish agjërimin, shkurton edhe namazin.”*

Gjuetia e tretë, domethënë gjuetia për zbavitje, te shumica e fukahave të mëparshëm e të mëvonshëm, është haram. Shejkh El Hamedànij, pasi e ka citur këtë feta, në kapitullin “Namazi i udhëtarit”, tekstualisht ka thënë: “Tregohet prej El Mukad’des El Bagdadij se ai e ka mohuar që ajo të jetë haram, domethënë gjuetia për zbavitje, madje ai e ka mohuar shumë ashpër dhe këtë lloj gjuetie e ka bërë si shëtitje për të shikuar pamje të gëzueshme, anije të bukura, ose të shikojë vendet ku mblidhen shumë njerëz, natyrisht nga vendmbledhje, që në ligjin e fesë janë të lejuara në mënyrë të laksative.”

Pastaj shejkh El Hamedànij e ka zgjatur shumë fjalën rreth fetvasë së El Mukad’des El Bagdadij. Duket se shehu El Hamedànij anon kah kjo feta. Prandaj ai e përmbledh fjalën, duke bërë kujdes që të jetë sa më i qartë në shprehje dhe në mënyrë të përmbledhur është shprehur: “Njoftimet e ardhura prej Ehli Bejtit nuk tregojnë se gjuetia për zbavitje është haram, por ato tregojnë se është detyrim që namazi të falet i plotë kur udhëtohet, me qëllim këtë lloj gjuetie.” Është e kuptueshme se falja e plotë e namazit është një gjë dhe ndalimi i prerë (haram) është një gjë tjetër. Prandaj falja e namazit të plotë është detyrim për atë që e ka gjuetinë profesion, ashtu siç është detyrim për atë që bën nijet të qëndrojë dhjetë ditë në ndonjë vend, ose ai që shkon e vjen në atë vend gjatë një muaji të plotë, duke ditur se profesioni i udhëtimit,

nijeti për të qëndruar në ndonjë vend dhe vajtje-ardhja në atë vend, të gjitha këto janë veprime hallall.

Dalja në dritë e gabimit

Pyetje: Kur udhëtari beson se udhëtimi që ai ka ndërmarrë është haram, prandaj e fal namazin të plotë, por më pas, për të bëhet e qartë se kjo bindje e tij ishte gabim, sepse udhëtimi i tij ishte i lejuar. A mbetet detyrim mbi këtë njeri ta përsërisë namazin, duke e falur të shkurtuar? Le të supozojmë se ai nuk fali namaz gjatë udhëtimit, namazin kaza ai duhet ta falë të shkurtuar apo të plotë?

Përgjigje:

Të gjitha dispozitat e ligjit të fesë kanë lidhje me subjektet e veta reale. Bazuar mbi këtë gjykim e pavarësisht nga dituria që ai ka për këto dispozita, bën përjashtim, kur vërtetohet me argument se subjekti i asaj dispozite është i kushtëzuar me diturinë. Këtu nuk ka argument. Atëherë veprimi kryhet duke u bazuar mbi realitetin. Prandaj, pasi të zbulohet kundërshtimi, ai ka detyrë që atë namaz ta falë të shkurtuar dhe, është e barabartë, qoftë kur ai e ka falur namazin të plotë, qoftë kur nuk e ka falur fare. Prandaj ai është i penguar, derisa realiteti nuk është zbuluar te ai.

Udhëtimi profesion

5- Është kusht që udhëtimi të mos jetë profesion për udhëtarin. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Nomadët e shkretëtirës nuk e shkurtojnë namazin, sepse banesat e tyre janë së bashku me ta.”*

Gjithashtu Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Pesë kategori njerëzish e falin namazin të plotë, qofshin në udhëtim, qofshin në vendbanimin e tyre: përçuesi i kafshëve të ngarkesës, postieri, bariu... dhe detari, sepse këto janë punët e tyre.”*

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Kush nuk ka vendbanim të caktuar, në mënyrë absolute, ai as nuk e shkurton namazin dhe as nuk e prish agjërimin gjatë Muajit të Ramazanit. Gjithashtu, nuk e shkurton namazin dhe nuk e prish agjërimin as ai që është turist gjatë gjithë jetës së tij dhe as banori nomad i shkretëtirës që është vazhdimisht në kërkim të ujit e të kullotës.

Gjithashtu, nuk e shkurton namazin dhe nuk e prish agjërimin, cilido që udhëtimin e ka profesion, siç është shoferi i makinave me pagesë, edhe nëse në udhëtimin e tij përshkon tetë “ferseh”, megjithëse do të ishte më mirë të ishin më pak se tetë “ferseh”, siç është për shembull detari, piloti dhe ai që e ushtron tregtinë në udhëtim e sipër, domethënë ai që e ka tregtinë me vete ngado që shkon dhe nuk ka dyqan në një vend të caktuar tregtari shëtitës). Nga kjo pikëpamje, ky tregtar shëtitës është plotësisht si

nomadi i shkretëtirës, që ka shtëpinë me vete, ashtu siç është shprehur vetë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*).

Kur ndonjëri prej këtyre që u thanë, qëndron në ndonjë qytezë, dhjetë ditë, profesioni i tij ndërpritet. Prandaj ai fal namazin të shkurtuar në vaktin e parë të ushqimit dhe e fal namazin të plotë në vaktin e dytë të ushqimit, pa asnjë dallim se ka bërë nijet ose nuk ka bërë nijet që në fillim të qëndrojë në këtë qytezë dhjetë ditë. Për sa i përket qëndrimit dhjetë ditë jo në qytezë, profesioni nuk ndërpritet, veçse kur është së bashku me nijetin që në fillim për të qëndruar aty dhjetë ditë. Dallimin ndërmjet vendit të banuar dhe një vendi tjetër, e kanë përmendur shumë fukahë, madje disa prej tyre kanë pretenduar se kjo çështje gëzon fjalën e përbashkët të fukahave.

Njoftimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë për ta!*) nuk tregojnë as nga afër e as nga larg për këtë çështje, ashtu siç nuk tregojnë as për vajtje-ardhjen për një muaj në vendin ku ka arritur udhëtari. Në të vërtetë, transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit, nijetin për të qëndruar dhe vajtje-ardhjen, i kanë përmendur ndër ndërprerësit e udhëtimit, prandaj atashimi i punës së udhëtimit në këto transmetime, është analogji e gabuar.

E vërteta është se qëndrimi dhjetë ditë në një vend të banuar ose në një vend të pabanuar, me nijet ose pa nijet, e ndërpret udhëtimin, sepse transmetimi që ka cituar shejkh El Hamedàni dhe të tjerë, është bazë në këtë dispozitë. Gjithashtu, në këtë transmetim, në mënyrë absolute nuk përmendet nijeti. Ja edhe teksti i transmetimit: “Pyeta Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për kufirin e përçuesit të kafshëve të ngarkesës që agjëron dhe fal namazin të plotë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) u përgjigj:

“Çdo përçues kafshësh që banon në shtëpinë e vet, ose banon më pak se dhjetë ditë në vendin ku hyn, ai gjithnjë e ka detyrim të agjërojë dhe ta falë namazin të plotë. Në qoftë se vendbanimi i tij është shtëpia e tij, ose në vendin ku ai ka hyrë për më shumë se dhjetë ditë, domethënë dhjetë ditë e më shumë, ai ka detyrë ta falë namazin të shkurtuar dhe ta prishë agjërimin.”

Autori i librit “Misbâhul Fakijh” ka thënë: “Ky transmetim, edhe pse është i gradës “Daijf”, nga ana e përcjellësve, fukahatë kanë punuar me këtë transmetim dhe është argumenti më i fuqishëm e më i saktë ndër të gjitha transmetimet që flasin për këtë çështje, atëherë dyshimi në këtë transmetim për shkak të gradës “Daijf” (dobët) të përcjellësve, nuk është në vendin e duhur, sidomos pas pohimit se puna e fukhave e mposht gradën “Daijf” të transmetimit.

Nëpunësia dhe puna

Këtu kemi një çështje rreth së cilës janë të shumta pyetjet rreth dispozitës së saj, sepse ndodh shpesh që njerëzit të vihen para sprovas, për shkak të detyrës e të punës. Kjo çështje konsiston në faktin se, pas lehtësimit që sjellin mjetet e komunikacionit, njeriu mund të banojë së bashku me familjen jo në vendin e nëpunësisë e të punës së tij dhe shkon në punën e tij një ditë ose më shumë në javë dhe kthehet në shtëpinë e vet në të njëjtën ditë, ose ditën pasardhëse, madje kështu vazhdon me vite, ose edhe gjatë gjithë jetës së tij. Si duhet të veprojë ky njeri, të shkurtojë namazin dhe të prishë agjërimin, apo të falë namazin të plotë dhe të agjërojë? Duke ditur që largësia ndërmjet vendbanimit të tij dhe vendit të punës së tij është tetë “ferseh”, ose

edhe më shumë, pasi ai nuk qëndron as në shtëpinë e tij e as në vendin punës, dhjetë ditë pa shkëputje.

Përgjigje:

Përgjigja për këtë pyetje konsiston në faktin se duhet të dihet qëndrimi për të falur namazin të plotësuar dhe për të mos prishur agjërimin në Muajin e Ramazanit. Këto dy veprime, siç është shpjeguar, janë të varura nga marrja e udhëtimit profesion, pra, që udhëtimi është puna e tij e mirëfilltë, ashtu siç pamë për përçuesin e kafshëve të ngarkesës e të ngjashëm me të, pavarësisht se udhëtimet janë shumë ose pak, ose falja e plotë e namazit dhe agjërimi janë të varura sipas përshkrimit të bërë, që njeriu të mos banojë në vendin e vet dhjetë ditë pa shkëputje, në atë mënyrë që të vihen në konsideratë udhëtimet e shumta dhe jo me marrja e udhëtimit profesion. Në rastin e parë, ai fal namaz të shkurtuar dhe prish agjërimin, sepse obligimi është që udhëtimi të mos merret profesion, domethënë dispozita me të cilën është ndërtuar rregulli për të mos prishur agjërimin dhe për faljen e plotë të namazit. Kur puna e tij nuk është udhëtim, edhe pse, në vetvete, ka udhëtime të shpeshta, por dihet se udhëtimet e shpeshta janë një gjë dhe marrja e udhëtimit profesion është një gjë tjetër. Prandaj në të dytën ai nuk e shkurton namazin dhe nuk e prish agjërimin, sepse obligimi është që ai që udhëtojë shpesh dhe dispozita e agjëritimit dhe e faljes së plotë të namazit është e varur nga shumica dhe jo ngaqë udhëtimi është profesion.

E vërteta që e mbështesin të gjithë fukahatë më të dëgjuar, është ajo që përfitohet prej fjalëve të Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i*

Allahut qoftë mbi ta!), është rasti i parë, domethënë që agjërimi e falja e plotë e namazit janë të lidhura me marrjen e udhëtimit profesion dhe jo me udhëtimet e shumta, si dhe me mosqëndrimin në një vend dhjetë ditë me radhë. Për këtë çështje flet qartë fjala e Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Udhëtimi është puna e tyre.”

Bazuar mbi këtë fjalë, i ngarkuari me nëpunësi e me punë, fal namazin të shkurtuar dhe prish agjërimin, si çdo njeri që nuk e ka udhëtimin profesion dhe nuk bën udhëtime të shumta.

Ai nuk sheh muret dhe nuk dëgjon ezanin

6- Kushti i gjashtë dhe i fundit është se udhëtarit nuk i lejohet ta falë namazin të shkurtuar dhe të prishë agjërimin vetëm nga fakti që ai vendosi të udhëtojë, ose nga fakti që ai doli nga shtëpia e tij, ose doli prej vendit të tij, por ai duhet të largohet prej vendit të vet në një largësi aq sa në vendin ku gjendet nuk e dëgjon më ezanin dhe nuk sheh muret e ndërtesave. Gjithashtu, kur kthehet, udhëtari hyn në dispozitën e banorit vendas, kur të arrijë në kufirin ku e dëgjon ezanin dhe sheh muret e ndërtesave të vendbanimit. Atëherë ai e ka detyrim ta falë të plotë namazin dhe të agjërojë, edhe pse akoma s’ka hyrë në vendin e vet, pa thënë që s’ka arritur akoma në shtëpinë e tij.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai e shkurton namazin, kur të mos shikojë shtëpitë.”

Gjithashtu Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur të nisesh për udhëtim, fale namazin të plotë, derisa e dëgjon ezanin aty

ku gjendesh dhe fale namazin të shkurtuar, kur të mos e dëgjosh më ezanin. Në njëjtën mënyrë vepro edhe kur të kthehesh nga udhëtimi."

Fukahatë

Pasi fukahatë ranë në marrëveshje të punojnë me këto dy transmetime dhe me kuptimet e këtyre transmetimeve, patën kundërshtime në mesin e tyre dhe zgjatën fjalën: "Nëse qëllimi me mosdëgjimin e ezanit dhe mosshikimin e mureve është që këta dy faktorë duhet të jenë së bashku, apo mjafton të vërtetohet vetëm njëri prej këtyre dy faktorëve, ose supozohet se njëri prej dy faktorëve ndodh në largësi më të largët se tjetri, si do të veprojmë? Të marrim atë që është më afër, apo atë që është më larg, apo të veprojmë me rezervë? Duke supozuar se do të marrim vetëm njërin faktor me përzgjedhjen tonë, pa u referuar nga gjendja në të cilën anon më shumë secili nga dy faktorët, ose supozojmë se nuk shikojmë nga cila anë rëndon më shumë balancimi, si do të veprojmë?"

Në lidhje me këto pyetje të shtruar, fukahatë kanë përmendur fjalë të shumta, si: dituria, profesioni, kushtëzimi i secilit prej dy faktorëve i thënë me të njëjtën fjalë edhe për faktorin tjetër. Por pas gjithë këtij diskutimi, nuk qëndron ndonjë dobi e madhe.

Ne besojmë se qëllimi i parë dhe i fundit është: Njeriu bëhet udhëtar vetëm atëherë kur largohet pak prej vendit të vet, në atë mënyrë që në këndvështrimin e njerëzve të thuhet se ai u nis për udhëtim, ashtu siç hyn udhëtari në dispozitën e banorit vendas, sapo t'i afrohet vendit të vet. Për këtë arsye i urojnë kthimin

shëndoshë e mirë, sapo ai i afrohet vendit të vet, edhe pse akoma nuk ka hyrë në të. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), largësinë e afërsisë, herë e ka shprehur me mosdëgjimin e ezanit, herë tjetër e ka shprehur me mosshikimin e mureve, duke toleruar një ndryshim të vogël. Atëherë faktori mosdëgjim i ezanit dhe faktori mosshikim i mureve të shtëpive janë dy argumente që tregojnë largësinë, por nuk janë prej shkaqeve të sanksionuara në ligjin e fesë. Prandaj mjafton të bazohemi edhe vetëm në njërin prej dy faktorëve, pasi kështu nuk mbetet jashtë as bashkimi mes dy faktorëve, prandaj nuk ka nevojë as të veprohet për rezervë e as për të qenë sa më i ruajtur.

Kur njeriu, në nisjen e udhëtimit dyshon, nëse ka arritur kufirin e lejimit, ai mbetet në rregullin që ta falë të plotë namazin, të agjërojë dhe ta falë namazin të shkurtuar dhe të mos e agjërojë në kthim, duke vepruar sipas rregullit të shoqërimit.

* * *

DISPOZITAT E NAMAZIT TË UDHËTARIT

Lidhja mes shkurtimit të namazit dhe prishjes së agjërimit

Në çdo rast që shkurtimi i namazit është detyrë e domosdoshme, në atë rast është detyrë e domosdoshme të prishet edhe agjërimi në Muajin e Ramazanit, si dhe kundërta.¹

Në lidhje më këtë, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Kur të shkurtosh namazin (namazin farz), prish edhe agjërimin dhe, kur të prishësh agjërimin, shkurto edhe namazin.”* Me një fjalë, kushtet për shkurtimin e namazit dhe për prishjen e agjërimit janë të njëjta.

¹ Me përjashtim të tri burimeve të mirësisë: E para, në katër vendet që janë: Shtëpia e shenjtë e Allahut, xhamia e të Dërguarit të Allahut, xhamia e Kufes dhe El-Hàiril-Husejnij.” Në këto katër vende, udhëtari ka të drejtë të përzgjedhë mes faljes së namazit të shkurtuar ose të plotë. Por ai ka detyrë ta prishë agjërimin. E dyta, kur udhëtari del prej shtëpisë së vet, pasi dielli ka kaluar zenitin, ai mbetet agjërueshëm dhe fal namaz të shkurtuar. E treta, kur udhëtari arrin në shtëpinë e vet, pasi dielli ka kaluar zenitin, ai fal namazin të plotë dhe prish agjërimin.

Ashtu siç nuk lejohet agjërimi në Muajin e Ramazanit gjatë udhëtimit, po ashtu nuk lejohet kryerja e agjëritimit kaza në këtë muaj.

Me lejen e Allahut të Lartësuar, për këtë çështje do të jepen shpjegime të hollësishme në kapitullin: “Agjërimi”.

Katër vendet

Udhëtari ka të drejtën e përzgjedhjes për faljen e namazit të shkurtuar apo të plotë, megjithëse falja e plotë e namazit është më e mirë në katër vende: në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut të Lartësuar (xhamia e Qabes), në xhaminë e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në xhaminë e Kufes, ku është vrrarë Prijësi i besimtarëve, Imami Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe në El Hàirul Husejnij, vendin e lartësuar të sigurisë.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Prej depozitave të diturisë së Allahut është falja e plotë e namazit në katër vende: në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut, në xhaminë e të Dërguarit të Allahut, në xhaminë e Prijësit të besimtarëve dhe në mezarin e Hysejn bin Aliut.”

Në këtë kuptim, transmetimet e kanë tejkaluar kufirin e përcjelljes pa shkëputje brez pas brezi (*had’du t’tevàtur*).

Nuk është larg mendjes të kuptohet se urtësia e përmbajtjes së këtij transmetimi, konsiston në faktin se këto qendra të shenjta janë vende të shpirtit e të zemrës së njeriut, veçanërisht shpirtit e zemrës së besimtarit të përkushtuar.

Falja e plotë e namazit, kur duhet të falet i shkurtuar

Kush e fal namazin të plotë, duke ditur se kushtet për të falur namaz të shkurtuar janë të bollshme, namazi që ai fali është pa vlerë, prandaj ai ka detyrim ta falë atë namaz përsëri, kur është brenda kohës. E fal atë namaz kaza, kur është jashtë kohës, sepse ai bëri një veprim për të cilin nuk është urdhëruar.

Kush e fal namazin të plotë, ngaqë nuk e di dispozitën e ligjit të fesë se udhëtari ka detyrë ta falë namazin të shkurtuar, namazi që ai fali është i vlefshëm dhe në mënyrë absolute, ai nuk e përsërit namazin, as brenda kohës e as nuk e fal atë namaz kaza jashtë kohës. Ky rregull ka mbështetjen e të gjithë fukahave, ose mbështetjen e fukahave më të dëgjuar. Argumenti që ata kanë për këtë mbështetje është pyetja që i kanë bërë Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që agjëron gjatë udhëtimit. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “*Në qoftë se ai ka marrë njoftim që i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e ka ndaluar agjërimin në udhëtim, ai ka detyrim të agjërojë kaza. Por nëse ai nuk ka asnjë njoftim në lidhje me urdhrin për të mos agjëruar në udhëtim, mbi të nuk rëndon asnjë detyrim.*”

Në kuptimin e këtij transmetimi kanë ardhur edhe shumë transmetime të tjera, të cilat, edhe pse janë të posaçme për agjërimin, asnjëri prej fukahave nuk bën ndarjen mes agjëritit e namazit, ashtu siç pamë më sipër fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “*Kur prish agjërimin, shkurto namazin dhe kur shkurton namazin, prish agjërimin.*”

Ti mund të thuash: Si qenka e logjikshme kështu, kur thënia tjetër shpjegon se dispozitat e ligjit të fesë përfshijnë në

mënyrë të barabartë atë që di dhe atë që nuk di, kur dihet se ai që fal namaz dhe nuk di dispozitat e faljes së namazit, namazi i tij është prishur, madje namazi është i prishur, edhe kur ai nuk ka dituri se po fal namazin me mangësi.

Përgjigje:

Detyrimi i parë në udhëtim është shkurtimi i namazit. Nga transmetimet e mësipërme ne zbuluam se Ligjvënësi e ka rrëzuar këtë detyrim si mëshirë dhe lehtësim për atë që nuk di dhe për atë që e fal namazin të plotë në udhëtim. Gjithashtu, mësuam se Ai ka rrëzuar edhe detyrimin për të agjëruar kaza në udhëtim, kur nuk e di se në udhëtim nuk duhet të agjërohet, sepse kurrë e asnjëherë s'mund të ketë ndalim në dhënien e mirësisë e të mëshirës nga ana e Allahut. I ngjashëm me këtë shembull, është rasti kur ti, nga padituria, këndimin në namaz e bën pa zë, aty ku këndimi duhet të bëhet me zë, ose këndon me zë aty, ku duhet të këndohet pa zë, sepse me rënien e obligimit, vetvetiu bie edhe dënimi. Prandaj mos i kushto vëmendje asaj fjale që ka lëshuar ndonjë prej fukahave se dënohet edhe ai që nuk njeh dispozitën e ligjit të fesë, edhe nëse puna e tij është e saktë, sidomos duke ditur se hadithi për dënimin nuk hyn në specialitetin e fukahave, pasi detyra e fukahave është e reduktuar vetëm në fjalën rreth hallallit e haramit, të pastrit e të ndyrit, të vlefshmit e të prishurit.

Udhëtari që fal namazin të plotë nga harresa, por jo me qëllim dhe jo se nuk e di që namazi në udhëtim nuk falet i plotë dhe kujtohet para se të dalë koha për faljen e namazit, ai e përsërit këtë namaz. Në qoftë se koha ka kaluar, atëherë e fal kaza. Është

pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që harron dhe në udhëtim fal katër rekate. Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Nëse ai kujtohet gjatë kësaj dite, domethënë para se të dalë koha e faljes së namazit, le ta përsërisë namazin dhe, në qoftë se koha e faljes së namazit ka kaluar, ai nuk e përsërit namazin.”*

Udhëtimi pas daljes së kohës për faljen e namazit

Kur hyn koha për faljen e namazit dhe ai është në vendbanim, por pastaj udhëton dhe e vonon faljen e namazit, me qëllim që ta falë brenda kohës gjatë udhëtimit, a duhet ta falë këtë namaz me katër rekate, duke e konsideruar detyrim ashtu siç ishte për atë në kohën, kur ishte në vendbanim, pasi dihet se, nëse ai do ta kishte falur namazin në fillim të kohës, patjetër që namazin do ta falte të plotë, apo ai duhet ta falë këtë namaz të shkurtuar me dy rekate, duke vënë në konsideratë kohën kur ishte i detyruar që namazin ta falte të plotë. Ose, kur hyn koha, ai është udhëtar, por më pas bëhet në dispozitën e banorit vendas. A do ta falë ai këtë namaz të shkurtuar, duke vënë në konsideratë kohën sipas së cilës ai kishte detyrim, apo atë namaz do ta falë të plotë, duke vënë në konsideratë gjendjen e tij në të cilën po e fal këtë namaz?

Kundërshtimet mes fukahave për këto çështje kanë ardhur sipas ndryshueshmërisë së transmetimeve: Disa prej fukahave janë shprehur: Vihet në konsideratë gjendja e tij, kur ai kryen faljen e namazit. Të tjerë janë shprehur se vihet në konsideratë gjendja që ai kishte detyrim të falte namazin. Të tjerë kanë thënë se ai ka të drejtën e përzgjedhjes. Një i katërt ndan mes atij që ishte

në vendbanim dhe u bë udhëtar dhe mes atij që ishte udhëtar e u bë banor vendas.

Ne preferojmë të shprehemi se ai që fal namazin, le të vështrojë në gjendjen në të cilën është në kohën që fal namazin, pavarësisht nga gjendja që ishte më parë: Në qoftë se ai në kohën që fal namazin është udhëtar, ai e fal namazin të shkurtuar dhe, në qoftë se ai është në vendbanimin e tij, ai e fal namazin të plotë. Është e padiskutueshme që dispozitat ndjekin emërtimet, ekzistojnë ose jo.

Largimi i atij që ka bërë nijet të qëndrojë

Kur burri bën nijet të qëndrojë në një vend dhjetë ditë dhe pastaj largohet prej atij vendi pa udhëtuar as katër “ferseh” të plotë e kthehet në vendin e tij, me këtë veprim, a është prishur vendosmëria për të qëndruar në atë vend, pra, për atë nuk lejohet as të falë namazin të plotë e as të agjërojë, apo ai mbetet në gjendjen e banorit në vendbanim dhe duhet ta falë namazin të plotë e të agjërojë?

Fjalët e fukahave janë tepër të gërshetuara dhe nuk kanë sjellë asgjë që shpirti mund të gjejë prehje në lidhje me këto çështje, sepse të gjitha argumentet e tyre, ose ato më të pëlqyerat, janë vetëm miratim. Gjithsesi, më e mira ndër të gjitha thëniet është thënia që ka përmendur autori i librit “El Urvetul Uthkà”: “Nëse ai kthehet brenda kësaj dite dhe para se të arrijë në vendin e bujtjes, ai mbetet në gjendjen e vendbanimit, sepse zakonisht, në këtë gjendje, atij nuk i hiqet emri banor vendas.”

Është normale që dispozitat ndjekin emërtimet. Madje En Nàijnij, në shtojcat anësore të librit “El Urvetul Uthkà”, ka thënë: “Sipas thënies më të dallueshme, edhe sikur të ketë bërë nijet të qëndrojnë në vendin e bujtjes vetëm një natë.”

Heqja dorë nga vendqëndrimi

Kur burri bën nijet të qëndrojë në një vend dhjetë ditë dhe para se të falë një namaz të plotë, heq dorë prej nijetit të tij, ai ka detyrë ta falë namazin të shkurtuar dhe të mos e falë namazin të plotë. Nëse ai heq dorë prej nijetit të tij, pasi ka falur një namaz të plotë, ai mbetet në gjendjen, në të cilën ka detyrë ta falë namazin të plotë. Për këtë tregon edhe transmetimi i ardhur prej Ebu Viladit, i cili tregon: “I thashë Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Hyra në Medine me nijet që të qëndroj këtu dhjetë ditë, prandaj e fala namazin të plotë. Por pastaj më doli që nuk mund të qëndroja më këtu. Si mendon për mua, të fal namazin të plotë apo të shkurtuar?”

Ai tha: “Nëse, kur hyre në Medine fale një namaz farz të plotë, ti nuk ke detyrë që atë namaz ta falësh të shkurtuar, derisa të dalësh prej Medines, por, nëse ke hyrë në Medine me nijet për të qëndruar këtu dhe të doli se nuk do të qëndrosh, ti nuk kishe falur të plotë asnjë namaz farz. Në këtë gjendje, ti ke të drejtën e përzgjedhjes, nëse dëshiron bën nijet të qëndrosh dhjetë ditë dhe fale namazin të plotë. Gjithashtu, fale namazin të shkurtuar, që shtrihet ndërmjet teje dhe një muaji. Pastaj, kur të kalojë ky muaj, domethënë, duke shkuar e duke ardhur në Medine, pa bërë nijet për të qëndruar dhjetë ditë, atëherë fale namazin të plotë.”

NAMAZI I XHUMASË

Motivimi për të falur namazin e Xhumasë

Allahu i Lartësuar thotë:

”يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ ۚ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنتُمْ تَعْلَمُونَ“

“O ju që besuat, kur të bëhet thirrja për namaz ditën e Xhuma, nxitoni për aty ku përmendet Allahu dhe lini shit-blerjen, sepse, nëse do të dinit, kjo është shumë më e dobishme për ju.” (Sure “El Xhumuah” ajeti 9)

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kush e le namazin e Xhumasë tri herë radhazi, pa pasuar ndonjë pengesë, Allahu atij i ka vulosur (i ka mbyllur) zemrën.”

Zurara tregon: “Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) na nxiste aq shumë të falnim namazin e Xhumasë, sa unë kujtova se donte që të shkonim te ai, prandaj i thashë: “Që të hamë drekë te ti?” Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Jo, interesohem për ju.”

Mënyra e faljes së namazit të Xhumasë

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Namazi i Xhumasë falet me Imam dhe është dy rekate.*” Namazi i Xhumasë është bërë dy rekate për shkak të dy hytbeve, të cilat janë në namaz, derisa të zbresë Imami. Në vijim, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “*Imami që prin në faljen e namazit të Xhumasë vesh xhybe dhe vë çallmë, mbështetet mbi harkun ose mbi një bastun. Imami bën një ndenjie të vetme mes dy hytbeve dhe këndimi që bëhet para rukusë, në të dy rekatet, këndohet me zë të lartë.*”

Edhe Muham’med bin Muslim e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për namazin e Xhumasë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur: “*Falet me ezan dhe me ikamet. Pas këndimit të ezanit, Imami ngrihet dhe ngjitet mbi minber, ku këndon hytben.*” Gjatë kohës që Imami këndon hytben, njerëzit nuk falin namaz. Imami ulet në minber dhe qëndron ulur aq kohë sa duhet për të kënduar “*Kul huall’lilàhu ehad...*” Pastaj Imami ngrihet dhe fillon këndimin e hytbes së dytë, pastaj zbret dhe u prin njerëzve në faljen e namazit të Xhumasë. Në rekatën e parë, pas sures “*Fatiha*”, Imami këndon suren “*El Xhumuah*” dhe në rekatën e dytë, pas sures “*Fatiha*”, këndon suren “*El Munafikun*”.

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se namazi i Xhumasë është dy rekate dhe zëvendëson namazin e drekës. Është mustehab që në namazin e Xhumasë këndimi të bëhet me zë, në rekatën e parë, pas sures “*Fatiha*” të këndohet surja “*El Xhumuah*” dhe në rekatën e dytë, pas sures “*Fatiha*” të këndohet surja “*El Munafikun*”. Thuhet se

në namazin e Xhumasë është mustehab të bëhen dy kunue, një kunut në rektin e parë, pas këndimit dhe para rukusë, kurse në rektin e dytë kunuti bëhet pas rukusë.

Autori i librit “El Medarik” ka thënë se kjo fetva mbështet mbi një transmetim të gradës “Daijf”, por më pas ajo është cituar prej shehut Saduk, autorit të librit “Kush nuk ka arritur fakijhun”, që është njëri prej katër librave të njohur: “Ajo që përdoret e me të cilën jepet fetva dhe me të cilën kanë vazhduar shehët e mi (Allahu i mëshiroftë!) është transmetimi se kunuti, në të gjitha namazet, në namazin e Xhumasë e në namazet e tjera, është në rektin e dytë, pas këndimit dhe para rukusë.”

Më poshtë, autori i librit “El Medarik” ka thënë: “Shejkhul Mufijdi dhe një grup prej shokësh, fukah, kanë thënë: “Në namazin e Xhumasë ka vetëm një kunut në rektin e parë. Kjo thënie mbështet në njoftimet e shumta që flasin për këtë çështje.”

Ne jemi me Sadukun, i cili është mjaftuar të shprehet se është mustehab të bëhet vetëm një kunut në rektin e dytë, pas këndimit dhe para rukusë, ashtu siç bëhet kunuti në të gjitha namazet. Kjo është e njohur te ne prej rrugës së Vënës të ligjit të fesë. Në hadithin e saktë, i transmetuar prej Muavije bin Amarit, tregohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nuk di të ketë kunut veçse para rukusë.”

Në librin “Mustemsekul Urveh” të autorit Sijjidul Hakijm, vëllimi 4, faqe 387, botimi i parë, cituar prej librit “Es Seràir”, thuhet: “Ka vetëm një kunut dhe është kunuti sipas kërkesës së medh’hebit tonë e fjalës së përbashkët të fukahave tanë.”

Kushtet

Namazi i Xhumasë është detyrim me disa kushte:

Imami i pastër nga gabimet (el imàmul ma'sùm):

1- Namazi i xhumasë është *uaxhibu ajnij* në praninë e Imamit të pastër nga gabimet, ose me praninë e të emëruarit prej tij vetëm për të drejtuar faljen e namazit të xhumasë, ose edhe për të drejtuar faljen e namazeve të tjera.

El Mukad'des El Erdebilij në komentin e librit “El Irshàd” thotë: “Me rrugët e transmetimeve të shi’ave nuk ka argument që të tregojë për këtë kusht, përveç fjalës së përbashkët të fukahave. Por edhe fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, nëse lejohet apo nuk lejohet falja e namazit të Xhumasë në kohën e fshehjes së Imamit (*Paqja qoftë mbi të!*) të pastër nga gabimet, siç është koha jonë e tanishme. Një grup fukahash kanë thënë se lejohet, ndër të cilët edhe shehu Et’tusij, kurse të tjerë fukaha kanë thënë se nuk lejohet, ndër të cilët edhe Sherijf El Murteza.

Në të vërtetë, namazi i Xhumasë është sanksionuar në ligjin e fesë në gjendjen e mungesës së Imamit me përzgjedhje, domethënë: të mospërzgjedhjes për të falur namazin e Xhumasë, ose namazin e drekës. Transmetimi më në zë për këtë çështje është dëshmia që bën El-Alameh, në librin “Et Tedhkiroh”, sipas fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), në lidhje me namazin e Xhumasë: “Kur mbliidhen shtatë dhe nuk kanë frikë, ata i prijnë njëri-tjetrit në faljen e namazit (Xhumasë).” Në këtë thënie, shprehja “ata i

prijnë njëri-tjetrit”, nuk tregon se ai që prin në faljen e namazit të Xhumasë, është vënë prej Imamit të pastër nga gabimet.

Veç kësaj, nuk është cituar që ndonjë prej Imamëve të ketë caktuar Imam për njerëzit për të falur namazin e Xhumasë. Shejkh El Hamadanij thotë në librin “El Misbah”: “Në këtë çështje nuk duhet të bëhen komplikime, ashtu siç nuk duhet të kërkohen veshje, nëse namazi i Xhumasë shlyen faljen e namazit të drekës, kur ai është i lejuar.”

Unë që ndjek burimet e këtij kushti dhe fjalët e dijetarëve të fesë, pohoj se pjesa më e bukur që kam lexuar, është thënia që ka përmendur shehu i madh, autori i librit “El Xheuàhir”, i cili, duke trajtuar këtë çështje, ka thënë: “Disa shehë e kanë tepruar dhe e kanë shtrënguar shumë detyrimin kokë për kokë për faljen e namazit të Xhumasë në kohën e mungesës së Imamit të pastër nga gabimet, madje e kanë shtrënguar aq shumë, sa kanë bërë kujdesin më të madh që të mos falin namazin e drekës së bashku me namazin e Xhumasë, në një kohë kur për këtë teprim e këtë shtrëngim të tepruar nuk ka asnjë burim, përveç dëshirës së madhe për kryesi, pushtet e për nëpunësi që atij mund t’i jepeshin në vendet e axhemit (jo arabe). Kjo është puna këmbëngulëse e shumicës së atyre që shkojnë te banorët e atyre anëve.”

Thuhet se disa prej tyre shkonin shumë larg në lidhje me shenjtërimin e namazit të Xhumasë. Kur kjo çështje ishte në dorën e ndonjërit prej tyre, veçanërisht kur për të bëhej e qartë ndonjë fjalë, atëherë ai kalonte deri në ekstrem për bërjen detyrim të domosdoshëm faljen e namazit të Xhumasë. Sikur të mos kemi frikë se do të sillnim lodhje, do të citonim këtu fjalët e tyre në

lidhje me këto thënie. Por kjo do të sillte që të njiheshim me gjërat më të çuditshme që ka në thëniet e tyre.

Nuk e di se ç' do të shkruante autori i librit "El Xheuàhir", sikur të shikonte gjykatësit e ligjit të fesë në ditët e sotme, të cilët i kanë kthyer shpinën Librit të Allahut dhe Sunetit të Profetit të Tij, ashtu siç i kanë kthyer shpinën fjalës së përbashkët të fukahave, logjikës dhe turpit, pasi për fenë e për ligjin e fesë kanë marrë si analogji epshet e dëshirat e tyre, ashtu siç kanë zëvendësuar burimet e ligjit të fesë me mitmarrjen, me joshjen e zonjave nevojtare, me ndërhyrje e me ndërmjetësime te njerëzit autoritarë, bij të kësaj bote.

Falënderimi i takon vetëm Allahut, që më largoi nga një post i këtitllë dhe më nderoi me librin e me lapsin, që më orientoi kah studimi e gjurmimi, që të njihem me gjurmët e familjes së pastër të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të njihem me dijetarët e tyre të mirë, si për shembull, me autorin e librit "El Xheuahir" e të tjerë si ky.

Numri

2- Xhemati për faljen e namazit të xhumasë nuk mund të formohet me më pak se pesë vetë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "*Ditën e Xhuma njerëzit mblidhen kur janë pesë vetë e më shumë dhe, kur janë më pak se pesë vetë, ata nuk kanë detyrim ta falin namazin e Xhumasë.*"

Në disa transmetime thuhet shtatë vetë, kurse në një transmetim tjetër është përmendur shtatë, edhe pesë së bashku. Zurara tregon: “E pyeta Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) se kush e ka detyrim namazin e Xhumasë. Ai tha: “*Namazi i Xhumasë bëhet detyrim, kur janë shtatë myslimanë. Nuk ka namaz Xhumaje me më pak se pesë vetë, njëri prej të cilëve është Imami.*”

Shumë prej fukahave kanë një mendim të përbashkët në lidhje me transmetimin për shtatë vetë dhe për transmetimin për pesë vetë. Ata kanë thënë se transmetimi për shtatë vetë, është kusht për detyrimin kokë për kokë, me praninë e Imamit të pastër prej gabimeve, kurse pesë vetë tregon detyrimin me përzgjedhje, mes faljes së namazit të Xhumasë, ose të namazit të drekës, në kohën e mungesës së Imamit të pastër nga gabimet. Ky grup i madh fushash, në lidhje me bashkimin mes dy transmetimeve, në lidhje me numrin, është mbështetur mbi transmetimin e mësipërm të Zurares, që bashkonte dy numrat. Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: “*Kur mblidhen pesë vetë, njëri prej tyre është Imam dhe ata kanë detyrim të formojnë xhematin.*”

Është e qartë se fraza “ata kanë detyrim” tregon se për faljen e namazit të Xhumasë nuk është domosdoshmëri prania e Imamit të pastër nga gabimet, ose e të emëruarit të veçantë prej tij për faljen e namazit të xhumasë.

Dy hytбет

3- Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Imami i Xhumasë këndon hytben, duke qëndruar në këmbë, falënderon Allahun, (thotë “Elhamdu lil’lâh”) dhe e lavdëron Atë (thotë “Subhànall’lâh).*

Pastaj porosit për frikë e devotshmëri ndaj Allahut, këndon një sure të shkurtër prej Kur'anit, pastaj ulet, ngrihet në këmbë dhe përsëri falënderon Allahun, (thotë "Elhamdu lil'làh") dhe e lavdëron Atë, thotë (Subhànall'llàh), këndon salavat për Profetin Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe për Imamët e myslimanëve. I lutet Allahut të falë mëkatet e myslimanëve e të myslimaneve dhe, pasi të mbarojë këto, muezini këndon ikametin. Imami fal me njerëzit dy rekate namaz. Në rekatin e parë, pas sures "Fatiha" këndon suren "El Xhmuah" dhe në rekatin e dytë, pas sures "Fatiha" këndon suren "El Munafukun".

Fukahatë

Fukahatë i kanë numëruar dy hytbet prej kushteve të namazit të Xhumasë, duke i vënë ato në dispozitën e namazit të Xhumasë dhe mënyrës së faljes së këtij namazi. Për këtë arsye, shejkh El Hamdanij, për tolerancë, i ka numëruar dy hytbet prej kushteve. Sido që të jetë, koha e këndimit të dy hytbeve është pasi dielli ka kapërcyer zenitin dhe jo para kësaj kohe. Është detyrë që dy hytbet të këndohen para faljes së namazit të Xhumasë dhe patjetër secila nga dy hytbet duhet të përmbajë fjalët: "El hamdu lil'làh", "Subhànall'llàh", salavat për Profetin e për familjen e tij, këndimin e një sureje të shkurtër, ose të një ajeti të plotë, që ka një kuptim të pavarur. Është detyrë e Imamit që hytben ta këndoje në këmbë dhe të ndajë dy hytbet me një qëndrim të shkurtër ulur.

Është veprim i pëlqyer (*mustehab*) që Imami të jetë elokuent në fjalë, të dijë kohët e faljes së namazeve farz, të mbajë çallmë, verë e dimër dhe të veshë një xhybe të veçantë (në tekst xhybe Jemeni).

Xhemati

4- Për faljen e namazit të Xhumasë xhemati është kërkesë e domosdoshme, pasi me fjalën e përbashkët të gjithë myslimanëve, namazi i Xhumasë i falur vetëm nuk është i vlefshëm.

Uniteti

5- Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Kur largësia midis dy xhemateve është tri milje, nuk ka asnjë problem që secili xhemat të falë namazin e Xhumasë.”*

Bazuar mbi këtë transmetim e mbi transmetime të tjera, fukahatë kanë thënë: *“Kur formohen dy xhemate dhe ndërmjet dy xhemateve ka së paku një “ferseh” largësi, namazi që ata falin, është i vlefshëm.”*

Më sipër kemi shpjeguar se një *“ferseh”* është i barabartë afërsish me gjashtë kilometra. Kur ndërmjet dy xhemateve ka më pak se një *“ferseh”*, namazi i të dy xhemateve është prishur, përveçse kur dimë se njëri prej dy xhemateve e ka parakaluar tjetrin, qoftë edhe me tekbinin e fillimit.

Koha

6- Namazi i xhumasë është detyrë të falet në fillim të kohës, kur dielli fillon animin në kupën e qiellit, derisa hija e një sendi të bëhet sa vetë sendi. Pas kësaj kohe, namazi i Xhumasë nuk lejohet të falet, por detyrimisht duhet të falet namazi i drekës.

I obliguari për faljen e namazit të Xhumasë

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Allahu i Lartësuar ka bërë farz që njerëzit, nga xhumaja në xhuma, të falin 35 namaze, por vetëm njërin prej këtyre namazeve Ai e ka bërë detyrim të falet me xhemat dhe ky është namazi i Xhumasë.” Allahu i Lartësuar nuk e ka bërë obligim namazin e Xhumasë për të voglin, të moshuarin e të drobiturin, të çmendurin, udhëtarin, robin, gruan, të sëmurin, të verbrin dhe ai që është larg dy “ferseh” nga vendi ku falet namazi i Xhumasë.”

Në transmetimet e Ehli Bejtit, nga ato transmetime që më kanë rënë në dorë, nuk përmendet çalamani. Por fukahatë e kanë përmendur edhe çalamanin. Gjithashtu, fukahatë kanë rënë në konsensus që të punojnë me këtë transmetim, që flet për ata që nuk e kanë detyrim faljen e namazit të Xhumasë, si i sëmuri, çalamani, i verbëri, i moshuari i drobituri, gruaja e udhëtari. Por nëse këta e falin namazin e Xhumasë, namazi i tyre është i vlefshëm dhe prej tyre bie detyrimi për të falur namazin e drekës. Me këtë kategori njerëzish, që nuk e kanë obligim të falin namazin e Xhumasë, nuk mund të formohet xhemati me numrin e kërkuar, pasi numri duhet të realizohet pa çalamanin, pa të verbrin, pa gruan dhe pa robin.

Namazi i Xhumasë humbet, kur ikën koha për faljen e namazit të Xhumasë, bie edhe detyrimi për faljen e këtij namazi. Gjithashtu, namazin e Xhumasë nuk e fal kaza ai që e ka obligim.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kush nuk fal namazin e Xhumasë me xhemat e me Imam, ai nuk ka detyrim ta falë këtë namaz dhe as nuk ka detyrim që ta falë kaza.”

* * *

NAMAZI I FITËR BAJRAMIT

DHE I KURBAN BAJRAMIT

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Namazi i dy bajrameve është farz. Farz është edhe namazi për eklipsin e diellit. Gjithashtu, ai ka thënë: “Në dy bajramet nuk ka namaz pa Imam.” Nëse ti fal namazet ditore vetëm, nuk ka ndonjë problem (në lidhje me vlefshmërinë e namazit).”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për namazin e Fitër Bajramit dhe të Kurban Bajramit. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nuk ka namaz pa Imam.”

Fukahatë

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se namazi i dy Bajrameve, i Fitër Bajramit dhe i Kurban Bajramit, është detyrim me praninë e Imamit të pastër nga gabimet, ose të zëvendësit të tij të posaçëm. Shumica e fukahave janë shprehur se në kohën e mungesës së Imamit të pastër nga gabimet, është veprim i pëlqyer që namazet e dy bajrameve të falen me xhemat, ose edhe vetëm.

Kushtet e marra në konsideratë në namazet e dy bajrameve, janë të njëjta me kushtet e namazit të Xhumasë, përveç kohës së faljes, e cila fillon me lindjen e diellit, deri kur dielli kapërcen zenitin. Ai që e humb namazin e Bajramit, nuk e ka detyrë që këtë namaz ta falë kaza dhe është e barabartë, qoftë kur e ka lënë atë me qëllim, qoftë kur e harron.

Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai që nuk ka falur namaz me Imamin, ai s’ka detyrë ta falë atë namaz dhe as të falë atë kaza.”

Të gjithë fukahatë kanë rënë në një fjalë të përbashkët se qëllimi me këtë namaz, nuk janë namazet e përditshme, por është namazi i dy bajrameve. Siç shihet, nuk kemi kontradiktë as në realitet e as në dukjen e jashtme mes këtij transmetimi dhe transmetimit që thotë: “Ai që humb një namaz farz, le ta falë atë ashtu siç e humbi.”

Falja e namazit kaza është e posaçme vetëm për namazet e përditshme, kurse namazi që ai humbi, nuk ishte prej namazeve të përditshme, pasi me ndryshimin e subjektit, zhduket edhe kontradikta.

Mënyra e faljes së namazit të dy Bajrameve

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në namazin e dy bajrameve s’ka as ezan e as ikamet, por vetëm thirret tri herë: “Namazi!”

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), në lidhje me namazin e dy bajrameve ka thënë: “Këndon vetëm një tekbir për fillimin e namazit, pastaj këndon suren “Fatiha” dhe një sure tjetër. Pastaj këndon pesë

tekbire (thuhet pesë herë "All'Ilàhu Ekber". Qëndron pak duke u lutur në mes tekbireve, pastaj këndon vetëm një tekbir, pas të cilit kalon në ruku. Pastaj ngrihet të falë rekatin e dytë, në të cilin, ashtu si në rekatin e parë, këndon suren "Fatiha" dhe një sure tjetër. Në rekatin e parë këndon suren "El Ala" (seb'bihisme rab'bikel a'là) dhe në rekatin e dytë këndon suren "Shems" (ushe'shemsu ue duhàhà). Në rekatin e dytë këndon katër tekbire, duke qëndruar pak për lutje në mes tekbireve. Me tekbirin e pestë kalon në ruku."

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Hytbeja e namazit të Bajramit këndohet pas faljes së namazit." Pasi Imami këndon hytben e Bajramit, ulet pak ndërmjet dy hytbeve.

Fukahatë

Namazi i Bajramit s'ka as ezan e as ikamet, por një njeri thërret: "Namazi!", duke e përsëritur këtë fjalë tri herë. Namazi i Bajramit ka dy rekate. Në rekatin e parë këndohet surja "Fatiha" dhe një sure prej Kur'anit. Është mustehab të përzgjidhet sure "El Alà" (seb'bihisme rab'bikelaëlà). Pastaj Imami këndon tekbirin (All'Ilàhu Ekber) dhe lutet me njërën prej lutjeve. Është e pëlqyeshme të këndoje lutjen që këndohet gjithmonë dhe të thotë: "O Zoti im, Zot i madhështisë e madhërisë, Zot i bujarisë edhe i ngadhënjimit, Zoti i faljes e i mëshirës, Zoti i devotshmërisë e i faljes së mëkateve, vetëm Ty të lutem për madhështinë e kësaj dite, të cilën Ti e bërë festë për myslimanët dhe për Muhamedin (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e bërë ndihmë, nderim, respekt dhe shtim, të lutem të dhurosh paqe e shpëtim për Muhamedin e për familjen e tij. Të më fusësh mua në çdo të mirë në të cilën ke futur Muhamedin e familjen e Muhamedit dhe të më nxjerrësh prej çdo të keqeje nga e cila ke

nxjerrë Muhamedin e familjen e Muhamedit (*Paqja e bekimi Yt goftë mbi të e për ta!*).

O Zoti im, të lutem me fjalët më të mira me të cilat të janë lutur robtë e Tu të mirë. Kërkoj mbrojtjen Tënde prej atyre gjërave që të kanë kërkuar mbrojtje Ty robtë e Tu të singertë!)

(All'Ilàhum'me Ehlul kibrijài uel adhameti, ue ehlulxhùdi uel xheberùti, ue ehlul afui uerr'rrahmeti, ue ehlu tekuà uel magfireti; Es'eluke bihak'ki hàdhal jeumi el ledhij xhealtehù lil muslimijne ijden, ue li Muham'medin sal'lall'Ilàhu alejhi ue àlihi dhukhren ue sherefen ue keràmeten ue mezijden, en tusal'li alà Muham'medin ue àli Muham'med, ue en tudkhilenij fi kul'li khajrin edkhalte fijhi Muham'meden ue àle Muham'medin, ue en tukhrixhenij min kul'li sùin ekhrexhte minhu Muham'meden ue àle Muham'medin salevátuke alejhi ue alejhim; All'Ilàhum'me in'nij es'eluke khajre mà seeleke bihi ibàduke sàlihùne, ue eùdhu bike mim'mà isteàdhe minhu ibàdukel mukhlesùn).

Pastaj thotë pesë herë “All'Ilàhu Ekber”, domethënë bën pesë kunute të njëpasnjëshme, duke ndarë njërin kunut prej tjetrit vetëm me aq kohë sa këndohet një tekbir. Pastaj thotë “All'Ilàhu Ekber” dhe bie në ruku, bën edhe dy sexhdet, pastaj ngrihet, këndon suren “Fatiha” dhe një sure tjetër. Është mirë të këndohet surja “Esh'shems”. Pastaj thotë katër herë “All'Ilàhu Ekber”, duke bërë ndarjen për lutjen e shkurtër mes çdo tekbiri, pastaj këndon tekbir dhe kalon në ruku, pastaj bën dy sexhdet, pastaj këndon tesheh'hudin dhe jep selam. Dy hytbet e namazit të Bajramit këndohen pas faljes së namazit, pra, është e kundërta e dy hytbeve të namazit të Xhumasë, të cilat, ashtu siç u tha më sipër, këndohen para namazit të Xhumasë dhe jo pas tij.

NAMAZI ME RASTIN E NDODHIVE

KOZMIKE (salàtul-àjàt)

Qëllimi me fjalën “àjàt” (shumës) dhe “àjet” (njëjës) të tekstit, është për falje namazi, kur ndodh eklipsi i diellit, eklipsi i hënës, ose kur ndodhin tërmete dhe çdo ndodhi qiellore frikësuese, si për shembull furtunë dhe errësirë e befasishme në mesin e ditës. Këto katër ndodhi, në mënyrë absolute, e bëjnë detyrim faljen e namazit në praninë e Imamit të pastër nga gabimet. Në mungesë të tij, ky namaz falet sipas një mënyrë të përcaktuar dhe me dispozita të veçanta.

Argumenti që e bën detyrim

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Namazi për eklipsin e diellit është detyrim.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) se ç’është tërmeti? Ai është përgjigjur: “Është àjet.” Pyetësi i tha: “Kur ndodh tërmeti, ç’të bëj?” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Edhe për tërmetin fal namaz si namazi që falet për eklipsin e diellit.”

Imam Ebu Xhaferi (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Të gjitha ndodhitë frikësuese të qiellit, si errësirë, furtunë dhe elemente të tjera tmerruese, për të gjitha këto ndodhi, fal namaz si namazi që fal për eklipsin e diellit.”

Imam Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*), djali i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur vdiq Ibrahim, djali i të Dërguarit më të madh (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndodhi eklipsi i diellit dhe njerëzit thanë: “Edhe dielli u eklipsua për humbjen e djalit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). I Dërguari i Allahut hipi mbi minber, falënderoi Allahun, tha “Elhamdu lil’lâl” dhe e lavdëroi Atë, tha “Subhànall’lâh” dhe pastaj tha: “O njerëz, dielli e hëna janë dy argumente (àjete) prej argumenteve të Allahut që lëvizin me urdhrin e Tij. Të dy janë të nënshtruar ndaj Allahut. Eklipsi i tyre nuk ndodh as për vdekjen e ndonjërit e as për ardhjen në jetë të dikujt. Por kur të ndodhë eklipsi i diellit e i hënës së bashku, ose vetëm i diellit, ose vetëm i hënës, ju menjëherë falni namaz.” Pastaj zbriti prej minberit dhe u priu njerëzve në faljen e namazit që falet në rastet e eklipsit të diellit.

Të gjithë fukahatë kanë rënë në një fjalë të përbashkët për të punuar me këtë transmetim dhe me transmetime të tjera të ngjashme.

Koha

Koha për faljen e namazit me rastin e eklipsit të diellit dhe të eklipsit të hënës është e përkohshme dhe kalon me kalimin e

eklipsit. Kufiri i kësaj kohe është me fillimin e eklipsit, derisa të dalë plotësisht disku i diellit ose i hënës. Bazuar mbi këtë dukuri, lejohet të fillohet falja e namazit të eklipsit me fillimin e vetë eklipsit. Koha fillon e ngushtohet sa më shumë vjen duke u bërë i dukshëm disku i diellit ose i hënës. Argumenti për këtë fetva tregon se koha për faljen e këtij namazi fillon me fillimin e eklipsit, është fjala e të Dërguarit më të madh (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Kur ju të shihni këtë, menjëherë falni namaz.”

Argument për vijimin e kohës deri në dukjen e plotë të diskut, shërben fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur fal namaz me rastin e eklipsit, vazhdoje namazin derisa të hiqet eklipsi prej diellit e prej hënës dhe zgjate namazin, sepse kjo është më e preferuar. Por nëse dëshiron, edhe mund ta lësh namazin para se të kalojë plotësisht eklipsi, pasi edhe kështu lejohet.”

Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Para se të kalojë eklipsi”, do të thotë: Të plotësohet dukja e plotë e diskut të diellit, ose e diskut të hënës.

Kur ka mbetur pa u zbardhur vetëm një pjesë fare e vogël prej diskut, në atë mënyrë që koha nuk mjafton as për veprimin më të vogël brenda së cilës mund të plotësohen kushtet për faljen e namazit të eklipsit, obligimi për faljen e këtij namazi bie që nga baza, sepse në këtë gjendje është e pamundur për të qenë në rregull me kushtet e për të punuar me to.

Në qoftë se koha është e mjaftueshme për të falur namazin e eklipsit dhe ai nuk e fal këtë namaz, a mbetet apo nuk mbetet detyrim për atë që këtë namaz ta falë kaza?

Përgjigje:

Ai shikon: Në qoftë se disku është zbardhur plotësisht, në mënyrë absolute, ai ka detyrë që namazin e eklipsit ta falë kaza dhe është e barabartë qoftë kur e di këtë, qoftë kur e ka lënë me qëllim, ose nuk e ka ditur, por e ka mësuar pas një kohe. Në qoftë se disku nuk është zbardhur plotësisht, mbetet detyra për të falur kaza namazin e eklipsit për atë që e di dhe e le me qëllim, ose harron, por nuk është detyrim për atë që nuk e di, derisa të dalë koha e faljes së këtij namazi bashkë me mbarimin e eklipsit.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur ndodh eklipsi i hënës dhe ti nuk e di që ka ndodhur eklipsi deri në mëngjes, nëse hëna është zbardhur e gjitha, mbetet detyrë që këtë namaz ta falësh kaza. Por nëse hëna nuk është zbardhur plotësisht, ti nuk ke detyrë ta falësh namazin për këtë eklips.”

Me këtë transmetim të sqaruar ne arrijmë bashkimin mes transmetimeve që e kanë saktësuar në mënyrë absolute faljen kaza të namazit me rastin e eklipsit dhe të transmetimeve që e mohojnë në mënyrë absolute faljen kaza të namazit të eklipsit.

Për sa i përket faljes së namazit për tërmetin, në tekste nuk përmendet kohë e caktuar. Gjithçka që tregojnë tekstet, është fakti se, sapo të fillojë tërmeti, bëhet detyrë edhe falja e namazit. Bazuar mbi këtë sentencë, në çdo kohë që njeriu e fal namazin për tërmetin, e fal me njetin se po e fal brenda kohës dhe jo me njet se po fal namaz kaza.

Mënyra e faljes

Imam Bakiri dhe djali i tij, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), kanë thënë: “Namazi me rastin e eklipsit të diellit e të hënës, si dhe me rastin e dridhjeve të tokës e të tërmetit, është dy rekate me dhjetë ruku dhe katër sexhde. Në rukunë e pestë bie në sexhde, pastaj ngrihesh dhe bën edhe pesë ruku të tjera. Pas rukusë së pestë bie në sexhde. Nëse dëshiron, në çdo rekat këndo një sure, ose, nëse dëshiron, këndo një gjysmë sureje për çdo rekat. Kur këndon një sure, këndo suren “Fatiha” dhe, nëse këndon një gjysmë sureje, e shlyen detyrimin për këndimin e sures “Fatiha” dhe e këndon suren “Fatiha” vetëm në rekatën e parë, derisa të fillosh rekatën tjetër. Gjatë rukuve, mos thuaj “Semiall’lâhu limen hamideh!” - “Allahu e dëgjon atë që e falënderon!”, kur të ngresh kokën prej rukusë, por thuaje frazën “Semiall’lâhu limen hamideh” vetëm pas rukusë në të cilën do të kalosh në sexhde.

Fukahatë

Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët për të punuar me këtë transmetim. Në komentimin e këtij transmetimi e në komentimet e transmetimeve të tjera kanë thënë: “Kur do të falësh namazin me rastin e eklipsit të diellit ose të eklipsit të hënës, ose të tërmetit, bëj nijetin dhe këndo tekbirin e fillimit, pastaj këndo suren “Fatiha” dhe një sure tjetër, pastaj bjer në ruku, ngrije kokën, fillo këndimin e sures “Fatiha” dhe të një sureje, pastaj bjer në ruku. Vazhdo kështu derisa të plotësohen pesë ruku. Pas rukusë së pestë bëj dy sexhde, pastaj ngrehu të falësh rekatën e dytë, këndo suren “Fatiha” dhe suren tjetër. Vazhdo kështu si në rekatën e parë,

derisa të plotësosh dhjetë ruku. Para se të biesh në ruku, thuaj “All’llàhu Ekber!”, pra, pas rukusë së dhjetë, bëj dy sexhdet, pastaj këndo tesheh’hudin dhe jep salam.”

Është *mustehab* të thuash: “Semiall’llàhu limen hamideh” kur ngrihesh nga rukuja dhe fillon përkuljen për të rënë në sexhde.

Fukhatë kanë thënë: “Lejohet që një sure të vetme ta ndash në pesë rekatet e para. Kur je në këmbë, në rekatën e parë këndon suren “Fatiha” dhe pas saj këndo një ajet të sures, pastaj bie në ruku, pastaj ngre kokën dhe këndon ajetin e dytë të kësaj sureje dhe bie në ruku, pastaj ngre kokën dhe këndon ajetin e tretë të sures. Vazhdo kështu deri në të pestin, me kusht që surja të plotësohet në rekatën e parë, që përmban pesë ruku. Pastaj, pas dy sexhdeve, ngrihesh në këmbë për të falur rekatën e dytë dhe vepro ashtu siç veproje në rekatën e parë, duke kënduar suren “Fatiha” vetëm një herë në fillimin e çdo rekati, si dhe suren vetëm një herë, të shpërndarë në të pesë rukutë.

Namazi i eklipsit lejohet të falet me xhemat dhe vetëm. Në këtë namaz Imami nuk mban asnjë përgjegjësi për xhematin, përveç përgjegjësisë së këndimit, plotësisht ashtu si në namazet e përditshme.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) për namazin e eklipsit të diellit, nëse falet me xhemat apo falet vetëm. Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) është përgjigjur: “Cilën të duash nga këto të dyja.”

Çështje

1- Kur eklipsi i diellit ndodh në kohën, kur nuk e ke falur akoma namazin farz të radhës, atëherë do të shikosh: Në qoftë se ka kohë për të falur të dy namazet, fillo më parë me cilin namaz të duash, por, nëse koha për faljen e namazit farz është e ngushtë, atëherë fal më parë namazin farz para namazit të eklipsit, sipas fjalës së Imam Bakirit e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur ndodh eklipsi i diellit, ose eklipsi i hënës, atëherë fal namazin e eklipsit, derisa nuk ke frikë se kalon koha për faljen e namazit farz dhe, nëse ke frikë, atëherë menjëherë fillo faljen e namazit farz.”

Sikur të supozohet: Koha është e ngushtë dhe ai e kundërshton këtë rregull dhe fal namazin e eklipsit, duke lënë namazin farz. A është i vlefshëm apo jo namazi që ai fali?

Përgjigje:

1- Është i vlefshëm, sepse urdhri për një send, nuk nënkupton ndalimin për të kundërtën e atij sendi, por ai është mëkatar për shkak të kundërshtimit të urdhrit.

2- Eklipsi i diellit dhe eklipsi i hënës vërtetohet me dituri, me ndijim, me dëshminë e dy dëshmitarëve të drejtë dhe me fjalën e specialistëve, me kusht që me fjalën e tyre të arrihet siguria dhe besueshmëria.

Dikush ka thënë se nuk lejohet mbështetja në fjalën e tyre, sepse ata njoftojnë për eklipsin e diellit, eklipsin e hënës dhe për daljen e hënës së re me hamendje e me intuitë dhe jo nëpërmjet shikimit të drejtpërdrejtë e të vrojtimit.

Në përgjigje të fjalës së këtij pyetësi, ne themi: Ata vëzhgojnë dhe shikojnë shkakun e plotë të eklipsit të diellit, të eklipsit të hënës dhe daljes së hënës së re, prandaj rezulton që dituria, me shkakun e plotë, është dituri me shkak, në të kundërt, fjala e tyre është me ndijim dhe jo me hamendje.

3- Ky namaz nuk është detyrim për gruan me menstruacione, për gruan gjatë periudhës së hemorragjisë së lehonisë. Është më e pëlqyeshme të mos falet kaza, sepse është degë që duhet kryer brenda kohës së vet.

* * *

PËRMBAJTJA 2

NAMAZI.....	5
Namazet farz dhe namazet nafile.....	5
Kuptimi i namazit:.....	5
Mohuesi i namazit dhe lënësi i namazit:.....	7
Namazet farz:	8
Namazet e vullnetshme (nevàfil) të namazeve të përditshme:.....	9
Kohët e faljes së namazeve.....	11
Koha për faljen e namazit të drekës dhe të namazit të mbasdites.....	14
Fukahatë:.....	14
Koha për faljen e namazit të mbrëmjes dhe namazit të darkës (El-ishàejn):.....	16
Fukahatë:.....	17
Koha për faljen e namazit të mengjesit:	18
Fukahatë:.....	19
Kohët e nafileve të namaze ditore:.....	19
Çeshtje:.....	21
KIBLEJA.....	24
Fukahatë:	25
Rruga e njohjes së dejtimit të Kibles:.....	27
Fukahatë:.....	28
Çeshtje:.....	31
VESHJA E ATIJ QË FAL NAMAZIT.....	36

Rroba e tejdukshme:.....	36
Lëkura e ngordhësirës:.....	36
Veshja prej kafshëve që nuk i hahet mishi:.....	37
Mëndafshi:.....	37
Floriri:.....	38
Gruaja, fytyra dhe dy shputat e duarve:.....	38
Sendi i rrëmbyer:.....	39
Fukahatë:.....	39
Cilësitë e veshjes:.....	42
Çeshtje:.....	47
VENDI KU NJERIU FAL NAMAZIN.....	51
Fukahatë:.....	51
Vendi ku vihet balli për të bërë sexhde:.....	55
Fukahatë:.....	56
Çeshtje:.....	56
EZÀNË DHE IKÀMETI.....	60
Filozofia e Ezànit:.....	60
Ligjërimi i Ezànit:.....	61
Mënyra e këndimit të Ezànit:.....	62
Mënyra e këndimit të Ikàmetit:.....	64
Kushtet e Ezànit e të Ikmetit:.....	67
PUNËT E NAMAZIT.....	68
Kushti i detyrimit dhe kushti i qenësishëm:.....	68
Nijeti:.....	71
Fukahatë:.....	71
Çeshtje:.....	73
Tekbijri i fillimit (tekbijretul-Ihràmi):.....	74
Fukahatë:.....	75
Qëndrimi më këmbë (Elkijàmu):.....	76
Fukahatë:.....	77

Këndimi:	80
Fukahatë:	81
Rukuja:	83
Fukahatë:	85
Sexhdeja:	86
Fukahatë:	88
Farzet (el-erkàn):	89
Tesheh' hudi:	90
Fukahatë:	91
Selàmi:	91
Fukahatë:	91
Sistemimi dhe vijueshmëria:	93
Prej veprime mustehab të namazit:	93
PRISHËSIT E NAMAZIT	95
Prishësit e namazit janë:	95
Rezume:	101
HARRESA	102
Namazi është veprim pas veprimi:	102
Ku është argumenti i veçantë?	103
Harrimi i farzeve:	106
Harresa në veprimet jo farze:	107
Mënyra e bërjes së sexhdes së harrimit:	111
Rezume:	112
Çeshtje:	113
DYSHIMI	116
Dyshimi në origjinën e namazit:	116
Dyshimi pas përfundimit të namazit:	117
Dyshimi në kushtet e namazit:	117
Dyshimi në punët e namazit:	118
Fukahatë:	119

Dyshimi në numërin e rekatëve:.....	121
Dyshimi i saktë:.....	123
Dyshimi në namazet nafile:.....	126
Dyshimi i shumtë:.....	127
Mënyra e faljes së namazit rezervë:.....	127
Çeshtje:.....	128
FALJA E NAMAZIT KAZA.....	130
Parathënie:.....	130
Falja e namazit kaza është detyrim:.....	134
Fukahatë:.....	134
Falja e namazeve kaza sipas rradhës:.....	140
Fukahatë:.....	140
Namazi i falur për të vdekurin:	142
Dhurimi i shpërblimit:.....	142
Falja e namazit kaza për të vdekurin:	143
Djali më i madh kyen adhurim kaza për dy prindërit e vet:.....	145
Fukahatë:.....	145
Çeshtje:.....	146
FALJA E NAMAZIT ME XHEMAT.....	149
Mirësia e xhematit:.....	149
Fukahatë:.....	150
Kushtet e xhematit:.....	151
Numri:.....	151
Qëllimi për të falur namazin me imam:.....	151
Imami:.....	151
Ndarësja:	154
Lartësia:	155
Dalja para imamit:.....	156
Largësia:.....	157
DISPOZITAT E XHEMATIT.....	158

Kur ai e gjenë imamin në ruku:.....	158
Fukahatë:.....	158
Këndimi sëbashku me imamin:	160
Fukahatë:.....	160
Ndjekja e imamit në veprime e në fjalë:.....	162
Fukahatë:.....	163
Sikur ai të ngrejë kokën para imamit:.....	165
Imami i ndyrë:.....	166
Fukahatë:.....	167
As hulumtues e as imitues:.....	167
Kur ai ka frikë se i humb rekati:.....	169
Ndërprerja e namazit:.....	169
Fukahatë:.....	170
Sikur imami të jetë para tij në veprime:.....	170
Fukahatë:.....	172
Kush ka prioritetin të prijë imam:.....	173
Fukahatë:.....	174
Dyshuesi kthehet te ai që mban mend:.....	174
NAMAZI I UDHTARIT.....	176
Shkurtimi namazit:.....	176
Fukahatë:.....	176
Rrëzimi i namazit nafilë:.....	178
Fukahatë:.....	179
Kushtet e shkurtimit:.....	179
Distanca:.....	180
Distanca vajtje-ardhje:.....	186
Fukahatë:.....	187
Nijeti për të përshkuar distancën:.....	188
Fukahatë:.....	188
Qëndimi dhjetë dit në një vend:.....	190

Fukahatë:.....	190
Atdheu:.....	191
Ligjërimi i udhtimit:.....	193
Fukahatë:	194
Gjuetia:.....	195
Dalja në dritë e gabimit:.....	197
Udhtimi profesion:.....	198
Fukahatë:.....	198
Nëpunësia dhe puna:.....	200
Ai nuk sheh muret dhe nuk dëgjon ezanin:.....	202
Fukahatë:.....	203
DISPOZITAT E NAMAZIT TË UDHTARIT.....	205
Lidhja në mes shkurtimit të namazit dhe prishjes së agjërimit:...	205
Katër vendet:.....	206
Falja e plotë e namazit kur duhet falur i shkurtuar:.....	207
Udhtimi pas daljes së kohës për faljen e namazit:.....	209
Largimi i atij që ka bërë nijet të qëndrojë:.....	210
Heqja dorë nga vendqëndrimi:.....	211
NAMAZI I XHUMASË.....	212
Motivimi për të falur namazin e xhumasë:.....	212
Mënyra e falajes së namazit të Xhumasë:.....	213
Fukahatë:.....	213
Kushtet:.....	215
Imami i pastërt nga gabimet (el-imàmul-maësùm):.....	215
Numëri:.....	217
Dy hytbet:.....	218
Fukahatë:.....	219
Xhemati:.....	220
Uniteti:.....	220
Koha:	220

I obliguari për faljen e namazit të Xhumasë:.....	221
NAMAZI I FITËR BAJRAMIT DHE I KURBAN BAJRAMIT....	222
Fukahatë:.....	222
Mënyra e faljes së namazit të dy bajrameve:.....	223
Fukahatë:	224
NAMAZI ME RASTIN E NDODHIVE KOZMIKE.....	226
Argumenti që e bën detyrim:.....	226
Koha:	227
Mënyra e faljes:.....	230
Fukahatë:.....	230
Çeshtje:.....	232
PËRMBAJTJA E LËNDËS.....	234

فقه الامام جعفر الصادق عليه السلام

المؤلف: محمد جواد مغنية

الجزء الثاني

الترجمة الى اللغة الألبانية: المرحوم الشيخ الحاج سليم اصطفى

تيرانا: 2018

اسم الكتاب: فقه الامام جعفر الصادق عليه السلام - الجزء الثاني

المؤلف: محمد جواد مغنية

الترجمة الى اللغة الألبانية: المرحوم الشيخ الحاج سليم اصطفى

المشرف العام: شيخ وُلُنْتُ مَرَّيَا

التصحيح اللغوي: يريدا كولا

الاخراج و الغلاف: صبريه فزا

الناشر: جمعية "النسيم"

المطبعة: انتشارات "ليلو"

تيرانا: 2018